



ARM



NË MISIONET PAQERUAJTËSE



REVISTË E MINISTRISË SË MBROJTJES SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË



EDICIONI SPECIAL
WNT

Përmbajtja:

Faqe **4** **NË MBROJTJE TË VLERAVE BASHKËKOHORE**
PAQUERUAJTËSIT E MAQEDONISË TË DENJË PËR RESPEKTIN E MADH



Faqe **7** **AMBASADORËT E PAQES TË MAQEDONISË**
TË DENJË PËR BESIMIN



Faqe **14** **NË SHOQËRI ME MË TË MIRËT**
PAQUERUAJTËSIT E MAQEDONISË NË OPERACIONE PAQESORE



Faqe **26** **USHTARËT E PAQES, TË SUKSESSHËM DHE SHUMË PROFESIONAL**
ME PAQUERUAJTËSIT TANË DHE AMBASADORËT MË TË MIRË TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË



Faqe **43** **PROFILIZIMI I ARMATËS SË RE**
MISIONI „LIRI PËR IRAKUN“



Faqe **50** **MISIONI I PARË I PAVARUR**
MISIONI I BE ALTHEA I DETASHMENTIT HELIKOPTERIK NË BEH (2006 -2008)



Faqe **56** **MISIONI MË I GJATË NË ORGANIZIM TË OKB-së**
MISIONI I OKB-së – UNIFIL



WITIT (MBUROJA) – edicioni special, dhjetor 2012

BOTUES
MINISTRIA E MBROJTJES
SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

MBI BOTUESIN:
Dr. Fatmir Besimi,
Ministër i Mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë

KËSHILLI REDAKTUES
Kolonel Zoran Sekullovski, major Zlatko Blazhevski,
Doc. Dr. Zhanet Ristova, Kristina Ilievska,
Kolonel Lube Dukovski, nën-kolonel Metodi Haxhi Janev

KRYEREDAKTOR
Vasil Diçevski

REDAKTOR PËRGJEGJËS
Ast. Mr. Marjan Gjurovski

REDAKSIA
Biljana Ivanova (redaktor teknik, artistiko-grafik),
Ivan Petrushevski (redaktor),
Mitko Vasilevski (gazetar),
Ksenija Miteva (lektor),
Aleksandar Atanasov (fotograf)

Përkthimi në gjuhën shqipe
Merita Limani
Lektorimi
Shkëlzen Halimi

Shtyp: „NAMPRES“ – Shkup

„Me punë dhe përkushtim drejt përhapjes së demokracisë, lirisë dhe barazisë“

Është nder dhe kënaqësi e madhe që si komandant suprem i Armatës së Republikës së Maqedonisë mund të theksoj se ju, pjesëtarët e Armatës së Republikës së Maqedonisë, jeni njëra nga shtyllat në të cilat mbështetet integriteti dhe pavarësia e Maqedonisë, ju jeni mburoja e lirisë, sigurisë dhe stabilitetit tonë.

Me krenari të madhe mund të konstatoj se Armata e Republikës së Maqedonisë ka përmbushur kriteret për anëtarësim në NATO dhe në mënyrë aktive kontribuon në misionet paqeruajtëse si një anëtare e vërtetë e Aleancës. Në vazhdimësi e ndjek gjendjen e kontingjenteve të Armatës të cilët kontribuojnë në vendosjen dhe ruajtjen e paqes globale në operacionet e udhëhequra nga NATO, por edhe nga Bashkimi Evropian dhe nga Kombet e Bashkuara. Paqeruajtësit tanë janë shembull i vërtetë për përkushtim dhe qëndrueshmëri ndaj qëllimeve tona strategjike.

Me këtë rast dua t'ju shpreh mirënjohje publike dhe respekt të gjithë paqeruajtësve të Armatës së Republikës së Maqedonisë të cilët në periudhën e deritashme kanë investuar shumë mund dhe përkushtim në angazhimin në misionet në Afganistan, Irak, Bosnjë e Hercegovinë dhe në Liban. Ata kanë kontribuar për vendosjen e paqes në vendet në të cilat kanë qenë të angazhuar, njëkohësisht duke afirmuar atdheun tonë në planin ndërkombëtar. Besoj se në të ardhmen e afërme, Republika e Maqedonisë edhe formalisht do të bëhet pjesë vëllazërisë euroatlantike të popujve e cila është e përkushtuar në vendosjen e sigurisë më të madhe, demokracisë dhe të drejtat njerëzore gjithkund nëpër botë.



Dr. **Gjorgje IVANOV**,
President i Republikës së Maqedonisë,
komandant suprem i forcave
të armatosura të RM



NË MBROJTJE TË VLERAVE BASHKËKOHORE



PAQERUAJTËSIT E MAQEDONISË TË
DENJË PËR RESPEKTIN E MADH

★ DR. FATMIR BESIMI,
MINISTËR I MBROJTJES SË
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË



Republika e Maqedonisë është vend i të barabartëve, vend në mesin e të barabartëve. Ky parim përshkruan parimin që ne ndjekim dhe do të vazhdojmë të ndjekim, duke paraqitur kapacitetet dhe aftësitë tona për kontribut efektiv dhe efikas drejt themelimit të vlerave bashkëkohore globalisht. Ekzistojnë disa elemente thelbësore si një mur mbështetës i drejtpërdrejtë apo i tërthortë për përpjekjet tona të cilat janë në korrelacion me partnerët tanë dhe të Aleancës, në të cilën kemi qëllim të anëtarësohemi.

Fillimisht nisem nga vetja, nga zhvillimi dhe përkrahja e proceseve demokratike dhe reformuese në „oborrin e shtëpisë“, si një mënyrë për investim në aftësitë dhe kapacitetet tona të sigurisë për të realizuar vlerat dhe interesat e përbashkët. Në këtë drejtim, Ministria e Mbrojtjes nuk heq dorë nga ruga e zhvillimit, e cila na ka dhënë mundësi që me vetëbesim të theksojmë se Armata e Republikës së Maqedonisë është armatë e të gjithë qytetarëve, armatë e cila, krahasuar me institucionet tjera, gëzon besueshmërinë më të madhe tek qytetarët e vendit dhe armatë e cila padyshim është ambasadori ynë më i madh në botë. Zhvillimi i një sistemi efikas të sigurisë si një imperativ i yni mundëson të kemi një pishinë prej ku do të thithim aftësinë për kontribut në përpjekjet në nivelin global.

Republika e Maqedonisë është shtëpia jonë drejt së cilës të gjithë duhet të lëvizim si një tërësi në procesin e ndërtimit të ardhmërisë së përbashkët. Shprehja „E pluribus unum“ ose „Nga një, shumë“, qartë tregon mënyrën në të cilën të gjithë ne duam të ndërtojmë vendin tonë. Në këtë kontekst, duhet të shikohet edhe Armata e Republikës së Maqedonisë, e cila është njëra nga institucionet më të rëndësishme, institucion i cili duhet të pasqyrojë strukturën etnike të shtetit. Besueshmëria nuk është diçka që mund të dhurohet – por fitohet, ndërsa respektimi i ndërsjellë dhe bashkëpunimi janë disa nga katalizatorët kyç në këtë proces. Sigurisht, do të theksoja se ne punojmë dhe do të vazhdojmë të punojmë në këtë fushë, me një mendim të vetëm, si nga shumë të bëjmë një të përbashkët.

Kjo fushë komplekse kërkon punë të vazhdueshme dhe paralele në disa fusha tjera. Sidoqoftë, zhvillimi, në kuptimin materialo-technik, njerëzor dhe në kuptim të çdo lloji, është një proces i cili është nisur që nga vetë konstituimi i

Armatës së Republikës së Maqedonisë dhe prandaj, nuk mundemi, apo, nuk guxojmë të ndërpresim këtë proces. Ndërsa, pengesa gjatë kësaj rruge ekzistojnë dhe do të ekzistojnë. Kriza financiare botërore, pastaj edhe kriza e zgjeruar ekonomike, ka qenë „grushti i fortë“ i fundit të cilin akoma e ndiejmë. Por, përcaktimi, vendosmëria, këmbëngulësia dhe përkushtimi ynë ndaj zhvillimit na mundësojnë që ngadalë, por sigurt të arrijmë qëllimet tona. Punojmë në rritjen e standardit në secilën kazermë, në secilën njësi, tek secili individ, sepse kjo është me rëndësi për ne. Rritja e standardit është ajo që paraqet garancë për lirinë e atdheut tonë dhe njëkohë-

sisht kjo do të paraqesë edhe një pasqyrë për Maqedoninë në të gjitha pjesët e botës, e veçanërisht në misionet ku ushtarët tanë përhapin vlerat të cilat ne i gëzojmë dhe të cilat janë pjesë e jetës sonë të përditshme.

LIDHJA RAJONALE – RRUGA MË E SHKURTËR DREJT IN- TEGRIMEVE EUROATLANTIKE

Duke shkuar një hap prapa, ky imazh tani më nuk përfshin vetëm Republikën e Maqedonisë. Përkundrazi, mozaiku është shumë më i



ndërlikuar dhe më piktoresk, dhe i njëjti imazh kërkon kujdesin e duhur. Rajoni ka rëndësi të madhe për ne, sepse ne jemi një „ishull në det“. Ne jemi këtu, njëri pranë tjetrit, ne marrim frymë njëjtë. Prandaj është shumë e rëndësishme që thelbësisht të përkushtohemi në zhvillimin e raporteve të ndërsjella, dhe si pasojë të krijojmë lidhje të forta si një mënyrë për të arritur siguri, stabilitet dhe paqe më të madhe rajonale. Në fakt, edhe realiteti i ri ekonomik kërkon të bashkohemi dhe të ndajmë kapacitetet tona. Në skenën botërore të mbrojtjes këtë koncept e aplikoi Aleanca e NATO-s me anë të „mbrojtjes së zgjuar“. Që vizioni dhe këndvështrimi nga



perspektiva e zhvillimit më të gjatë dhe të qëndrueshëm nuk është diçka e huaj për Rajonin e Ballkanit flasin edhe faktet – zhvillimi i qendrave rajonale janë një imperativ si për ne, ashtu edhe për partnerët tanë. Në fakt, Republika e Maqedonisë ka ofruar disa opsione reale të cilat tanimë funksionojnë në praktikë. Qendra Rajonale për Trajnim në Komunikime e cila duhet të zhvillohet në Qendër për Trajnim e Partneritetit për Paqe, Qendra për Trajnim Mjekësor, si një mënyrë për trajnimin e forcave rajonale mjekësore

dhe iniciativa për krijimin e Qendrës për Paqe e cila do të fokusohet drejt ndërtimit post-konfliktual të institucioneve shtetërore dhe shoqërisë, janë vetëm një pjesë e mënyrave sipas të cilave Republika e Maqedonisë mund drejtpërdrejtë të kontribuojë në bashkëpunimin rajonal. Si mënyra më specifike për bashkim do të përmendja edhe projektin për përmirësim të kushteve dhe kapaciteteve për akomodim, qëndrim, për trajnim dhe stërvitje në Poligonin Ushtarak „Krivollak“ i cili në vitin 2013 do të hyjë në fazën e dytë, si dhe qasja rajonale ballkanike për mbrojtje ajrore, si një mënyrë krejtësisht e re e avancimit të efikasitetit dhe efektshmërisë.

Ndjeshmëria dhe mirëpritja e kombeve të Ballkanit mundësoi të gjitha këto projekte, si dhe shumë të tjera, të konsiderohen seriozisht, dhe disa prej tyre tashmë qëndrueshëm të realizohen në terren. Gjithsesi, historia e lidhjes së suksesshme rajonale dhe krijimit të kontakteve të forta dhe të pandashme në kontekstin rajonal na lejon qartë të theksojmë se ne kemi kapacitet për të dalë nga kornizat tona dhe për të dhënë një kontribut real dhe të drejtpërdrejtë në një shtrirje shumë më të gjerë.

KONTRIBUTI NË MISIONET NDËRKOMBËTARE – FAKTE PËR RESPEKT

Periudha e tranzicionit në Republikën e Maqedonisë nga një importues në një ek-

sportues të paqes ishte shumë e shkurtër. Kontributi i parë në vendosjen e paqes globale ka filluar, nga ky këndvështrim, në vitin e largët 2002, kur në kuadër të forcave ISAF në Afganistan, nën udhëheqjen e Aleancës së NATO-s, Armata e Republikës së Maqedonisë dërgoi përfaqësuesit e saj të parë. Suksesi i kontingjentëve të cilët në vazhdimësi tregonin aftësitë e tyre të padyshimta, profesionalizmin në kryerjen e detyrave të caktuara dhe seriozitetin ndaj punës, kanë mundësuar që kontributi në mision vazhdimisht të ritet. Faktikisht, në vitin 2010, është arritur kontributi më i madh, kontributi i nivelit të

për Irakun”, kur Armata e Republikës së Maqedonisë me gjithsej 11 rotacione të kryera, apo 490 persona, sërish qëndroi në mbrojtje të lirisë. Dhe, nuk ndalum këtu. Para gjashtë viteve u bëmë pjesë e operacionit EUFOR-ALTHEA, i udhëhequr nga Bashkimi Evropian, edhe atë me një detashment helikopterësh (deri në vitin 2008), me ekip mjekësor NIVELI-1, me një këshilltar juridik dhe me një nënoficer për mjekësi preventive. Dhe nga viti i ardhshëm 2007, kemi përfaqësues tanë edhe në operacionin UNIFIL në Liban (oficer shtab), që udhëhiqet nga Organizata e Kombeve të Bashkuara.



PROMOVIMI I VLERAVE UNIVERSALE

„Vizita e ime përputhet me tre ngjarje të rëndësishme për Republikën e Maqedonisë: 11 Tetorin, ditën kur Maqedonia i tha „po“ lirisë; 20 vjetorin e pavarësisë, kur Maqedonia i tha „po“ pavarësisë dhe 10 vite nga Marrëveshja Kornizë e Ohrit, kur Maqedonia i tha „po“ bashkëjetesës dhe demokracisë. Ndjehem i lumtur që ju gjej në gjendje të mirë shëndetësore dhe që në mënyrë profesionale dhe me dinjitet i kryeni detyrat e juaja dhe me sukses e kryeni misionin tuaj. Ju përuroj për aksionin e suksesshëm më 13 shtator, i cili është dëshmi për një profesionalizëm shumë të lartë. Me këtë ju e ndërtoni imazhin

e Republikës së Maqedonisë si një vend me standarde dhe cilësi të larta për promovimin e vlerave universale”.

Pjesë e fjalës së ministrit Besimi gjatë vizitës së tij te kontingjenti i Maqedonisë në Kabul, Afganistan (11.10.2011)



lartë, kur me dërgimin e 250 pjesëtarëve të ARM-së Republika e Maqedonisë u bë vendi i katërt kontribues në ISAF, sipas numrit të popullsisë. Ndërsa, kontributi në kuadër të forcave ISAF do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Kjo është pjesë e Planit Afatmesëm për Zhvillim të Mbrojtjes 2012-2017, me të cilin është paraparë pjesëmarrje e vazhdueshme në ISAF deri në vitin 2014, si dhe kontribut dhe përkrahje të mëtejme për Forcat e Sigurisë Afgane pas vitit 2014. Bashkëpunimi me partnerët tanë të dëshmuar, Shtetet e Bashkuara, është dëshmuar edhe në veprë gjatë misionit „Liri



PASURI DHE PËRVOJË SHUMË E ÇMUAR

„Nuk kam fjalë me të cilat mund ta përshkruaj, në emrin tim personal dhe në emër të Ministrisë së Mbrojtjes, mirënjohjen për angazhimin tuaj, për aktivitetet tuaja nga aspekti shumë human, që në fushëbetejë të shpëtoni jetën e njerëzve, të kujdeseni për shëndetin e të gjithëve dhe me krenari ta afirmoni kosmopolitizmin e Armatës së Republikës së Maqedonisë dhe të atdheut. Ju keni përcjellë shpirtin tuaj të mirë, profesionalizmin dhe kompetencën në strukturat e batalionit të Norvegjisë ku edhe i kryeni detyrat tuaja punuese.

Besoje se prania juaj në spitalin për terren të batalionit norvegjez dhe puna e juaj në ekip me kolegët tuaj norvegjez dhe amerikan ju kanë ndihmuar të ripërtërin, zgjeroni dhe t’i përmirësoni njohuritë tuaja dhe se e gjithë kjo paraqet pasuri dhe përvojë të çmuar në segmentin e angazhimit tuaj të mëtejme në profesion”.

Pjesë e fjalës së ministrit Besimi gjatë ndarjes së nderimeve dhe pllakave për pjesëmarrësit në rotacionin e tretë të ekipit kirurgjik në kuadër të forcave ISAF (07.06.2012)

Njëkohësisht, Republika e Maqedonisë, që nga viti 1999 siguron mbështetje të vazhdueshme për forcat e operacionit KFOR në Kosovë.

I gjithë kontributi i deritashëm në misionet paqeruajtëse ndërkombëtare na ka sjellë disa elemente të cilat zhvillohen në mënyrë konstante që nga rotacioni i parë, nga misioni i parë i kryer. Pjesëtarët tanë janë të denjë për shumë respekt. Ata janë profesionistë të mëdhenj, luftëtarë të dëshmuar, paqeruajtës dhe bartës të paqes, sigurisë dhe demokracisë. Dhe, kur e gjithë kjo nuk është e thënë vetëm nga shteti nga i cili vijnë, por pa përjashtim nga të gjitha instancat e arkitekturës së sigurisë globale, rëndësia shumëfishohet. Faktet flasin se deri tani janë ndarë rreth 1.900 nderime ndaj paqeruajtësve të Maqedonisë. Për arritjet e jashtëzakonshme janë ndarë edhe medalje nderi për katër paqeruajtës të ARM-së për kontribut të jashtëzakonshëm në misionin „Liri për Irakun“ dhe gjashtë paqeruajtësve të ARM-së për merita të jashtëzakonshme në ISAF Afganistan.

Këto shifra flasin më mirë për atë se çka përfaqësojnë dhe si konsiderohen paqeruajtësit të cilët unë shpesh i quaj „ambasadorët“ tanë më të mirë të paqes.

QARTË DREJT QËLLIMIT

Republika e Maqedonisë është e përgatitur me potencialin e plotë me të cilin disponon, në mënyrë të barabartë me vendet tjera, të ballafaqohet me sfidat e ardhshme. Aftësitë tona janë të dukshme, dëshira e ynë është e madhe. Ne i ndjejmë dobittë nga demokracia dhe nga barazia, nga mosdiskriminimi dhe nga mundësitë e hapura, dhe prandaj hapërojmë fuqishëm në rrugën e realizimit të vlerave të njëjta në secilën shtëpi, në secilin vend.

Gatishmëria nuk ka rëndësi të madhe pa përkushtimin e duhur, prandaj duhet që edhe njëherë qartë të ngrihem dhe të themi: Ne jemi të përkushtuar. Ne jemi të vendosur. Ne nuk heqim dorë. Do të qëndrojmë në rrugën tonë të definuar dhe do të jemi edhe një fuqi më tepër, do të jemi fuqia e cila lufton për më të shenjtën – paqen. ★

AMBASADORIËT E PAQES TË MAQEDONISË

NË LINJËN E PARË



TË DENJË PËR BESIMIN

GJENERAL-MAJOR
★ GORANÇO KOTESKI,
KRYESHEF I SHP TË ARM-SË



Kur flasim për paqeruajtësit e Maqedonisë, atëherë nënkuptojmë ndjenjën e devotshmërisë për të gjithë atë që ka arritur Republika e Maqedonisë në periudhën e kaluar dhe për kontributin të cilin e japin paqeruajtësit tanë, jo rastësisht të quajtur edhe ambasadorët tanë më të mirë të paqes në botë dhe të imazhit të vendit tonë në botë.

Kontributi i Republikës së Maqedonisë në misionet ndërkombëtare paraqet konfirmim konkret për suksesin e reformave në mbrojtje dhe për përcaktimet e fuqishme strategjike të shtetit për anëtarësim në NATO dhe në Bashkimin Evropian. Republika e Maqedonisë sot kontribuon në tre operacione ndërkombëtare jashtë vendit (të udhëhequra nga NATO, BE dhe OKB - ISAF, ALTHEA, UNIFIL, Liban) dhe e udhëheq operacionin e katërt për sigurim të përhershëm logjistik të forcave të NATO-s, KFOR në Kosovë nëpërmjet funksionimit të Qendrës Koordinative për Mbështetje nga vendi-nikoqir (HNSCC).

Sot, kontributi global i Republikës së Maqedonisë përbëhet nga gjithsej 171 paqeruajtës të shpërndarë në operacionet e udhëhequra nga NATO, Bashkimi Evropian dhe OKB. Përfshirë edhe kontributin e vendit-nikoqir, Republika e Maqedonisë në vitin 2012 ka arritur nivelin e kontributit me rreth 190 persona, që paraqet shkallën e vendosjes së trupave me rreth 3% nga forcat tokësore të Armatës së Republikës së Maqedonisë në operacione paqeruajtëse nëpër botë.

Kjo përqindje e kontributit është për t'u respektuar, sepse nuk mund të arrihet edhe nga një numër i madh i vendeve-anëtare të NATO-s dhe Bashkimit Evropian. Kështu, vetëm në Afganistan, duke krahasuar për krye banori, Republika e Maqedonisë në vitin 2012 kontribuon shumë më se të gjitha vendet nga Rajoni dhe më tepër se shumë vende-anëtare të NATO-s, dhe kontributi i saj është shumë i përafërt, krahë më krahë, me atë të Mbretërisë së Bashkuar, SHBA-ve, Norvegjisë, Holandës, Danimarkës. Republika e Maqedonisë është e përkushtuar edhe për forcimin e mëtejshëm të kontributit të ardhshëm drejt sigurisë dhe paqes globale, nëpërmjet zgjerimit gradual të kontributit në operacionet ndërkombëtare dhe arritjes së vendosjes së 10% të trupave të forcave ushtarake në afat të gjatë.

Ajo që përbën krenari të veçantë është fakti që gjatë gjithë kontributit të deritashëm të Republikës së Maqedonisë në operacionet e udhëhequra nga NATO, BE dhe OKB, pjesëtarët e Armatës së Republikës së Maqedonisë kanë treguar dhe dëshmuar se janë të denjë për besimin e dhënë. Me sakrificën e tyre, profesionalizmin, disiplinën dhe përkushtimin ndaj detyrave të caktuara ata e përfaqësojnë atdheun e tyre në mënyrën më dinjitoze të mundshme. Si krenari për shtetin dhe ambasadorët e saj, paqeruajtësit tanë janë dëshmi se Republika e Maqedonisë meriton anëtarësimin e barabartë drejt të cilit synon.

PARTNER I ÇMUAR DHE I DËSHIRUAR

Paqeruajtësit e Maqedonisë janë partner i dëshmuar, i çmuar dhe i dëshiruar. Kon-



firmim më i mirë për këtë janë dukshmëria e flamurit të Maqedonisë dhe identifikimi i saj me paqeruajtësit të cilët posedojnë standardet më të larta. Vërtetim plotësues janë edhe nderimet më të larta të cilat paqeruajtësit tanë i fitojnë rregullisht në të gjitha kontributet e deritashme.

Me 20 vitet e saja pavarësi dhe 10 vite kontribut në paqen botërore, Republika e Maqedonisë dhe ARM përmes rotacioneve të deritashme në misionet ndërkombëtare ka arritur standardet më të larta, dhe në atdhe janë kthyer me një përvojë të madhe të fituar. Paqeruajtësit e Maqedonisë të cilët në vitin 2002, për herë të parë në mënyrë simbolike shënuan në mënyrë simbolike fillimin e kontributit tonë në operacionet paqeruajtëse në botë, duke vuar flamurin e Republikës së Maqedonisë në Afganistan pikërisht në Ditën e Pavarësisë, 8 Shtator, vazhdojnë të përfaqësojnë ambasadorë të vendit të cilët në mënyrën më të mirë të mundshme afirmojnë Republikën e Maqedonisë në ndërtimin e paqes dhe stabilitetit në botë. Dobitë të cilat ARM i fiton nga pjesëmarrja në operacionin paqeruajtës ISAF, fillimisht nga mësimet e nxjerra dhe përvojat e fituara, do të ndjehen në të ardhmen. Për një vend me zhvillim modest ekonomik si që është Maqedonia, të kesh ushtarë të trajnuar mirë të këtij niveli të cilët janë të aftë

të shfaqin shkallë të lartë të profesionalizmit dhe në të njëjtën kohë të kontribuojnë për imazhin e përgjithshëm pozitiv të forcave ISAF, paraqet një nder të veçantë. Republika e Maqedonisë dhe qytetarët e saj gjithmonë kanë qenë krenar për kuadrin e ARM-së të cilët në këtë periudhë nuk janë vetëm rojtar të paqes dhe sovranitetit të vendit, por njëkohësisht edhe ambasadorë të paqes. Prandaj, ata së bashku me kolegët e tyre të NATO-s ndihmojnë në vendosjen e zhvillimit demokratik në RI të Afganistanit.

VËRTETIM PËR NJË ANGAZHIM TË FORTË

Republika e Maqedonisë konfirmon përcaktimin strategjik për të arritur anëtarësim në Bashkimin Evropian nëpërmjet angazhimit të fortë politik për përkrahje të Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe Sigurisë (PPJS/CFSP) dhe duke deklaruar kontribut konkret ndaj operacioneve civile dhe ushtarake në kuadër të Politikës së Përbashkët të Mbrojtjes dhe Sigurisë (PPMS/CSDP) të BE-së. Pjesëmarrja e Republikës së Maqedonisë në operacionin ushtarak të BE-së për menaxhim me kriza në BeH, ALTHEA, shënon të parin prej morisë së kontributeve konkrete dhe të rëndësishme të cilat Republika e Maqedonisë do t'i japë në kuadër të operacioneve civile dhe ushtarake të PPMS në



drejtim të forcimit të kapaciteteve të BE-së. Kontributi i Republikës së Maqedonisë në operacionin e BE-së „ALTHEA“ ka vërtetuar progresin e vet nga një vend-shfrytëzues në operacionin e parë të Unionit („Konkordia 2003“) në vend-kontribues aktiv drejt PPMS („ALTHEA 2006“). Kontributi i Republikës së Maqedonisë në operacionin ALTHEA paraqet vërtetim për angazhimin e fortë të Republikës së Maqedonisë për kontribut të fuqishëm për Politikën e Përbashkët të Mbrojtjes së Sigurisë (PPMS) dhe Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe Sigurisë (PPJS/CFSP) të BE-së, si dhe vërtetim për përpjekjet e përgjithshme të Republikës së Maqedonisë për integrim në Bashkimin Evropian.



publik në Maqedoni në aspekt të përkrahjes së Koalicionit për luftë kundër terrorizmit, Republika e Maqedonisë ka marrë pjesë aktive në dërgimin e njësive të saja në misionin „Liri për Irakun“. Ushtarët dhe oficerët gjatë realizimit të misionit janë ballafaquar me sfida, kërcënime dhe rreziqe të ndryshme të cilat shoqërojnë misionin dhe profesionin. Pjesëtarët e Armatës së Republikës së Maqedonisë gjatë misionit kanë treguar profesionalizëm, shkallë të lartë të trajnimit dhe gatishmërisë në kryerjen e misioneve. Me përkushtimin e tyre, guximin dhe patriotizmin, sup më sup me ushtarët e SHBA-ve dhe të partnerëve tjerë të koalicionit kanë përfaqësuar atdheun

uar në mjedisin ndërkombëtar, si dhe manifestim politik i angazhimeve strategjike të Republikës së Maqedonisë. Sipas vlerësimeve të aftësive dhe kapaciteteve, Armata e Republikës së Maqedonisë edhe në të ardhmen është e gatshme që të vazhdojë pjesëmarrjen e saj në operacionet paqeruajtëse me kapacitete të njëjta, por edhe me kapacitete të shtuara, sidomos në BE BG, ku është deklaruar një regjiment i mekanizuar këmbësorik (125 persona) njësisia ABHO (9 persona), ekipi HUMINT (3 persona), një element kombëtar për mbështetje (5 persona) dhe oficerë të shtabit në komandën e GB së BE-së (8 persona), ose gjithsej 150 persona.

KONFIRMIM I ANËTARËSIMIT EFTKIV NË OKB


Siguria dhe prosperiteti në suaza globale shumë më tepër varen nga sistemi multilateral. Partneriteti strategjik me Organizatën e Kombeve të Bashkuara, karta e së cilës paraqet kornizë fundamentale të marrëdhënieve ndërkombëtare, është prioritet i Bashkimit Evropian dhe NATO-s në skenën e sigurisë ndërkombëtare. Sipas kësaj, kontributi i Republikës së Maqedonisë edhe në pjesën ushtarake në misionet e udhëhequra nga Organizata e Kombeve të Bashkuara paraqet një konfirmim të anëtarësimit efektiv të Republikës së Maqedonisë në këtë Organizatë, si dhe për përcaktimet e saja strategjike.

Republika e Maqedonisë në maj të vitit 2007 filloi pjesëmarrjen e saj në operacionin paqeruajtës të udhëhequr nga Organizata e Kombeve të Bashkuara në Liban, UNIFIL, me një pjesëtar nga Armata e Republikës së Maqedonisë në pozitën e oficerit të shtabit në Qendrën e Përbashkët Operative në Liban.

Kontributi i deklaruar i Republikës së Maqedonisë me një oficer shtabi u realizua me anë të miratimit të Vendimit nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë më 27 prill, 2007. Ky vendim u zbatua më 16 maj, 2007.

PËRFAQËSIM SHEMBULLOR

Me konsensus politik nga të gjitha subjektet politike në RM, si dhe nga i gjithë opinioni



tonë, Republikën e Maqedonisë, me dinjitet dhe në mënyrë shembullore. Armata e Republikës së Maqedonisë ka dhënë kontributin e vet konkret në mundësimin e ndërtimit të institucioneve të forta demokratike të besueshme dhe forca sigurie të trajnuara mirë në Irak, forca të cilat garantojnë ardhmërinë e vendit të vet, si dhe stabilitetin dhe sigurinë në rrethin e tyre dhe më gjerë.

VAZHDOJMË ME PJESËMARRJEN NË OPERACIONET PAQERUAJTËSE

Kontributi i vazhdueshëm i Republikës së Maqedonisë drejt multilateralizmit efektiv është një tjetër konfirmim i përvojës së fit-

Në vitin 2013, ne vazhdojmë me operacionet paqeruajtëse në Afganistan me një staf prej 150 pjesëtarëve. Duke pasur parasysh angazhimin e Aleancës për të dërguar forca të sigurisë në Afganistan, edhe ne do të fokusohemi në mentorim, trajnim dhe asistim të forcave afgane.

Regjimenti i deklaruar i mekanizuar këmbësorik është i gatshëm për vendosje në mision dhe është në gatishmëri operative.

Kështu, Republika e Maqedonisë mbetet në rrugën në të cilën hapëron me sukses që nga viti 2002, dhe paqeruajtësit tanë në të ardhmen do të jenë ambasadorë të paqes në botë. ★

“Arrijet ju shpijnë në familjen e NATO-s”



Kolonel Aleksander ALEKSANDROV,
Shef i Zyrës Ndërlidhëse të NATO-s në Republikën e Maqedonisë

Siguria, në kohët e fundit, është bërë pjesë e pandashme dhe universale. Sfidat janë bërë më komplekse dhe të paparashikueshme. Ndryshimet e shpejta, komplekse dhe dinamike, si dhe kërcënimet e reja asimetrike, si terrorizmi, krimi i organizuar transnacional, përhapja e armëve të shkatërrimit në masë, radikalizmi fetar, migrimi ilegal, trazirat, shtetet jofunksionale dhe sulmet kibernetike kërkojnë veprime të koordinuara shumëpalëshe.

Mënyra më efektive për të ruajtur sigurinë është parandalimi. Shteti juaj dhe shoqëria si një e tërë e kanë të qartë se kontributi në operacionet paqeruajtëse dhe mbajtja e kërcënimeve larg kufijve kombëtarë, në të vërtetë përfaqëson interesat e sigurisë kombëtare. Pikërisht për këtë arsye, vendi është angazhuar vazhdimisht të marrë pjesë në operacionet e mbështetjes së paqes të udhëhequra nga NATO-ja, BE-ja dhe OKB-ja, dhe me këtë të kontribuojë edhe për sigurinë rajonale, euro-atlantike dhe sigurinë dhe stabilitetin global. Nga kjo rrjedh edhe përgjegjësia për të siguruar çdo gjë që është e nevojshme për forcat e ARM-së të vendosura në misionet, ata janë krenarë për të përmbushur detyrat e tyre në mënyrë që të arrijnë prosperitetin dhe mirëqenien e qytetarëve. Duke pasur parasysh aspiratat për anëtarësim në NATO, një përfitim shtesë i kësaj pjesëmarrjeje është që pjesëmarrja jonë në misionet paqeruajtëse kontribuon në zhvillimin e aftësive të forcave të armatosura për të punuar së bashku me anëtarët e forcave të armatosura të NATO-s dhe vendeve partnere, si dhe për të rritur nivelin e ndërveprimit, duke lehtësuar kështu dhe reformat e mbrojtjes.

Vendi juaj, disa vite radhazi, me forcat e tyre kontribuon në operacionet e mbështetjes së paqes, d.m.th. ajo merr pjesë në “Liri për Irakun”, në operacionet aktuale ISAF të NATO-s në Afganistan, në misionin e kryesuar nga BE ALTHEA në Bosnje dhe Hercegovinë dhe në misionin UNIFIL në Liban. Gjithashtu, vendi edhe më tej ofron mbështetjen e nevojshme për forcat e KFOR-it të cilat tranzitojnë nëpër territorin e saj. Të gjithë këtë NATO e vlerëson shumë, dhe në shumë raste ka shprehur mirënjohjen e saj.

Bindja ime personale është se, me anë të arritjeve në fushën e sigurisë dhe përmes transformimit, vendi juaj do të marrë vendin e merituar në familjen e NATO-s.

MIQTË DHE ALEATËT TANË PËR PAQERUAJTËSIT E MAQEDONISË

„Një kontribut i rëndësishëm në përpjekjet e përgjithshme mbi sigurinë dhe mbrojtjen në Evropë”



Aivo ORAV,
Ambasador i BE-së, Shef i Delegacionit të Bashkimit Evropian në Republikën e Maqedonisë

„Bashkimi Evropian është mirënjohës për pjesëmarrjen tuaj në operacionet ndërkombëtare për ruajtjen dhe krijimin e paqes të udhëhequr nga OKB-ja, NATO-ja dhe BE-ja. Nëpërmjet kësaj pjesëmarrje aktive kontribuon në ndërtimin e paqes dhe stabilitetit në botë, një nga objektivat strategjike kryesore të Bashkimit Evropian. Falë tranzicionit demokratik, vitet e fundit vendi juaj ndërton kapacitetet e veta për të marrë pjesë në mënyrë aktive në këtë proces.

BE-ja është e kënaqur me cilësinë e dialogut politik me vendin tuaj në çështjet që lidhen me politikën e jashtme dhe të mbrojtjes. Ne shprehim mirënjohje për angazhimin tuaj aktiv dhe të vazhdueshëm në politikën e sigurisë dhe mbrojtjes evropiane. Ky angazhim është theksuar në raportet e progresit të publikuar nga Komisioni Evropian në vitet e fundit.

Gjithashtu, ne ju falënderojmë për pjesëmarrjen tuaj të vazhdueshme në misionin e EUFOR, ALTHEA në Bosnjë dhe Hercegovinë. Ne mirëpresim gatishmërinë e shprehur të vendit për të marrë pjesë në II/2012 BG të BE-së, e cila do të jetë operative në gjysmën e dytë të këtij viti. Nëpërmjet pjesëmarrjes në BG BE II/2012, së bashku me partnerët e BE-së, ju jepni një kontribut të rëndësishëm për sigurinë dhe përpjekjet e përgjithshme mbi mbrojtjen në Evropë.

Përveç kësaj, ju duhet të konsideroni që në tetor 2012 u nënshkrua Marrëveshje në mes të vendit tuaj dhe Bashkimit Evropian për të krijuar një kornizë për pjesëmarrjen në operacionet e menaxhimit të krizave të Bashkimit Evropian. Kjo padyshim do të lehtësojë pjesëmarrjen e mëtejme të ushtrisë tuaj në operacionet e menaxhimit të krizave të BE-së. Nënshkrimi i kësaj marrëveshje paraqet një hap përpara në zhvillimin e partneritetit tonë në kuadër të Politikës së Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët të Bashkimit Evropian.”

„Besim reciprok dhe bashkëpunim“



Paul D. UOLERS,
Ambasador i SHBA-ve
në Republikën e Maqedonisë

„Pjesa më e madhe e sfidave më të vështira të sigurisë me të cilat përballet bota sot më së miri mund të zgjidhen përmes bashkëpunimit efektiv ndërkombëtar. Armata e Republikës së Maqedonisë dhe udhëheqja e saj civile përkrahin këto përpjekje, duke dhënë kontribut në misionet paqeruajtëse dhe të koalicionit, si në nivel rajonal ashtu edhe global. Duke ndarë, sup më sup, detyrimet mbi sigurinë si partnerë, ne mund të arrijmë shumë më tepër si një kolektiv, se sa do të mund të arrinim individualisht.“

Në vitet e fundit, më shumë se 2100 ushtarë të Maqedonisë u vendosën së bashku me ushtarët amerikanë në Irak dhe Afganistan. Për më tepër, vendosja në Operacionin ALTHEA (Misioni paqeruajtës i BE-së në Bosnje) dhe tek Forcat Tranzitore të Kombeve të Bashkuara në Liban, edhe një herë kanë dëshmuar se Maqedonia është një partner i qëndrueshëm i cili dëshiron të bëjë një kontribut të çmuar në përpjekjet për të realizuar dhe promovuar paqen dhe stabilitetin.

Gjatë të gjitha operacioneve paqeruajtëse të përbashkëta, forcat tona ushtarake kanë zhvilluar besimin e ndërsjellë dhe bashkëpunim që vazhdon të rritet dhe të thellohet. Ky besim reciprok është demonstruar më mirë gjatë vendosjes së suksesshme të përbashkët në Afganistan, ushtarët e Maqedonisë të bashkuar me trupat e Gardës Kombëtare të Vermontit.

Maqedonia është një mik dhe partner i çmuar i Shteteve të Bashkuara të Amerikës që nga koha e pavarësisë, dhe ne jemi të sigurtë se në të ardhmen do të vazhdojmë të punojmë së bashku për të zgjidhur së bashku, sup më sup, sfidat e përbashkëta të së nesërme.“

MIQTË DHE ALEATËT TANË PËR PAQERUAJTËSIT E MAQEDONISË

„Forcat e armatosura të Maqedonisë gëzojnë reputacion të lartë“



Kristofer IVON,
Ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar
në Republikën e Maqedonisë

„Që nga vendosja e „skorpionëve“, disa vjet më parë, dhe deri më sot, Forcat e Armatosura të Mbretërisë së Bashkuar dhe Republikës së Maqedonisë kanë qenë të shpërndarë vazhdimisht në operacionet në Afganistan si pjesë e misionit ISAF.“

Bashkëpunimin i tyre i ngushtë vazhdon edhe më tej - dy herë në vit sigurohet transporti ajror nga Mbretëria e Bashkuar për kontingjentet e ARM-së dhe ofrohen shërbime logjistike mbështetëse nga Mbretëria e Bashkuar për trupat maqedonase.

Të dy vendet kanë një rol kyç të vazhdueshëm: ruajtjen e një mjedisi të sigurtë për popullsinë afgane, përderisa ata ndërtojnë një të ardhme të re për vendin e tyre dhe të pengohet krijimi i strehimeve të sigurta për terroristët.

Profesionalizmi dhe përkushtimi i të dy ushtrive në një mjedis të vështirë, është një shembull i shkëlqyer se si bashkëpunim i tillë mund të prodhojë rezultate në terren. Gjithashtu, ky bashkëpunim tregon kontributin e Maqedonisë si një forcë për ndryshime pozitive. Aftësia ARM-së dhe gatishmëria e tyre për anëtarësim të plotë në NATO janë shumë evidente.

Respekti dhe reputacioni i forcave të armatosura të Maqedonisë të fituara përmes vendosjeve të tilla, janë në një nivel të lartë, dhe Mbretëria e Bashkuar është shumë krenare për rolin e saj në mbështetjen e këtyre arritjeve.“

„Forcat e armatosura të Maqedonisë janë dëshmuar si një partner i përgjegjshëm dhe i besueshëm“



**Nënkolonel
Arnold MEYER,**

Atashe ushtarak i Republikës
Federale të Gjermanisë
në Republikën e Maqedonisë

„Forcat e Armatosura të Gjermanisë disa vjet me radhë kanë një bashkëpunim të suksesshëm, të ngushtë me Forcat e Armatosura të Maqedonisë. Përveç bashkëpunimit bilateral, i cili kryesisht përbëhet nga vizitat reciproke informative dhe marrja e masave për përmirësim, duhet të përmendet edhe bashkëpunimi në misionet ndërkombëtare.

Me rëndësi të madhe ka qenë mbështetja bilaterale e Maqedonisë në operacionet e suksesshme të NATO-s, „Essential Harvest“, „Amber Fox“ dhe „Allied Harmony“, të cilat nga viti 2001-2003 dhanë kontribut të veçantë për të stabilizuar vendin tuaj.

Veçanërisht duhet të theksohet angazhimi i Forcave të Armatosura të Maqedonisë në Afganistan. Këta ushtarë nga viti 2003 janë angazhuar pjesërisht nën udhëheqjen gjermane. Në këto angazhime, ushtarët e Maqedonisë gjithmonë kanë përmbushur obligimet e tyre në mënyrë profesionale dhe me angazhim të plotë. Gjithashtu, me rëndësi të madhe është mbështetja logjistike, e cila që nga viti 1999, i jepet KFOR-it. Fillimisht, puna e Qendrës Maqedonase Logjistike për Koordinim me vendin nikoqir (Host Nation Support Coordination Centre) është kryer në bashkëpunim me shtabin e NATO-s në Shkup. Pasi selia e NATO-s u shpërbë, Qendra Maqedonase për Koordinimin Logjistik me vendin nikoqir ka marrë përsipër të gjithë përgjegjësinë për mbështetje logjistike të misionit të KFOR-it.

Bashkëpunimi në Operacionin ALTHEA në Bosnje dhe Hercegovinë, në të cilën Forcat e Armatosura të Maqedonisë kontribuojnë me dy helikopterë për transport ajror ishte nën 'hijen' e një helikopteri të rënë në vitin 2008, e cila rezultoi me 11 të vdekur.

Sfida e re e përbashkët është bashkëpunimi brenda grupeve luftarake të BE-së. Në gjysmën e dytë të vitit 2012, Maqedonia, nën udhëheqjen gjermane, në këto grupe luftarake merr pjesë me një numër jo aq të vogël, dhe në këtë mënyrë jep një kontribut thelbësor jo vetëm për funksionimin e këtij grupi luftarak, por edhe për objektivat politike në Politikën e Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes së Bashkimit Evropian.

Bashkëpunimi i gjatë gjermano-maqedonas është konfirmuar në të gjitha angazhimet, ndërsa Forcat e Armatosura të Maqedonisë janë dëshmuar si partner të përgjegjshëm dhe të besueshëm.“

MIQTË DHE ALEATËT TANË PËR PAQERUAJTËSIT E MAQEDONISË

„Maqedonia në operacionet paqeruajtëse do të ruajë nivelin e njëjtë të lartë“



Gjurol SOKMENSUER,

Ambasador i Republikës së Turqisë në
Republikën e Maqedonisë

„Krizat dhe konfliktet kombëtare dhe rajonale dolën në pah në periudhën pas Luftës së Ftohtë, së bashku me rreziqet dhe kërcënimet e tilla si terrorizmi dhe përhapja e armëve të shkatërrimit në masë. Si rezultat i këtyre nevojave të reja të sigurisë, mbështetjet në operacionet paqësore dhe operacionet paqeruajtëse janë rritur ndjeshëm.

Në këtë kontekst, si një vend që i kushton shumë vëmendje sigurisë, stabilitetit dhe paqes rajonale dhe globale, Turqia është mirënjohës për kontributin e Maqedonisë në operacionet paqeruajtëse të udhëhequra nga BE-ja, OKB-ja dhe NATO-ja në Afganistan (ISAF), në Irak („Liri për Irakun“), në Bosnjë dhe Hercegovinë (Althea) në Liban (UNIFIL) dhe në Kosovë (KFOR).

Edhe pse vendi ka kaluar nëpër një periudhë të vështirë në fund të viteve të 1990-ta dhe gjatë konfliktit në vitin 2001, sot ka dëshmuar se Maqedonia është plotësisht e angazhuar për të kontribuar për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në disa misione paqeruajtëse. Unë jam i bindur se angazhimi i përgjithshëm i Maqedonisë në operacionet paqeruajtëse ndërkombëtare do të mbajë nivelin e njëjtë të lartë, si më parë.

Si dëshmi e marrëdhënieve të shkëlqyeshme bilaterale mes dy vendeve tona, vlen të theksohet se pjesëmarrja e Maqedonisë në operacionin ISAF filloi në gusht të vitit 2002 me dy oficerë të dërguar si pjesë e kontingjentit turk në Afganistan.

Me këtë rast, unë do të doja edhe një herë të shpreh mbështetjen time të fortë për arritjen e qëllimit të Maqedonisë - për të arritur integrimin e plotë në komunitetin euro-atlantik, gjë që edhe më shumë do të kontribuojë për prosperitetin dhe stabilitetin në rajon, por edhe në suaza më të gjera“.

„Maqedonia ka dëshmuar se posedon kapacitete të forta ushtarake mjekësore“



Nils RAGNAR KAMSVAG,
Ambasador i Mbretërisë së Norvegjisë, i akredituar në Republikën e Maqedonisë

„Vendosja ynë e përbashkët në ISAF ka qenë një element i rëndësishëm në zhvillimin pozitiv të marrëdhënieve bilaterale mes Maqedonisë dhe Norvegjisë në vitet e fundit. Vendosja e përbashkët, jo vetëm që na bashkoi në aspektin praktik, por ajo gjithashtu paraqet një kriter të fortë në përpjekjet tona për të krijuar përfitime reciproke në operacionin ku shërbimi mjekësor është vendimtar. Unë e di se sigurimi i spitalit, i udhëhequr nga Norvegjia, në Mejmana, Afganistan, nuk do të ekzistonte pa ekipet kirurgjike nga Maqedonia. Maqedonia ka siguruar ekipe kirurgjike për 7 kontingjente në ekipin provincial norvegjez për rikonstruim në Mejmana. Niveli i kompetencës dhe angazhimi profesional i demonstruar nga stafi i Maqedonisë ka qenë me të vërtetë mbresëlënës dhe ka shpëtuar jetën e njerëzve. Në përgjithësi, Maqedonia ka dëshmuar se posedon kapacitete të forta ushtarake mjekësore. Ndjem i nderuar se Norvegjia ishte në gjendje të kontribuojë në forcimin e këtyre kapaciteteve nëpërmjet një donacioni për spitalin për terren në tetor, 2012.

Unë jam i bindur se lidhjet tona të forta në fushën e mjekësisë ushtarake do të vazhdojnë. Norvegjia do të vazhdojë të mbështesë projekte në Maqedoni në mënyrë që të promovojë integrimin euro-atlantik dhe nxitjen e zbatimit të vazhdueshëm të reformave të vazhdueshme. Norvegjia vlerëson kontributin e rëndësishëm të Maqedonisë në operacionet e NATO-s dhe mbështet ambiciet e Maqedonisë për t'u bashkuar me NATO-n. Ne sinqerisht shpresojmë se spitali për terren do të vendoset në operacionet e ardhshme të OKB-së apo NATO-s, dhe se kjo aftësi do të forcojë edhe më tej rolin aktiv të Maqedonisë në bashkëpunimin rajonal në Ballkanin Perëndimor.“

MIQTË DHE ALEATËT TANË PËR PAQERUAJTËSIT E MAQEDONISË



NË SHOQËRI ME MË TË MIRËT



USHTARËT E MAQEDONISË NË OPERACIONET PAQERUAJTËSE

Thonë që shifrat flasin shumë. Kur është fjala për pjesëmarrjen e paqeruajtësve të Maqedonisë në operacionet e paqes, ne kemi arsye për të qenë krenar: paqeruajtësit e Maqedonisë, sipas përqindjes së popullsisë zënë vendet kryesore në botë, dhe ne jemi krenar edhe me dekoratat që ata kanë marrë për profesionalizmin, guximin dhe shkathtësinë e demonstruar në kryerjen e detyrave si Luftëtarë të Paqes

PJESËMARRJA NË OPERACIONET PAQERUAJTËSE NË AFGANISTAN

Republika e Maqedonisë ka filluar pjesëmarrjen e saj në operacionin ISAF të udhëhequr nga NATO në gusht të vitit 2002, duke dërguar dy oficerë si pjesë e kontingjentit turk. Më 8 shtator, në Ditën e Pavarësisë së Republikës së Maqedonisë, flamuri i Maqedonisë për herë të parë valoi në Kabul. Në mars të vitit 2003, Armata e Republikës së Maqedonisë ka rritur kontributin e saj në misionin ISAF duke dërguar një njësi të përbërjes së Brigadës së Këmbësorisë së Dytë, si pjesë e kontingjentit gjerman. Si rezultat i realizimit të suksesshëm të misionit dhe vlerësimeve të larta për pjesëmarrjen në "ISAF", nga gushti 2004 deri në fund të vitit 2006, ARM ka marrë pjesë me një tog këmbësorie të mekanizuar nga njësi e "leopardëve". Ndërkohë, në gusht të vitit 2005, në ISAF u dërgua edhe personel mjekësor, si pjesë e ekipit mjekësor aleat në format A3 (Maqedonia, Shqipëria, Kroacia), të cilët me sukses kanë kryer detyra të aeroportit të Kabulit, së pari brenda spitalit grek për në terren, dhe pastaj në kuadër të spitalit çek për në terren.



Bazuar në vlerësimet e Aleancës në pjesën e njëjësive të deklaruara të ARM-së që kanë arritur standardet e kërkuara strikte në fushën e trajnimit dhe procedurave operative, dhe në përputhje me Konceptin e Aftësive Operative (OCC), ARM-ja në qershor të vitit 2006 ka dërguar një Regjiment të Mekanizuar Këmbësor si pjesë e brigadës së parë të mekanizuar të këmbësorisë në kuadër të kontingjentit britanik në ISAF. Besimi i treguar nga Britania e Madhe në nëntëdhjetë "skorpionët" e Brigadës së Këmbësorisë së Parë, u justifikua plotësisht.

Vlerësime e larta nga strukturat komanduese më të larta për punën e njësisë, si dhe mësimet e nxjerra, paraqesin një nxitje për të vazhduar misionin e suksesshëm.

Në rotacionin e dytë të regjimentit për sigurim të komandës së ISAF-it, Republika e Maqedonisë ka shtuar praninë nga nëntëdhjetë në 127 (njëqind e njëzet e shtatë) pjesëmarrës, dhe nga janari i vitit 2008, i dërgoi edhe tre oficerë shtabi në komandën e ISAF-it në Kabul.

Në mbështetje të përpjekjeve për vetë-qëndrueshmëri të Armatës Kombëtare Afgane (ANA), duke filluar nga muaji mars 2008, Republika e Maqedonisë dërgoi dy anëtarë (një oficer dhe një nënoficer), si pjesë e ekipit të përbashkët shumëkombësh ndërlidhës operativ për mentorim (OMLT) në Mazari Sharif ndërsa duke filluar nga dhjetori 2008,

në rezultate, dhe në mënyrë që të forcojë bashkëpunimin rajonal dhe bashkërisht të kontribuojë në krijimin e paqes në botë, në kuadër të iniciativës A-5 (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi), dhe me mbështetjen e Shteteve të Bashkuara dhe Shteteve të Bashkuara të Evropës si anëtar i asociuar në 2011. filloi përgatitjen e personelit për pjesëmarrje në operacionin paqeruajtës, "ISAF", në kuadër të Misionit për Trajnim të NATO-s - Afganistan (NTM-A). Vendi udhëheqës është Republika e Kroacisë, në projektin për mentorim të stafit të AKA në shkollën e policisë ushtarake në garnizonin Darulaman, në rajonin e Kabulit. Kontingjenti i parë në këtë nismë rajonale është dërguar në shtator 2011, dhe Republika e Maqedonisë mori pjesë me 3 (tre) oficerë të shtabit. Në shkurt të vitit 2012, pjesëmarrja në këtë nismë rajonale është rritur për pesë (5) persona tjerë, brenda ekipit trajnues mobil.

Republika e Maqedonisë merr pjesë me përfaqësuesin më të vjetër kombëtar, një regjiment të mekanizuar këmbësor (149 ushtarë), një oficer në Komandën e Përbashkët Ndërkombëtare në ISAF, Kabul me një nënoficer në aeroportin KAIA, pesë oficerë si pjesë e shumëkombëshes OMLT në Mazari Sharif dhe dy oficerë në shkollën e policisë ushtarake AKA në rajonin e Kabulit. Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve aktualisht është 159 (njëqind e pesëdhjetë e nëntë). Deri tani, Republika e Maqedonisë në misionin ISAF ka marrë pjesë me 2169 (dy mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) persona.

KONTRIBUTI YNË NË OPERACIONIN USHTARAK ALTHEA TË BE-SË PËR MENAXHIMIN E KRIZAVE NË BOSNJË DHE HERCEGOVINË

Nëpërmjet traktatit midis Republikës së Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Maqedonisë në kuadër të Operacionit ALTHEA i cili u nënshkrua më 3 korrik 2006, në Bruksel, Belgjikë, nisi kontributi i parë i Republikës së Maqedonisë në operacionin e udhëhequr

nga Bashkimi Evropian në korrik të vitit 2006 me deklarimin e detashmentit helikopterik të ARM-së, pjesë përbërëse nga dy helikopterë "Mi-8/17" dhe personel prej 21 personave.

Në nëntor të vitit 2006, Republika e Maqedonisë forcoi kontributin e saj në operacionin Bashkimit Evropian, ALTHEA në BeH, duke deklaruar një ekip mjekësor të përbërë nga 10 persona ROLE 1- mbështetje mjekësore në Kampin Butmir.

Për shkak të rëndësisë së mbështetjes me helikopter në përmbushjen e misioneve të Operacionit ALTHEA, veçanërisht në transformimin e vazhdueshëm të EUFOR-it është kërkuar vazhdim i misionit të detashmentit helikopterik të Maqedonisë e cila vazhdoi në përbërje të njëjtë në rotacionin e dytë dhe të tretë.

Përveç kësaj, kontributi i Republikës së Maqedonisë në ALTHEA u forcua edhe më tej duke deklaruar një person, një asistent juridik ushtarak si këshilltar ligjor në HQ EUFOR (nga 20 qershori, 2007). Kështu, kontributi i përgjithshëm i Republikës së Maqedonisë në operacionin ALTHEA, duke përfshirë kapacitetet helikopterike dhe mjekësore, përbëhej nga dy Mi-8/17 dhe gjithsej personel prej 32 njerëzve.

Republika e Maqedonisë, në raport me rotacionin e katërt të detashmentit helikopterik (janar-qershor, 2008), dhe në bazë të analizave dhe vlerësimeve të kryera paraprakisht, solli vendim me çka shprehu nevojën për tërheqjen e një helikopleri "Mi-8/17" në drejtim të aritjes së nivelit të nevojshëm të operimit për kontributet e ardhshme. Në përputhje me vendimin, rotacioni i katërt i detashmentit helikopterik në operacionin paqeruajtës Althea në Bosnjë dhe Hercegovinë përbëhej nga një helikopter transporti Mi-8/17 dhe nga 12 persona në përbërje të detashmentit helikopterik.

Më 12 janar të vitit 2008 ndodhi aksidenti tragjik me helikopter në Blacë të Katlanovës ku humbën jetën 11 pjesëtarë të ARM-së, gjatë kthimit nga misioni i përfunduar me sukses në BeH, të cilët ishin pjesë



në bashkëpunim me Mbretërinë Norvegjeze, është përfshirë personel mjekësor maqedonas me një ekip kirurgjikal në strukturën organizative të njësisë kirurgjikale pranë ekipit norvegjez Ekipi Provincial për Rindërtim (PRT) në Mejmana, Afganistan.

Pjesëmarrja e Republikës së Maqedonisë dhe Armatës së Republikës së Maqedonisë në operacionin paqeruajtës të udhëhequr nga NATO, ISAF vazhdoi të rritet. Kështu, nga janari i vitit 2009, edhe 3 (tre) pjesëtarë tjerë të ARM-së (dy oficerë dhe një rreshter), si pjesë e Ekipit Operativ Mentorial për Lidhje (OMLT) janë dërguar në rajonin Kunduz, për të mentoruar anëtarët e AKA. Në mars të vitit 2010, në kuadër të bashkëpunimit bilateral me Forcat e Armatosura të Shteteve të Bashkuara, më saktë me njësinë e Gardës Kombëtare të Shtetit të Vermontit, SHBA, u vendosën 79 (shtatëdhjetë e nëntë) pjesëtarë të regjimentit dhe ROS në një rotacion, për të kryer detyra në operacionin paqeruajtës, ISAF.

Pjesëmarrja e ARM-së në operacionin paqeruajtës ISAF është vlerësuar shumë nga shtetet anëtare të NATO-s dhe vendet part-



e rotacionit të tretë të detashmentit helikopterik.

Në shkurt, 2008, Republika e Maqedonisë dërgoi edhe një person-nënoficer për mjekësi parandaluese në HQ EUFOR, me çka kontributi i përgjithshëm i Republikës së Maqedonisë në operacionin paqeruajtës ALTHEA përbëhej nga një helikopter transporti "Mi-8/17" dhe staf total prej 24 personave.

Me përfundimin e rotacionit të katërt të detashmentit helikopterik në korrik të vitit 2008, është sjellë vendim që Republika e Maqedonisë të rumbullakojë dhe përfundojë kontributin e saj me kapacitete helikopterike në operacionin ALTHEA të EU-



FOR në BeH, me gjithsej katër rrotullime të bëra (korrik 2006 - korrik 2008).

Pas tërheqjes të detashmentit helikopterik, Republika e Maqedonisë vazhdoi të kontribuojë me ekipin mjekësorë ROLE 1- mbështetje mjekësore për Kampin Butmir të përbërë nga 10 persona, një person Këshilltar Asistent-Ligjor në komandën e EUFOR-it në BeH dhe një nënoficer për mjekësi parandaluese në Komandën EUFOR, me një pjesëmarrje totale prej 12 njerëzve.

Gjatë vitit 2009, 2010 dhe 2011, Republika e Maqedonisë ka vazhduar pjesëmarrjen me kapacitete të njëjta. Sipas strukturës së re të EUFOR-it në operacionin ALTHEA, numri është ulur, dhe si rezultat i kësaj është hequr edhe pozita e nënoficerit për mjekësi parandaluese nga janari, 2012, kështu që kontributi në operacionin paqeruajtës në vitin 2012, mbeti me një ekip mjekësor dhe një këshilltar ligjor, një total prej 11 njerëzve. Në rrjedhë është rotacioni i trembëdhjetë i ekipit mjekësor dhe rotacioni i njëmbëdhjetë i këshilltarit asistent-juridik.

Republika e Maqedonisë në vitin 2012 do të vazhdojë të kontribuojë në operacionin ALTHEA me një pjesëmarrje totale prej 11 personave (10 persona në ekipin mjekësor dhe 1 person jurist ushtarak, këshilltar asistent-juridik, në Komandën e EUFOR-it).

MISIONI PAQERUAJTËS I KOMBEVE TË BASHKUARA NË LIBAN, UNIFIL

Në vitin 2007, Republika e Maqedonisë ka filluar kontributin e saj në misionin paqeruajtës UNIFIL në Liban duke dërguar një oficer shtabi në Qendrën e Përbashkët Operative në Liban.

Më 1 qershor 2008, Republika e Maqedonisë ka vazhduar kontributin në operacionin paqeruajtës UNIFIL në Liban duke dërguar një oficer të ri shtabi, që paraqet rotacionin e parë të personelit nga Maqedonia në kuadër të operacionit UNIFIL. Deri më tani në këtë operacion kanë marrë pjesë gjashtë (6) persona. Në operacionin paqeruajtës të OKB - UNIFIL në Liban, ARM merr pjesë me një oficer shtabi që nga maji i vitit 2007. Deri tani janë kryer pesë rotacione prej gjithsej 5 personave. Aktualisht është në rrjedhë rotacioni i gjashtë me 1 person.

MISIONI „LIRI PËR IRAKUN“

Misioni ka filluar me dërgimin e 2 oficerëve-përfaqësues kombëtar në Komandën Qendrore të SHBA-ve në Tampa në mars të vitit 2003.

Pas përfundimit të operacioneve kryesore luftarake, rrëzimin e regjimit të Sadam Huseinit dhe miratimin e Rezolutës 1546 të Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara, në qershor të vitit 2003 është miratuar vendim dhe është dërguar një skuadër për qëllime speciale që kryente detyrat në përbërje të divizionit këmbësorik të 4 të Forcave Shumëkombëshe për Irakun. Në vitin 2008, pjesëmarrja jonë në operacionin paqeruajtës „Liri për Irakun“ u zgjerua edhe me një skuadër plotësuese. Nga qershori i

vitit 2003 deri më dhjetor, 2008, janë kryer gjithsej 11 rotacione. Rotacioni i njëmbëdhjetë ka qenë i fundit, me çka ka përfunduar edhe pjesëmarrja jonë në misionin në Irak. Numri i plotë i personave që kanë marrë pjesë në këtë mision është 493. Pjesëmarrja e ARM-së në këtë operacion ka përfunduar në dhjetor, 2008.

Në kuadër të këtij operacioni, ARM ka marrë pjesë edhe me oficerë shtabesh në Komandën Qendrore në SHBA, Tampa, Florida, në periudhën prej qershorit 2003 - qershor 2010, me gjithsej 15 persona.

REZULTATE QË MERITOJNË RESPEKT

Republika e Maqedonisë, edhe pse nuk është anëtare e NATO-s, është njëra nga kombet që më shumë kontribuojnë për paqen në botë, llogaritur për krye banori. Deri tani në misionet e NATO-s, OKB-së dhe BE-së kanë marrë pjesë gjithsej 2.821 paqeruajtës nga Maqedonia, edhe atë në tre kontinente: Evropë, Azi dhe Afrikë. Midis tyre ka pasur edhe 127 femra-paqeruajtëse. Aktualisht në misione paqeruajtëse ndodhen 171 paqeruajtës nga Maqedonia, prej të cilëve 9 janë femra. Ambasadorët tanë të paqes deri tani kanë fituar 1.828 medalje, më shumë në misionet e NATO-s - 1.666 medalje, 5 medalje në misionin e OKB-së dhe 157 medalje në misionin ALTHEA. ★



GRATË NË ARM – PJESËMARRËSE NË MISIONE

GARANCË PËR SUKSESIN E OPERACIONEVE PAQUERUAJTËSE

Të drejtat e gruas, ndikimi i konflikteve mbi të, si dhe kontributi të cilin ajo mund ta jep në forcimin e paqes dhe demokracisë në nivele botërore, kanë qenë disa nga aspektet të cilat në të kaluarën janë neglizhuar. Por, para dymbëdhjetë viteve, me miratimin e njëres nga rezolutat më të rëndësishme të Kombeve të Bashkuara, Rezoluta 1325, për ne, pjesëtarët e gjinisë femërore, u paraqit mundësia të kthejmë faqen dhe të hyjmë në shekullin e ri, të liruar nga marginalizimi, jobarazia dhe diskriminimi i femrave.

Rezoluta 1325 është Rezoluta e parë e Këshillit të Sigurimit e cila i lidh përvojat e femrave nga konfliktet përmes ruajtjes së paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, e cila konfirmon afinitetin për udhëheqës tek femrat dhe rolin e tyre në zgjidhjen e konflikteve, në negociatat paqësore dhe për ripërtëritje dhe e cila fton në ritjen e aftësisë për përgjigje nga aspekti gjinor gjatë misioneve paqeruajtëse dhe për trajnime gjinore për të gjithë të cilët janë të përfshirë në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit. Në periudhën që vjen duhet të ritet numri i femrave të cilat marrin pjesë në proceset e vendim-marrjes lidhur me paqen dhe stabilitetin, të sigurohet pjesëmarrja e grave në bisedimet paqësore, pastaj të sigurohen informata të cilat kanë të bëjnë me femrat dhe me konfliktet e armatosura në raportet për shtetet drejtuar Këshillit të Sigurisë dhe, kuptohet, të sigurohen trajnime mbi aspektet gjinore dhe mbi konfliktet e armatosura që të mund të shqyrtojmë aspektin gjinor në programet për çarmatim, demobilizim dhe riintegrim. Nga analizat e deritashme mund të konkludohet se është e nevojshme të përgatitet një strategji për rritjen e numrit të femrave-paqeruajtëse dhe bartëseve të vendim-marrjes për ruajtje të paqes. Njëkohësisht, përmes institucioneve globale, nevojitet një raport global për pjesëmarrje

të grave në ndërtimin e paqes, dhe përveç kësaj, të gjitha shtetet duhet të mundësojnë organet e OKB-së të mbledhin të dhëna për pozitën e gruas në situatat post-konflikte, duhet të emërohen këshilltarë gjinor apo këshilltarë për mbrojtjen e grave në misionet paqeruajtëse dhe të përgatitet një koleksion global mbi treguesit për zbatimin e Rezolutës 1325 dhe të propozohen mekanizma, në kuadër të secilit shtet dhe më gjerë, për të ndjekur zbatimin e strategjisë.

Gratë përbëjnë gjysmën e popullatës në botë dhe kanë pjesë veçanërisht të rëndësishme në jetën shoqërore, dhe për këtë duhet patjetër të theksohet se pikërisht një nga shtyllat bartëse të Rezolutës, shtylla e pjesëmarrjes, thekson edhe thelbin lidhur me proceset e barazisë. Thënë thjeshtë, gratë duhet të përfshihen në proceset e vendim-marrjes në të gjitha nivelet – në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, si dhe në mekanizmat



për parandalim, menaxhim dhe zgjidhje të konflikteve, dhe në negociatat paqësore.

Ministria e Mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë, me formimin e Komitetit për Barazi Gjinore, bashkohet me përpjekjet për avancim të barazisë gjinore. Realizimi i perspektivave dhe mosdiskriminimit janë bazat e më shumë elementeve, midis të cilave edhe pjesëmarrjes së grave në strukturat udhëheqëse të Ministrisë dhe Armatës së Republikës së Maqedonisë. Pikërisht themelimi i këtij Komiteti është dëshmi se ne padyshim punojmë në sigurimin e mundësive të njëjta njëlloj për femrat dhe meshkujt.

Armata e Republikës së Maqedonisë ka një numër të konsiderueshëm të femrave në radhët e saja, të cilat bashkë me kolegët e tyre meshkuj marrin pjesë në misionet dhe detyrat më të vështira. Armata e Maqedonisë është themeli i pavarësisë dhe sovranitetit tonë, ndërsa femrat në radhët e saj janë garanci më tepër për suksesin e misionit të ARM-së.

Në fakt, ne jemi të detyruar t'ju kushtojmë shumë vëmendje pjesëtareve të ARM-së. Edhe përkundër përqindjes së vogël të femrave në Armatë – pjesëmarrëse në misionet (rreth 8 për qind), 123 pjesëtarët e deritashme të ARM-së të cilat kanë qenë pjesë e misioneve ndërkombëtare paqeruajtëse kanë arritur rezultate shumë të suksesshme. Kjo na jep një motiv dhe forcë të investojmë më tepër dhe të ndryshojmë pasqyrën aktuale të përfaqësimit të femrës në strukturat e Ministrisë dhe Armatës, pasqyrë kjo që akoma nuk është në përputhje me rolin dhe pozitën e gruas në fushën e mbrojtjes. Arsyetja e angazhimit tonë është e thjeshtë – ne të gjithë jemi të barabartë!

*Selvet Baruti,
Kryetare e Komitetit për Perspektiva dhe
Barazi Gjinore pranë Ministrisë së Mbrojtjes
dhe Udhëheqëse e Sektorit për Mbështetje
të Ministrisë së Mbrojtjes*



TË GATSHËM PËR MISSIONET E ARDHSHME

KONCEPTI I AFTËSIVE OPERATIVE NË ARM

Një nga vendet më të vogla, sipas territorit dhe numrit të banorëve në botë, Republika e Maqedonisë, mund të krenohet me një armatë të vogël në numër, por shumë të përgatitur, të aftë për t'ju përgjigjur sfidave të kohës së re. Për këtë më shumë flasin sukseset që ushtarët tanë arrijnë në stërvitjet dhe aktivitetet ndërkombëtare dhe të tjera, si dhe me lëvdatat për paqeruajtësit tanë të cilët qëndrojnë krah me krah në misionet me ushtarët e armatave të NATO-s.

Sipas përcaktimit të Armatës së Republikës së Maqedonisë të pranojë Konceptin për Aftësi Operative dhe nga bisedat e mbajtura me ekipin e NATO-s, ARM-ja deklaroi njësitë e saja në pishinën e forcave sipas këtij koncepti. Një regjiment i mekanizuar këmbësorie, nga një skuadër pioniere dhe një inxhinierë për rrugë, një skuadër nga Policia Ushtarake dhe një detashment helikopterik, kanë qenë njësitë e para të deklaruara, dhe menjëherë pas kësaj edhe një regjiment për mbikëqyrje të thelluar.

Gjatë vitit 2007 në muajin maj janë kryer vetëvlerësime të nivelit 1 për njësitë e lartpërmendura me përjashtim të regjimentit për mbikëqyrje të thelluar vlerësimi i së cilës në nivelin 1 është realizuar në tetor të vitit 2007. Këto njësi kanë kaluar me sukses vlerësimin në fjalë.

Sipas pakos së qëllimeve të partneritetit, në vitin 2008, si njësi të deklaruara janë regjimentit për mbikëqyrje të thelluar, detashmenti helikopterik, Regjimenti i Policisë Ushtarake dhe Batalioni i Mesëm i Këmbësorisë. Kështu, në muajin maj të vitit 2008, fillimisht është bërë

vlerësim i nivelit 1 nga NATO për regjimentin për mbikëqyrje të thelluar, dhe pastaj gjatë një Kursi Kombëtar për trajnim të vlerësuesve (ku bashkë me 33 ndjekës nga ARM-ja kishte edhe nga tre ndjekës prej Republikës së Kroacisë dhe Republikës së Shqipërisë), është kryer vetë-vlerësim i nivelit 1 për Batalionin e Mesëm të Këmbësorisë dhe për Regjimentin e Policisë Ushtarake. Udhëheqja e kursit dhe liderët e ekipeve ishin nga ARM, ndërsa aktiviteti ishte mbështetur nga Komanda Supreme e Forcave Aleate për Evropë (SHAPE). Në muajin tetor të vitit 2008 është kryer vlerësim i nivelit 1 nga NATO për Regjimentin e Policisë Ushtarake, për Batalionin e Mesëm të Këmbësorisë dhe Detashmentin Helikopterik. Ky vlerësim u realizua gjatë Kursit të 14-të për trajnim të vlerësuesve në nivelin 1, or-



ganizuar dhe zbatuar nga Komanda Supreme e Forcave Aleate për Evropë (SHAPE), ku bashkë me dëgjues tjerë të vendeve të NATO-s dhe PpP-së, kursin e kryen edhe 6 dëgjues nga ARM-ja, dhe gjithashtu një oficer ishte në rolin e instruktorit (udhëheqës ekipi). Gjatë vitit 2008, Kursin për Trajnim të Vlerësuesve jashtë vendit e mbaruan 4 oficerë të ARM-së. Me këtë u rumbullakua procesi i vlerësimit të njësiteve të deklaruara të nivelit 1 sipas Konceptit për Aftësi Operative, apo me fjalë tjera njësitë u vlerësuan se ndër-veprojnë sipas standardeve të NATO-s.

Gjatë vitit 2009 janë realizuar vlerësime të nivelit 2 për njësitë të cilat kaluan me sukses nivelin 1. Në muajin maj 2009 u realizua vetë-vlerësim i nivelit 2 për Regjimentin për Mbikëqyrje të Thelluar, të cilën regjimenti e kaloi me sukses. Në muajin tetor të vitit 2009 me sukses e kaluan vetë-vlerësimin e nivelit 2 edhe Regjimenti për Polici Ushtarake dhe Batalioni i Mesëm i Këmbësorisë. Gjithashtu, përfaqësues të ARM-së morën pjesë në një kurs për trajnim të vlerësuesve niveli 2 në shkollën e NATO-s në Oberammegrau dhe në Kroaci (gjithsej mbaruan 9 persona nga ARM). Në pajtim me Planin për zbatim të Konceptit për Aftësi Operative dhe Planit për Vlerësim të Njësiteve të Deklaruara në vitin 2010 janë realizuar disa aktivitete. Si aktivitete më të rëndësishme janë Kursi i 18-të për Trajnim të Vlerësuesve për nivelin 1 organizuar dhe mbajtur nga Komanda Supreme e Forcave Aleate për Evropë (SHAPE), ku krahas dëgjuesve nga vendet e NATO-s dhe PpP-së, kursin e mbaruan edhe 13 ndjekës nga ARM, dhe gjithashtu një oficer ishte në rolin e instruk-



torit (udhëheqës ekipi). Njësia e cila u vlerësua gjatë kursit ka qenë njësia e cila duhej të dërgohej në misionin ISAF në Afganistan.

Në Kursin e 19-të për Trajnim të Vlerësuesve në Austri në muajin qershor të vitit 2010, morri pjesë një person nga ARM-ja si student (ndjekës) në kurs, ndërsa një person morri pjesë si instruktor (udhëheqës ekipi) gjatë kursit.

Në tetor të vitit 2010 është realizuar vlerësim i nivelit 2 nga NATO për Regjimentin për Mbikëqyrje të Thelluar, Regjimentin e Policisë Ushtarake dhe Batalionin e Mesëm të Këmbëtorisë. Njësitë kaluan me sukses vlerësimin dhe u vlerësuan si të aftë për luftë për të marrë pjesë në operacionet e udhëhequra nga NATO. Me këtë, këto njësi mbaruan ciklin e plotë të vlerësimit sipas Konceptit për Aftësi Operative me kohëzgjatje prej 3 vjet. Gjithashtu, është realizuar edhe vetë-vlerësim në nivelin 2 për Detashmentin Helikopterik.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2011, është realizuar edhe vetëvlerësimi i suksesshëm i nivelit 1 për grupin e Batalionit të Mesëm të Këmbëtorisë në muajin prill, dhe gjithashtu është realizuar edhe Kursi i 21 për Trajnim të Vlerësuesve nga niveli 1 i organizuar nga Komanda Supreme e Forcave Aleate për Evropën (SHAPE), ku përveç ndjekësve nga vendet e NATO-s dhe PpP, kursin e mbaruan edhe 5 ndjekës nga ARM-ja, dhe gjithashtu edhe një oficer ndodhej në rolin e instruktorit (udhëheqës ekipi). Si njësi e vlerësuar ishte Regjimenti i Mekanizuar i Këmbëtorisë i deklaruar dhe departamenti ABHO nga përbërja e EU BGII/2012 (Vlerësim i NATO-s, niveli 1).



Gjatë vitit 2012, në maj, në kohën e realizimit të stërvitjes së NATO/PpP „Cooperative Longbow/Lancer“ është kryer vlerësim i NATO-s për grupin e batalionit të mesëm të këmbëtorisë. Vetë vlerësimi është kryer si pjesë e Kursit të 23-të për Trajnim të Vlerësuesve, niveli 1, i organizuar dhe zbatuar nga Komanda Supreme e Forcave Aleate për Evropën (SHAPE). Krahas ndjekësve nga vendet e NATO-s dhe PpP-së, kursin e mbaruan edhe 9 ndjekës nga ARM, si dhe një oficer ka marrë pjesë si instruktor (udhëheqës ekipi). Ajo që është me rëndësi të përmendet lidhur me këtë kurs është se ka qenë kursi më i madh i organizuar deri tani sipas këtij koncepti.

Para të gjitha vlerësimeve dhe kurseve, me sukses janë kryer edhe vizitat e duhura këshillëdhënëse (para vlerësimeve) dhe takimet koordinative (para kurseve). Përveç kurseve për trajnim të vlerësuesve të nivelit 1, ku aktualisht kemi rreth 80 vlerësues të certifikuar, përfaqësues tanë kanë kryer me sukses edhe kursin për trajnim të vlerësuesve nga niveli 2 për vlerësim të aftësisë luftarake të forcave tokësore (CREVAL) dhe ajrore (TACEVAL), edhe atë gjithsej 20 persona (CREVAL 14, TACEVAL 6).

Përveç vlerësimeve të njëjësive të deklaruara në pishinën e forcave sipas Konceptit për Aftësi Operative dhe mbështetjes së realizimit të kurseve për trajnim të vlerësuesve në nivelin 1, si vend-nikoqir, ARM ka realizuar me sukses edhe aktivitete tjera lidhur me këtë koncept.

Në tetor të vitit 2010 është organizuar dhe realizuar Konferencë Vjetore sipas Konceptit për Aftësi Operative në Ohër. Përveç organizimit, në Konferencë kanë marrë pjesë edhe dy përfaqësues të ARM-së. Lidhur me organizimin e konferencës, RM dhe ARM kanë marrë vlerësimet më të larta nga NATO. Në qershor të vitit 2010 janë realizuar bisedime ekspertësh mbi zbatimin e Konceptit për Aftësi Operative në Mal të Zi nga ARM-ja. Si rezultat, dhe me qëllim të mbështetjes dhe ndihmës për drejtorin për vlerësim, një person i ARM-së morri pjesë në vetë-vlerësim në nivelin 1 të regjimentit të deklaruar të këmbëtorisë të Ushtrisë së Malit të Zi në nëntor të vitit 2010.

Në dhjetor të vitit 2010 dy persona nga ARM-ja kanë marrë pjesë dhe me sukses kanë mbaruar trajnimin për punë me bazën e të dhënave sipas Konceptit për Aftësi Operative në Finlandë, dhe në nëntor, 2011 në Zvicër. Gjatë këtij trajnimi, rregullisht, një person ka qenë i caktuar në rolin e instruktorit.

Në shkurt të vitit 2011 janë realizuar bisedime ekspertësh për zbatimin e Konceptit për Aftësi Operative në Republikën e Serbisë nga përfaqësues të ARM-së.

Në mars të vitit 2011 janë realizuar bisedime ekspertësh për zbatimin e Konceptit për Aftësi Operative në Bosnjë e Hercegovinë nga përfaqësues të ARM-së.

Në qershor, 2011 një përfaqësues nga ARM-ja ka marrë pjesë në vetë-vlerësim nga niveli 2 për një njësi në Ukrainë si vlerësues, ndërsa në muajin gusht të vitit 2011, një përfaqësues nga ARM ka marrë pjesë në vetë-vlerësim nga niveli 1 për një njësi në Ukrainë si mbikëqyrës i ri NATO-s. Pjesëmarrja e përfaqësuesve të ARM-së në Ukrainë ka vazhduar edhe në vi-



tin 2012 me kërkesë nga Komanda Supreme e Forcave Aleate për Evropën (SHAPE), Republika e Maqedonisë të përkrah aktivitete sipas këtij Koncepti për shkak të mungesës së personelit të trajnuar në komandat e NATO-s.

Nga aktivitete, sipas Konceptit për Aftësi Operative, për periudhën e ardhshme është paraparë vazhdimi i vlerësimit për grupin e Batalionit të Mesëm të Këmbëtorisë:

- Vetë-vlerësimi i nivelit 2 në tetor, 2013;
- Vlerësimi i NATO-s i nivelit 2 në tetor, 2014 - certifikim i vlefshëm deri në tetor, 2017.

Vlerësimi i NATO-s i nivelit për Detashmentin Helikopterik në tetor, 2014, me çka do të rumbullakohet cikli i vlerësimit të kësaj njësie dhe certifikim i së njëjtës me vlefshmëri deri në tetor, 2017.

Vlerësim i spitalit për terren, niveli 2:

- vetë-vlerësimi i nivelit 1 në qershor, 2013;
- vlerësimi i NATO-s i nivelit 1 në tetor, 2013;
- vetëvlerësimi i nivelit 2 në prill, 2014;
- vlerësimi i NATO-s i nivelit 2 në tetor, 2014 - certifikim me vlefshmëri deri në tetor, 2017.

Nga e gjithë kjo mund të konkludohet se ARM-ja, jo vetëm që ka zbatuar Konceptin për Aftësi Operative për vlerësim të njëjësive të saja të deklaruara për të pasur vlerësues të certifikuar për nivelin 1 dhe nivelin 2, por edhe fakti që ARM paraqet një udhëheqës në rajon, sipas këtij koncepti, e pranuar jo vetëm nga NATO, por edhe nga Mali i Zi, Serbia dhe Bosnja e Hercegovina. Kjo mirënjohje shihet edhe nga pjesëmarrja e ARM-së me përfaqësuesit e saj në kurse jashtë Republikës së Maqedonisë si instruktorë gjatë kurseve për trajnim të vlerësuesve dhe vlerësimit të njëjësive nga armatat tjera. ★



MAQEDONIA ËSHTË KRENARE

NË VIZITË TË PAQERUAJT

Paqeruajtësit e Maqedonisë, kudo që të jenë, gjithmonë na përfaqësojnë denjësisht.

Gjithmonë vlerësohen si ushtarë tejet profesional, ato janë shembull për të tjerët. Por njihen edhe për mikpritjen dhe shoqërim e tyre. Gjatë momenteve të lira dinë të organizojnë drekë Maqedonie, të mirëpresin miq nga ushtritë tjera, së bashku të këndojnë këngën "vajza e Maqedonisë", të valojnë flamurin e Maqedonisë, të përgatisin tortë në formën e Maqedonisë, të bëjnë që kohë në Afganistanin e largët ose në vendet tjera, të paktën për një moment të jetë si në shtëpinë mikëpritëse të Maqedonisë.

Megjithatë, kënaqësia më e madhe për ato është kur do të mirëpresin ndonjë mik nga Maqedonia, veçmas nëse mes miqve gjen-

den kryetari i RM-së dhe komandanti suprem i ARM-së, Gjorgje Ivanov, ministri i Mbrojtjes, Fatmir Besimi ose shefi i Shtabit të Përgjithshëm të ARM-së, Goranço Kotevski. Kështu ishte edhe më 11 nëntor të vitit 2012, kur kryetari Ivanov u takua me paqeruajtësit tanë. I shoqëruar nga ish shefi i SHP të ARM-së, gjeneral-nënkolonel Miroslav Stojanovski dhe shefi i tanishëm i SHP të ARM-së atëherë adjutant i komandantit suprem, gjeneral-major Goranço Koteski. Si nikoqir të vërtetë, paqeruajtësit tanë u shprehën mirëseardhje dhe i shërbyen me kafe nga Maqedonia, shkëmbyen mendime të bukura dhe dhurata të ndryshme.

"Maqedonia duhet të jetë krenare me pjesëmarrjen e paqeruajtësve tanë në misionin ISAF në Afganistan – tha atëherë kryetari



Ivanov, sepse ato në mënyrën më të mirë i demonstrojnë të gjitha reformat në armatën tonë. Ushtarët tanë profesionalisht i kryejnë të gjitha detyrat. Respektohen nga kolegët por edhe nga popullata vendase. Edhe pse jemi shtet i vogël, në këtë formë kontribuojmë që të stabilizohet një pjesë e botës"- potencoi kryetari Ivanov.

Ngjashëm ishte edhe gjatë vizitës së ministrit të Mbrojtjes Fatmir Besimi dhe shefit të SHP të ARM-së, gjeneral-major Goranço Koteski në kontingjentin e Maqedonisë në Kabull, Afganistan, me rastin e festës shtetërore 11 tetori, 20 vjetorit të pavarësisë së RM-së dhe 10 vjetorit të Marrëveshjes së Ohrit. Ministri i mbrojtjes Fatmir Besimi, i vizitoi paqeruajtësit



ME PAQERUAJTËSIT E SAJ

ËSVE TANË NË MISIONIN ISAF

tanë në misionin ISAF edhe në nëntor të vitit 2012.

"Unë jam i kënaqur dhe krenar që këtu dëgjuam vetëm fjalë të mira për pjesëtarët e ARM-së. Maqedonia, së bashku dhe në mënyrë të barabartë me të gjitha vendet-anëtare të NATO-s kontribuon për paqen dhe stabilitetin në botë. Maqedonia i plotëson standardet për t'u anëtarësuar në NATO"- vuri në dukje jo rastësisht ministri Besimi.

"Në bazë të vlerësimeve të mia dhe nga bisedat që i kishim me përfaqësuesit e lartë të NATO-s, thekson shefi i SHP të ARM-së, gjeneral-major Goranço Koteski, konsideroj se ushtarët e Maqedonisë me sukses e

sigurojnë bazën e ISAF-it në Kabull. Gjendja psikofizike dhe shëndetësore e ushtarëve tanë është e mirë dhe ata do të realizojnë me sukses detyrat e rregullta dhe luftarake.

Gjatë takimit me paqeruajtësit tanë në tetor 2011, ato u takuan edhe me komandantin e ISAF-it, gjeneralin Alen, i cili theksoi se i çmon jashtëzakonisht paqeruajtësit e Maqedonisë dhe është i lumtur që ato janë pjesë e ISAF-it. "U vërtetua se armata e Maqedonisë qëndron krah për krah me forcat e mëdha. Ushtarët e Maqedonisë janë pjesë e rëndësishme e misionit ISAF dhe janë ushtarë të shkëlqyeshëm dhe trima. Krenohem me to. Dita më fillon dhe mbaron

1. PJESËTARËT TANË ME SUKSES I REALIZOJNË DETYRAT E RREGULLTA DHE LUFTARAKE: MINISTRI BESIMI DHE SHEFI I SHP TË ARM-SË GJENERAL-MAJOR KOTESKI, NË MESIN E PAQERUAJTËSEVE TANË

2. GJITHMONË I MIRËSEARDHUR: KOMANDANTI SUPREM NË MESIN E USHTARËVE TË MAQEDONISË NË MISIONIN ISAF NË AFGANISTAN

3. MOMENTE NGA VIZITA E MINISTRI BESIMI TEK EKIPI I MAQEDONISË NË MISIONIN ALTHEA



duke u përshëndetur me ushtarët e Maqedonisë. Ata denjësisht e përfaqësojnë vendin e vet"- theksoi gjenerali Alen.

Kryetari Ivanov dhe ministri Besimi në nëntor të vitit 2012, në vizita të ndara, e vizituan edhe ekipin tonë mjekësor në misionin e BE-së ALTHEA në BeH. Edhe atje kishin rastin të dëgjojnë fjalë miradije për punën dhe profesionalizmin e ekipit tonë mjekësor. Me këtë rast, kryetari Ivanov dhe ministri Besimi vunë kurorë të busti në Butmir dhe i nderuan pjesëtarët e rënë nga kontingjenti i Maqedonisë në fatkeqësinë e helikopterit të rrëzuar në vendin e quajtur Bllaca e Katllanovës.

R.M.



ATA HAPËN RUGËN



LUFTËTARËT E PARË TË PAQES NGA MAQEDONIA ISHIN OFICERËT E SHTABEVE DHE KONTINGJENTEVE NË NIVEL TË KLASËS

Në historinë e Armatës së Republikës së Maqedonisë me shkronja të pashlyeshme janë shkruar emrat e oficerëve të shtabit të cilët shkuan në mision paqeruajtës jashtë vendit, si edhe të ushtarëve të cilët për herë të parë në historinë e Republikës së Maqedonisë dhe Armatës së Republikës së Maqedonisë, në formacionin e klasës, shkuan në mision të vërtete paqeruajtës në përkrahje të paqes. Ata e hapën rrugën edhe për misionet e ardhshme paqeruajtëse dhe e ndërtuan reputacionin e ARM-së dhe të RM-së në botë me sakrificën, përkushtimin, profesionalizmin dhe disiplinën e tyre ndaj detyrave të caktuara, duke e përfaqësuar atdheun e tyre me dinjitet. Gjatë muajit korrik të vitit 2002, në bazë të Rezolutës së këshillit të OKB-së me numër

1413 dhe Memorandumit për mirëkuptim me Republikën e Turqisë, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e miratoi vendimin e parë për dërgimin e dy oficerëve të parë të shtabit në misionin ISAF.

Në 7 gusht 2002, për herë të parë që nga ekzistenca e saj, Armata e Republikës së Maqedonisë, në mision paqeruajtës në përbërjen të kontingjenti turk nga Brigada Shumëkombëshe dhe Shtabi i Forcave të ISAF-it në Kabull- Afganistan, dërgoi kapitenin Zoran Janev, në rolin e oficer shtabi për lidhje, dhe togeri Marjan Nakov, si ndihmës oficer i operacioneve në përbërjen e batalionit turk. Më 8 shtator të vitit 2002, në Ditën e pavarësisë së Maqedonisë, në Komandën e ISAF-it në Turqi kapiteni Janev dhe togeri Nakov zyrtarisht e ngritën flam-

urin e Maqedonisë. Kjo shënoi zyrtarisht fillimin e misionit tone në kuadër të ISAF-it. Paqeruajtësit tanë kishin qëndruar në Ankara, në përbërjen e Njesisë për përgatitje të njësive paqeruajtëse turke për SFOR, KFOR dhe ISAF. Gjatë qëndrimit të tyre, ata kishin trajnime në fushën e operacioneve paqeruajtëse së bashku me eprorët dhe ushtarët turk, si edhe trajnim për qitje me armë këmbësorie të ushtrisë së Turqisë. Më 16, 17 gusht të vitit 2002, me fluturim special të Armatës turke, eprorët tanë në përbërjen e ISAF-it shkuan në Kabull. Në mision ishin deri me 27 dhjetor të vitit 2002, kur edhe u krye zëvendësimi i oficerëve tanë të shtabit në ISAF me oficerë të ri të shtabit: kapiteni Marijan Ugrev dhe togeri Vase Paçemski. Pas qëndrimit prej katër muaj e gjysmë

në Kabull, dhe përfundimit me sukses të detyrave, eprorët-pjesëmarrës të Maqedonisë në misionin e parë historik paqeruajtës u zëvendësuan me të rinj. Pas mbarimit të misionit, eprorët e Maqedonisë u vlerësuan me nota të larta për detyrat e kryera me sukses edhe para 22 vendeve-anëtare të ISAF-it e përfaqësuan ARM-në si pjesëmarrëse të barabartë. Në 20 dhjetor të vit 2002, kapiteni Marjan Ugrev nga Brigada e parë e këmbëtorisë dhe togeri Vasko Paçemski, shkuan në Turqi dhe iu bashkëngjitën batalionit turk në Afganistan në përbërjen ISAF. Me këtë Republika e Maqedonisë dhe ARM-ja vazhduan të kontribuojnë konkretisht në luftën kundër terrorizmit botëror dhe në ruajtjen e paqes.

bëtar ISAF-3 në Afganistan, në përbërjen e kontingjentit gjerman. Ekipin e vogël të zgjedhur të ARM-së, e përbënin: togeri Feto Bajrami, rreshteri më i vjetër Xhemail Demiri dhe ushtarët profesionist Marjan Markoski, Halil Babiç, Mirçe Efmov, Goce Georgiev, Stojance Jankov, Dejan Sekulov, Shpend Hamiti dhe Toni Trajkovski. Me vete morën bindjen se do të japin maksimumin për stabilizimin e paqes dhe zhvillimin e demokracisë në Afganistan, por edhe të dëshmojnë se ARM-ja është e denjë për të punuar me ushtritë më të fuqishme dhe se ecën me hapa të mëdhenj në drejtim të arritjes së qëllimit për anëtarësim të plotë në NATO. Paqeruajtësit tanë, "leopardët" si njësi formative e parë e ARM-së, kishin çuar pjesëmarrjen tone të mëtijshme në misionin paqeruajtës për të ndihmuar popullin afgan si dhe vendos-

Brk2."leopardët," nga 7 gusht 2003 deri në 19 shkurt 2004, nën komandën e kontingjentit gjerman.

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, 5 shkurt 2004 e miratoi vendimin e pestë (apo të tretë) për dërgimin e njësisë së ARM-së në misionin paqeruajtës ISAF-5 në periudhën nga shkurti deri në gusht 2004. Mandej pasonin edhe seksione të tjera në nivel togu dhe klase deri në dërgimin e njësisë së parë në nivel të regjimentit të përbërë nga "skorpionët" nga Shtipi në vitin 2006. Në të gjitha këto kontingjente ndiqej me kujdes përfaqësimi etnik i eprorëve dhe i përbërjes së ushtrisë.

Forcat ndërkombëtare për përkrahjen e sigurisë në Afganistan - Kabul Brigada Shumëkombëshe, kishin një detyrë shumë komplekse në zonën e saj të përgjegjësisë e cila shtrihej në qytetin e Kabullit dhe rrethinën e tij.

Për realizimin e misionit, pjesëtarët e klasës së parë i kishin detyrat e mëposhtme si prioritet: Mbështetjen e institucioneve qeveritare në ofrimin e sigurisë dhe stabilitetit në Kabul dhe rrethinën e tij, ofrimin e ndihmës në ndarjen e ndihmave humanitare popullatës në zonën e përgjegjësisë; ndihmë, trajnim dhe asistencë në kryerjen e detyrave të rregullta të forcës policore, ndihmë në sigurimin e stafit në terren dhe stafit mjekësor, ndihmë në zbatimin e projekteve të CIMIC, së bashku me kontingjentet e tjera ushtarake dhe civile.

VLERËSIME TË LARTA DHE MIRËNJOHJE

Pjesëtarët e kontingjenteve të parë të Maqedonisë morën mirënjohje të merituar për shkathtësitë e tyre të jashtëzakonshme dhe profesionalizmin në kryerjen e detyrave, që u



NJËSIA E PARË E ARM-SË NË MISION PAQERUAJTËS

Dëshira për participim në misione paqeruajtëse me njësi më të vogla të udhëhequra nga NATO-ja, shumë shpejt u realizua. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në janar 2003, e miratoi vendimin e tretë ose vendimin e parë për dërgim të njësisë së parë të ARM-së në mision paqeruajtës. Në periudhën shkurt - gusht të vit 2003 nga përbërja e Brk2. "leopardët" u përgatit dhe u dërgua seksioni i parë i këmbëtorisë si pjesë e kontingjent gjerman të Brigadës Multinacionale Kabull- ISAF-3. Në 7 mars të vit 2003, seksioni i Brigadës së Dytë të Këmbëtorisë së ushtrisë shkoi në një mision gjashtë-mujor paqeruajtës ndërkom-

jen e paqes në përbërjen e kontingjentit nacional gjerman në Brigadën Multinacionale në Kabull. Pjesëmarrja në misionet paqeruajtëse në Afganistan, si edhe mirënjohjet që erdhën prej atje, parasegjithash nga kontingjenti gjerman në kuadër të dilit zhvillohej misioni, ishin edhe një dëshmi për rezultatet e arritura të pjesëtarëve të ARM-së. Madje, vetëm me punë dhe rezultate fitohet emër, reputacion dhe imazh i mirë, siç gëzonin pjesëtarët e këtij dhe kontingjentit tjetër në misionin ISAF.

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në korrik të vitit 2003 miratoi vendimin e katërt (ose të dytë) për dërgimin e njësisë së ARM-së në misionin paqeruajtës ISAF-4. Në misionin morën pjesë seksioni i këmbëtorisë nga



arritën falë trajnimit dhe përgatitjes cilësore të tyre për kryerjen e misioneve.

Sipas trajnimit, përgatitjes fizike, përdorimit të armëve, ushtarët tanë ishin krah për krah me ushtarët gjermanë dhe ushtarët tjerë. Konfirmim më i mirë për këtë, ishin shprehja e komplimenteve nga oficerë gjermanë dhe dekoratat e çmimit e larta që u janë dorëzuar paqeruajtësve tanë. Vlerësimet dhe çmimet për angazhimin tonë në ruajtjen e paqes dhe realizimin e detyrave thelbësore të misionit në të gjitha rotacionet në nivel seksioni dhe togu, vetëm i konfirmuan gatishmërinë, moralin e lartë, profesionalizmin dhe përgatitjen fizike të pjesëtarëve të ARM-së, të cilët denjësisht e prezantuan jo vetëm Armatën por edhe Republikën e Maqedonisë.

R.M.



INTERVISTË



I PARI NGA TË PARËT

MAJOR FETO BAJRAMI, KOMANDANT I KLASËS SË PARË TË ARM-SË QË SHKOI NË AFGANISTAN



K

ur togeri Feto Bajrami, sapo kishte përfunduar Akademinë Ushtarake të RM-së, por me shumë entuziazëm dhe dëshirë për të arritur diçka që do të jetë shumë e rëndësishme në jetë, u gjend në mesin e "leopardëve" të Kërçovës, sigurisht se nuk kishte imagjinuar se do të jetë lideri i pare i ekipit, klasës së pare të cilën Republika e Maqedonisë dhe ARM-ja e dërguan në mision paqeruajtës të udhëhequr nga NATO-ja. Toger i ri, por tashmë me përvojë, duke kaluar paraprakisht trajnime intensive në Brmk2, shkoi që të shkruaj faqet e reja të ARM-së, Kontingjenti i ARM-së i udhëhequr nga Bajrami, misionin e filloi nën komandën e kontingjentit gjerman në mis-



ionin ISAF, i cili shumë shpejtë u shndërrua në mision i NATO-s. Kështu togeri Bajrami u bë komandanti i parë i kontingjentit që shkoi në mision paqeruajtës dhe si i tillë do të mbetet i shënuar në analet e ARM-së.

Ishit komandant i kontingjentit të parë të ARM-së në misionin ISAF 3. Çfarë nënkupton konkretisht kjo për ju?

- Prej atëherë kaluan gati 10 vjet, por mbaj mend gjithçka sikur ka ndodhur dje. Për Afganistanin, kontingjenti i Maqedonisë në nivelin klasë shkoi në një mision gjashtëmujor në kuadër të kontingjentit gjerman më 7 mars, 2003. Atëherë isha toger, i pamartuar, me shumë entuziazëm në vetvete. Kjo ishte eksperiencia e parë, sfida e parë e tillë, kjo nuk harrohet kurrë.

Përsëri isha në mision nga korriku 2007 deri në janari i vitit 2008, këtë herë si komandant i kontingjentit në nivel regjimentit, ashtu që, në të dy misionet, isha përfaqësues kombëtar më i vjetër i ARM-së. Të dy misionet kanë qenë në shumë mënyra të veçantë. Në misionin e parë e thymem "akullin", sepse për herë të parë ushtarët, gjegjësisht formacioni i nivelit të klasës shkoi në mision jashtë vendit në mbështetje të misionit ISAF. Misionin atëherë e udhëhiqte një komb udhëheqës (lider ishte Gjermani). Pas 10 gushtit 2003 misionin e mori përsipër NATO-ja.

Kur kontingjenti i Maqedonisë për herë të parë shkoi në misionin ISAF, detyrat e caktuara i kryente vetëm në Kabul dhe rrethinë,

kurse në misionin e dytë në të gjithë Afganistanin, kur u shpeshuan sulmet nga ana e talebanëve. Vetëm për krahasim, gjatë misionit të parë patrullonim nëpër Kabul me automjete, kurse gjatë misionit të dytë, ishim të detyruar të mbanim mbrojtëse personale dhe patrullonim me automjete të blinduara "hermelinë" të cilët "skorpionët" nga Shtipi i sollën këtu në vitin 2006.

Cilat ishin detyrat tuaja konkrete gjatë misionit të parë?

Në të dy misionet pretendonim të fitojmë besimin e popullatës lokale dhe ia arritëm qëllimit, pavarësisht se rebelët shumë rëndë dalloheshin nga qytetarët e zakonshëm, për shkak se ato janë pjesë e tyre. Megjithatë, mbështetja dhe bashkëpunimi me popullatën lokale ishte në nivel maksimal. Ka pasur shumë raste kur për kërcënimet për sulme na njoftonte popullata.

Në misionin e parë, detyra e kontingjentit të Maqedonisë ishte që të sigurojë lidhje të vendosura në kodrën Tevehil, e cila e ndan Kabulin në jugor dhe verior. Shpesh së bashku me ushtarët gjermanë patrullonim nëpër Kabul, siguronim bazën e NATO-s. Ndonjëherë kemi pasur edhe patrulla zbulimi në pjesën lindore të Kabulit, ku ishte stacionuar ushtria afgane, të cilat kontribuan për afrimin e ushtarëve të Maqedonisë me trupat afgane. Edhe sot i mbaj mend këto shoqërime, tubime të përbashkëta çaji dhe biseda. Ata mësuan fjalë maqedonisht, kurse ne e mësuan gjuhën Darin-Taxhi.

Kishit shumë ndodhi në atë periudhë. Çfarë ju kujtohet më së shumti?

- Në një moment, patrullonim së bashku me pjesëtarët e ushtrisë gjermane. Kur një ushtar gjerman nga pakujdesia u plagos vetë. Një nga ushtarët tanë i dha ndihmën e parë. Ai e bëri atë në mënyrë të shpejtë dhe me shkathtësi, pastaj në spital kur u dërgua ushtari, mjekët konstatuan se ndihma e dhënë ishte vendimtare për shpëtimin e jetës së ushtarit. Ky ishte ri, atëherë ushtar profesionist, Toni Trajkovski, i cili fitoi lëvdatë dhe dekoratë nga aleatët tanë.

Shkuat përsëri në Afganistan si komandant i kontingjentit të Maqedonisë, këtë herë në nivel të njësisë. Sa ka kontribuar përvoja juaj në kryerjen efikase të detyrave?

- Të gjithë punonim si një. Kjo është tipike jo vetëm për "Leopardët", por për të gjithë ushtarët e Maqedonisë. Kësaj radhe kontingjenti kryente sigurimin komplet të bazës dhe Komandës së Kabulit, si dhe patrullimin e zonës më të gjerë të përgjegjësisë në qarkun e policisë në zonën 10, sigurimin e konvojeve të organizuara nga ambulanca në bazë dhe në detyra tjera.

Në asnjë moment në drejtim të kryerjes së detyrave nuk dalloheshim nga ushtarët tjerë në misionin ISAF. Ndoshta ne nuk ishim aq të pajisur mirë, por trajnimi ynë cilësor dhe përshtatshmëria reale e situatës, e kombinuar me njohurit tona paraprake për bashkëjetesën këtu, na mundësoi në shumë punë të jemi edhe përpara tyre. Kjo

kontriboi të gjithë 126 ushtarë të jenë të lavdëruar dhe të marrin medaljen e NATO-s për pjesëmarrjen në misionin ISAF.

Keni fituar përvojë të çmuar dhe të pazëvendësueshme. Sa kjo përvojë ju ndihmon në punën e përditshme në njësi?

- Tani jam përsëri në mesin e "leopardëve" nga Batalioni i 3-të i mekanizuar i këmbësorisë. Isha dhe ngela "Leopard" dhe mendoj se gjithmonë do të jem kështu. Nga momentet e para pas kthimit isha i përfshirë në mënyrë aktive në përgatitjen e njësisë për misione, përmes organizimit të trajnimit apo në përgatitjen e instruktorëve për trajnim. Ne përqipemi që të përgatisim



maksimalisht ushtarët tanë të cilët dërgohen në mision, për shkak se qëllimi kryesor është pjesëtarët e kontingjentit të kthehen shëndoshë e mirë në shtëpi. Ndër të tjerat, i informojmë ushtarët në lidhje me atë që ndodh në të vërtetë në Afganistan që me kohë të shqyrtohen rreziqet e mundshme dhe të merren masa preventive dhe masa tjera e reagime nga kërcënimet e mundshme.

Kur flasim për Afganistanin, njerëzit tanë e kanë të vështirë të kuptojnë situatën reale që në të vërtetë ndodh atje. Të jetohet dhe të punohet 24 orë në ditë gjatë gjashtë muajve në mision do të thotë shumë. Ka një proverb popullore që e reflekton më mirë realitetin. Ajo thotë: "Vetëm ai që është në tenxhere, mund të shijoj gjellën." Prandaj, përvojat e fituara në Afganistan ose në misione të tjera, janë jashtëzakonisht të rëndësishme.

Pas kthimit nga misionet ushtarët tanë kanë horizonte të gjera dhe shumë më ndryshe i perceptojnë gjërat në shtëpi. Ato janë përfitimet tona nga misionet. Sot kënaqësia ime më e madhe është që të ulem në kafe- bisedë me ato me të cilët unë kam qenë në mision dhe të bisedojmë për gjëra të përditshme. Mua veçanërisht më kënaq fakti që njerëzit më respektojnë dhe shpesh më pyesin mua për opinion ose këshilla. Unë kurrë nuk kam refuzuar për tu dalë në ndihmë.

V. D.



USHTARËT E PAQES, TË SUKSES

ME PAQERUAJTËSIT TANË DHE AMBASADORËT MË TË MIRË

PAS GJURMËVE TË "LEOPARDËVE" DHE "SKORPIONËVE" TË BRMK1.

Brigada e parë e mekanizuar e këmbësorisë është njësisia e ARM-së e cila e para ka filluar dërgimin e pjesëtarëve në më shumë misione paqeruajtëse jashtë Republikës së Maqedonisë. Në vitin 2002 për herë të parë nga pjesëtarët e saj dërgoi një oficer shtabi në misionin ISAF në Afganistan. Në vitin 2003 një klasë e Brmk1. u dërgua në mision IRAQI FREEDOM. Në vitin 2006, përveç oficerëve të shtabit të saj në misionin ISAF, Brmk1. e dërgoi kontingjentin e saj të parë të madh

prej 90 ushtarëve dhe oficerëve në të njëjtin mision. Në vitin 2008, kontingjenti i ISAF-it u rrit në 127 anëtarë, dhe nga viti 2009 deri më sot, Brmk1. dy herë në vit dërgon kontingjent prej 150 anëtarëve të stafit në Afganistan. Në maj të vitit 2007, për herë të parë në historinë e pavarur të Maqedonisë, Brmk1. dërgoi oficerin e saj të shtabit në misionin UNIFIL nën përbërjen e organizatës së parë në botë përgjegjës për ruajtjen dhe promovimin e paqes në botë, gjegjësisht në Organizatën e Kombeve të Bashkuara e cila, madje, është edhe e vetmja organizatë në të cilën është anëtarë Republika e Maqedonisë.

Republika e Maqedonisë ka marrë dhe akoma merr një numër të madh të lëvdatave dhe çmimeve për pjesëmarrjen e saj në luftën kundër terrorizmit global dhe ruajtjen e paqes në botë, kurse Armata e Republikës së Maqedonisë, mirënjohje për disiplinën, nivelin e lartë të trajnimit dhe angazhimit të stafit në kryerjen e detyrave të caktuar në këto misione, jo vetëm për oficerët e shtabit por edhe kontingjentet e saj në tërësi.

Shumica e personelit të Brmk1. në këtë mision, përveç medaljeve të rregullta për pjesëmarrje në misione, u kthyen edhe me medalje për angazhim të veçantë dhe

ARMATA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË, VEÇANËRISHT ME PJESËMARRJEN NË NATO, BE DHE NË MISIONET PAQERUAJTËSE TË OKB-SË KA ARRITUR REZULTATE TË LARTA, TË NJËJTA ME SECILËN ANËTARE TË NATO-S, KURSE PJESËMARRËSIT NË MISIONE JANË ÇMUAR SI LUFTËTARË TË PAQES SHUMË PROFESIONAL DHE TË SUKSESSHËM. SHUMË PREJ TYRE FITUAN DEKOARATA PËR REZULTATET E ARRITURA.

KËSAJ RRADHE BISEDOJMË VETËM ME DISA PREJ TYRE, EDHE PSE TË GJITHË PJESËMARRËSIT NË MISIONET PAQERUAJTËSE, SI DHE ATA TË PRANISHËM NË STËRVITJET NDËRKOMBËTARE DHE STËRVITJET TJERA, JO RASTËSISHT NJIHEN SI AMBASADORËT MË TË MIRË TË RM-SË NË BOTË



SHËM DHE SHUMË PROFESIONAL

TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË



MR. SIMEON MITREV
MITKO VASILEVSKI

sakrificë në kryerjen e detyrave të caktuara dhe të rrezikshme gjatë realizimit të misioneve.

Përveç medaljes së veçantë, "Medalje ekspedicionale për luftën kundër terrorizmit", nga ambasada e SHBA në Afganistan, në janar të vitit 2009, fituan dekorata edhe majori Vasil Mitevski nga Batalioni i Inxhinierisë, kapiteni Sasho Spasovski, rreshteri më i vjetër Bekim Limani, dhjetari Orce Petkovski dhe dhjetari Arben Dalipi nga bnmk1.

"Të gjithë ata, së bashku me personelin e një regjimentit të këmbëorisë të mekanizuar nga bnmk1. me një shkallë të

pasigurisë së mjedisit të ri, siç deklaroi rreshteri i vjetër, Bekim Limani, në misionin ISAF në Afganistan kanë shkuar në korrik të vitit 2008. Shkuarja në misionin, që kishin dëgjuar shumë nga kolegët e tyre të cilët ishin pjesë e kontingjenteve të mëparshme, për ta ishte një sfidë e madhe. Por e gjithë kjo pasiguri dhe sasi e caktuar e frikës, zhduket pas mbërritjes në Afganistan dhe pas qëndrimit disa ditore në mision, derisa të njoftohen me detyrat dhe me zonën e përgjegjësisë", tha rreshteri Limani.

Përveç kryerjes së detyrave të tyre të rregullta, nëpërmjet qendrës operative të

misionit ISAF në komandën kryesore në Kabul, në nëntor 2008, të gjitha njësitë morrën njoftim për shpërthim e makinës bombë pranë ambasadës amerikane në Kabul. Pas marrjes së informatës, meqë vendi i shpërthimit i përkiste zonës së përgjegjësisë së kontingjentit të Maqedonisë menjëherë u aktivizuan forcat për reagim të shpejtë (QRF – Quick Reaction Force), ku në detyrë në atë kohë ishin këta anëtarë të bnmk1. për vetëm pak minuta, dy autobлиндat ("hermelinë") të kontingjentit të Maqedonisë, me ekipet e tyre, të parët arritën në vendin e shpërthimit, para të gjitha organeve e tjera të

cilat duheshin të reagojnë në situata të tilla, policia afgane dhe disa njësi të tjera, thotë rreshteri i vjetër Limani.

Menjëherë pas mbërritjes në vendin e shpërthimit, ata e siguruan vendin e ngjarjes dhe i kryen të gjitha procedurat e tjera sipas Procedurave Standarde Operative (PSO) për situata të tilla dhe të ngjashme. Të parët i siguruan informatat e nevojshëm për qendrën operative të misionit ISAF.

Pas mbërritjes në vendin e shpërthimit të makinës bombë, kujtohet rreshteri më i vjetër Limani, kishte gjashtë civilë të vdekur dhe disa civilë të plagosur, qytetarë të Kabulit.

Për reagimin me kohë dhe kryerjen me sukses të detyrës, në janar të vitit 2009, pak para përfundimit të misionit të tyre gjashtë-mujor, pesë anëtarët e kontingjentit të Maqedonisë kanë qenë të ftuar nga ambasada amerikane në Kabul. Në një pritje të përzemërt në ambasadën amerikane, nënkoloneli i ushtrisë amerikane Othell Hamlett ju ndau medaljet për përkushtimin dhe sakrificën e tyre për kryerjen e detyrave në kuadër të misionit.

Gjatë misionit gjashtë-mujor ka pasur situata të tjera ku na është kërcënuar edhe jeta, kujtohen dhjetarët Petkovski dhe Dalipi të cilët kanë nga dy misione gjashtë-mujore në ISAF. Pavarësisht rreziqeve, ne jemi të gatshëm me njësitë tona të marrim pjesë në çdo mision kudo në botë, deklaruan Petkovski dhe Dalipi.

"FENIKS" – SFIDË PËR MË TË MIRËT

Misioni "Feniks" na mbushi me krenari për shumë gjëra. Do të përmendim vetëm

disa: 1. ai ishte misioni i parë i përbashkët me pjesëtarët e Armatës së SHBA-së, 2. pjesëtarët e misionit kryenin me sukses shumë detyra jashtëzakonisht të rëndësishme; 3. numër i madh i pjesëtarëve të misionit kanë fituar dekorate për aftësitë dhe profesionalizmin e lartë të demonstruar.

"Feniks" - komponenta në misionin ISAF është detyra operative më komplekse e cila u është besuar pjesëtarëve tanë, kurse për nga përmbajtja më e pasur me ngjarje, bisedojmë me disa prej tyre, për të na përcjellë për atë që pikërisht ka ndodhur, si janë zhvilluar gjërat, për rreziqet, kontakte, shoqërimet, përgjegjësitë, shpërblimet. Të gjithë janë dakord në një gjë: se ARM-ja në Afganistan është një forcë serioze marrin pjesë në kryerjen e detyrave në prani të ushtrive më të mëdha dhe më të fuqishme se ajo, participon në mënyrë të barabartë dhe në të njëjtën kohë i zbaton ato në maksimum profesionalisht dhe për këtë merr trajtimin që ajo e meriton.

Këtë herë diskutojmë vetëm me disa pjesëmarrës në mision pjesëtarë të Batalionit Renxhera, të Regjimentin për Operacione Special dhe Batalionin e Policisë Ushtarake.

"Kam marrë pjesë në misionin 'Feniks' nga marsi i vitit 2010 deri në tetor të vitit 2010, tha rreshteri më i vjetër nga Batalioni i Renxherëve, T. A. jam dekoruar me medaljen e NATO-s. Ishte misioni ynë i përbashkët me Gardën Kombëtare të Vermont-it. Para se të nisemi për në Afganistan ishim në përgatitje të përbashkëta këtu në Republikën Maqedonisë, si dhe në SHBA. Në bazë ishim bashkë me kushte të njëjta për të gjithë ushtarët. Në një mis-



ion tejet të vështirë të gjithë në mënyrë korrekte bashkëpunim, pavarësisht përkatësisë kombëtare dhe fetare. Veçanërisht më impresionuan kontaktet miqësore me popullatën në Afganistan në zonën ku ne vepronim. Shpesh pinim çaj me përgjegjësit e fshatit. Për fat të mirë, çdo gjë kaloi pa probleme. Afganistani është i ndryshëm nga të gjitha përvojat e mia të mëparshme. Shumë i ndryshëm. Tani jam në Maqedoni. Jam i lumtur që jam pjesë e ARM-së dhe gëzohem me jetën familjare me bashkëshorten dhe me djalin tim". Edhe anëtarët e Batalionit të Policisë Ushtarake gjithashtu e provuan pluhurin e rërës afgane. Njerëz të mëdhenj për detyra të mëdha, bashkëbisedues të sinqertë, shumë mirë të njoftuar me detyrën



që duhet të kryejnë, thuajse një zëri tregonin për episodet e përbashkëta, larg nga toka amtare, sfidat e pafundme afgane, surpriza të pakëndshme dhe ngjarje që mund të kërcënojnë jetën.

Rreshteri më i vjetër, Sinisha Krstevski, kapiteni Krunislav Velkov dhejtari Oliver Spirkovski, rreshteri më i vjetër Blagoj Gjeorgjiev, në bisedë rasti me ne u kujtuan në "episodin e fuqishëm afgan" nga jeta e tyre ushtarake dhe na treguan shumë detaje interesante. Misioni zgjati nga 1 prill deri në 24 nëntor të vitit 2010. NATO / ISAF medalja dhe simboli luftarak SAV për luftime të drejtpërdrejta, janë dekorata që mund me zili të shikohen edhe nga pjesëtarët e ushtrive të shumta. Ishin vendosur në provincën Parvan në avio-bazën "Bagram". Dy

kanë pasur takime të drejtpërdrejta me talebanët dhe me formacionet tjera terroriste në atë pjesë të Afganistanit dhe kanë arritur me veprimet e tyre luftarake të kontribuojnë që sulmet në kryeqytetin Kabul të reduktohen për nëntëdhjetë për qind. Pjesëtarët e ARM-së, së bashku me pjesëtarët e armatës amerikane, kanë qenë komandantët e departamenteve dhe udhëheqës të ekipeve dhe kanë arritur të menaxhojnë në mënyrën më të mirë të mundshme zbatimin e detyrave, duke kryer misionin deri në fund pa asnjë humbje. Të gjithë pajtohen se: duke pasur parasysh ekskluzivitetin e Afganistanit si një rajon i trazuar dhe problemi i sigurisë që mund lehtë të përparoj, ARM-ja arriti në mënyrë të përkryer të pozicionuar edhe në "Feniks" të demonstroj

është shumë i ndryshëm nga rajoni ynë. "Asgjë nuk është e lehtë, sipas bashkëbiseduesve tanë. Paqja nuk vjen vetëvetiu. Është e vështirë të sigurohet, por gjëja më e vështirë është të ruhet ajo. Shpresojmë se afganët do të kujtojnë kontributin tonë në sigurimin e të drejtave të tyre civilizuese. Ne u përpoqëm maksimalisht në këtë drejtim". Të gjithë pajtohen me një gjë: Se të gjithë anëtarët e Batalionit të Policisë Ushtarake, janë të përgatitur për çdo sfidë të ardhshme.

EKIPET-TRAJNUESE MOBILE DEMONSTRUAN AFTËSI TË LARTA

Profesionalizmi, kompetenca, qasja sistematike në transferimin e njohurive u ndihmon shumë pjesëtarët e Batalionit të Policisë Ushtarake për të demonstruar aftësitë e tyre speciale edhe në kuadër të misionit ISAF në Afganistan, si instruktorë për trajnimin e ekipeve-trajnuese mobile të policëve të mundshëm ushtarak për nevojat e ushtrisë afgane.

Misioni kompleks fisnik, i niveluar profesionalisht, praktikisht dhe teknikisht që i ka kushtëzuar policët tanë ushtarak që të kenë sukses në mënyrën më përfaqësuese të demonstrojnë njohuritë e tyre, duke u vënë në shërbim të forcave aleate në mënyrë që të trajnojnë armatën afgane dhe të japin kontribut konkret në zhvillimin dhe organizimin e policisë ushtarake afgane.

Bisedat për këtë temë të veçantë i zhvillonim me komandantin e Batalionit të Policisë Ushtarake, nënkolonelin Robert Tasevski, vetë pjesëmarrës dhe lider në mision.



grupe me nga 16 njerëz të ndarë në dy detashmente kan kryer detyrat në zonat urbane, jashtë kanë siguruar bazën, patrullonin, kontrollonin check-pika, kryenin desante ajrore, kanë përcjellë ndihma humanitare për popullatën lokale, kanë kërkuar persona të arratisur, kanë vënë pusi, kanë siguruar objekte dhe baza të ndara, kanë dhënë roje "të vdekur". Mision jashtëzakonisht i rrezikshëm në të cilin secili prej pjesëtarëve të kontingjentit kishte individualisht mbi njëqind e pesëdhjetë misione jashtë bazës në orarin njëzet e katër deri më shtatë ditë. Kjo përfshin shumë aktivitete komplekse që kanë nevojë për përgatitje të madhe psikofizike dhe aftësi për tu përgjigjur shpejt sfidave që më së shumti ndodhin në pjesë të sekondës. Kontaktet me popullatën në këto rrethana nuk ishin saktësisht të pastra. Fiset taxhi dhe pashtun të përçarë dhe të ndarë mes veti, janë përbërja etnike e asaj pjese të Afganistanit. Policët tanë ushtarak

aftësi luftarake të denjë për respekt. Batalioni i Policisë ushtarake është formacioni i shkëlqyeshëm ushtarak si pjesë e ARM-së, i cili me kompaktësinë, kolegjalitetin dhe sinqeritetin, gjë të cilën e kemi parë në vepër. Mendim i përgjithshëm është se e njohin shumë mire profesionin e vet. Në mënyrë flasin për përgatitjet e tyre të plota para se të nisen në mision. Ndër të tjera, janë "kalitur" shkëlqyeshëm me njohjen e gjeografisë së Afganistanit, karakterit etnik-fetar të grupeve etnike të atjeshme, me natyrën e grupeve terroriste, si dhe rugët e lëvizjeve, platformën teorike të talebanëve dhe veprimet e tyre operative dhe deri te natyra e trullit në Afganistan dhe përbërjen kimike të vendit të bardhë që kanë parë në atje. Absolutisht dakordohen njëzëri se ky mision ka qenë një përvojë e madhe, e pazëvendësueshme. Ky, madje, është një tipar i të gjithë atyre që të paktën një herë, nën flamurin e vendit tonë, kanë shkuar në misione paqeruajtëse në rajonin që në thelb,



Kursi aktual për trajnimin e pjesëtarëve të policisë ushtarake të Afganistanit është projekt i justifikuar plotësisht, i cili është planifikuar të zgjasë deri në vitin 2014, ku thuhet se kjo kohë është e mjaftueshme për trajnimin e këtij lloji për nevojat e ushtrisë afgane. "Ne ofronim udhëzime, mentorim pjesëtarë të policisë ushtarake të Afganistanit përmes kurseve të ofruara



nga dy javë për trajnim dhe aftësim për kryerje të detyrave me sukses të lartë. Obligim i tyre mbetet që të transmetojnë njohurit e fituara dhe të trajnojnë pjesëtarët e tyre. Udhëheqës në këtë kurs ishin kroatët, dhe përveç nesh kishte edhe pjesëtarë të armatave të tjera: Armata e Shqipërisë, Malit të Zi dhe BeH-së. Gjatë punës përdornim vetëm gjuhën angleze për komunikim dhe për mësimin e materies së paraparë, u ligjëronim një grupi personash mjaftë inteligjent që besojmë se ia kanë dalë të kuptojnë thelbin e kursit të synuar dhe për të funksionuar profesionalisht në këtë drejtim. Në ligjerata udhëtonim çdo ditë, të shoqëruar me shumë rreziqe. Për fat të mirë, nuk kemi pasur ndonjë incident serioz që ka mund të rezultojë me pasoja të rrezikshme, me viktima apo tragjedi të çdo forme“.

Sipas bashkëbiseduesve tanë, është interesante se në armatën afgane mund të shiheshin edhe një numër i pjesëtarëve të gjinisë femërore. Ndër dëgjuesit, mund të kishte edhe anëtarë të grupeve terroriste me armë të fshehta. Instruktorët dhe pedagogët tanë gjatë kurseve, të veshur me roba të rëndomta dhe pa armë ishin të eksponuar ndaj rreziqeve të ndryshme, të cilët, me shkathtësi të madhe i tejkaluan.

“Ishte mision shumë i rrezikshme, shton nënkoloneli Tasevski, sepse nuk mund gjithmonë të depërtosh në mendjen e dëgjuesit në kurs, në mentalitetin e tyre, duke kuptuar se janë ritur në një rajon të traumatizuar shumë, ku jeta e njeriut gjith-

monë pak ka qenë me vlerë dhe duhet shumë pak për të fyer ndenjen e dikujt, që të kapë armë për të krijuar një kaos të vërtet“.

Edhe bashkëbiseduesit tjerë në mënyrë eksplicite u përpoqën të na rrëfejnë përvojat personale nga prania e tyre në Afganistan.

Për rreshterin e vjetër Sase Toshevski ky ka qenë misioni i parë nga shkurti deri në shtator të vitit 2012. I dekoruar nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Andres Fog Rasmussen edhe nga komandanti i kontingjentit, kolonel Tomislav Galic nga Armata kroate. “Ne ishim të vendosur në zonën e Kabulit, Darulaman, në një zonë

të siguruar mirë. Për fat të mirë, ne nuk ndjejmë çka do të thotë sulm i drejtpërdrejtë, dhe nga baza ne dilnim thuajse çdo ditë, duke udhëtuar deri në vendin e trajnimit, “thotë rreshteri i vjetër Tosevski, duke i paraqitur me krenari përvojat e tija nga misioni ISAF. Ai dhe kolegët e tij, rreshteri i vjetër Jovica Kolevski, rreshteri i vjetër Kire Nikolov dhe rreshteri i vjetër i klasit të I-rë, Robert Banskoliev kanë pasur detyra të shumta: bënë trajnimin, siguronin instruktorët, siguronin personalitetet VIP. Për gjithë këtë angazhim janë dekoruar me “simbol Bronzi” nga shefi i Shtabit të përgjithshëm të ARM-së, që është grupi i parë që kolektivisht i është



dhënë ky çmim pas kthimit nga misioni. Kanë edhe shumë diploma të dhëna nga agjenci private RONCO, të merituar në bazë të sigurimit të VIP-personave gjatë qëndrimit në misionin ISAF në Afganistan. Ky për nga përmbajtja është ndoshta misioni më specifik i pjesëtarëve të ARM-së në Afganistan. Aktiviteti shumëdimensional ku dominonte pjesa e mësimdhënies, nëpërmjet kurseve për edukimin e pjesëtarëve të Armatës afgane. Multinacionaliteti edhe i këtij misioni i afirmoi potencialet e larta të armatës sonë për të këmbyer përvojat por edhe për të fituar përvoja të reja



ushtarakë edhe në të ardhmen të paraqiten si adutë seriozë të ARM-së për nevojat e misioneve të cilat i udhëheq aleanca e NATO-s në rajonet kritike ku kërkohet profesionalizëm në biografinë e ushtarit.

Edhe më herët, në kuadër të njëjsteve tjera, përfaqësuesit e Policisë Ushtarake të ARM-së kanë kryer detyrat e policisë ushtarake në Afganistan. Do të nënvizohet ajo se i pari mes tyre në mision gjashtëmujor në këtë vend, ishte flamurtari Goranço Angelevski.

Në Kabul, në vitin 2008, në mision ushtarak-policor ishte edhe ushtarja profesioniste Dushica Aleksova. Aji shumë qetë u përgjigjet pyetjeve rreth qëndrimit të saj në mision. Zëri i dridhet kur rrëfen për rastin kur iu afrua një vajzë afgane me dorë të përgjakur. Në patrullë ajo ishte gruaja e vetme dhe vajza ndjeu se pikërisht Dushica do ta ndihmojë. "U afrua, thotë ajo, me besim në sytë e saja. Unë ia lidha dorën e prerë. Nuk e di pse, por kjo ngjarje nga episodi i jetës ushtarake, ende me kujtohet. Ndoshta për shkak të besimit të vajzës se pikërisht un duhej ti ndihmoja".

"UJQËRIT" DHE "RENXHERËT" NGA ROS TË PAZËVENDËSUESHËM

Në Irakun e post-konfliktit, në kuadër të forcave ndërkombëtare përgjegjëse për organizimin e jetës në këtë vend, të krijojnë dhe promovojnë demokracinë, të ruajnë vlerat civilizuese dhe të sigurojnë të ardhmen e këtij vendi nga Lindja e Mesme, u gjetën edhe pjesëtarët e ARM-së. Si vend-kandidat për anëtarësim në NATO dhe anëtare e Partneritetit për Paqe, R. e Maqedonisë tërësisht e vuri në dispozicion potencialin e saj ushtarak për të ndihmuar forcat aleate në Irak.

Në fillim "ujqërit", e pas tyre "renxherët" e Maqedonisë nga Regjimenti për Operacione Speciale të ARM-së, u gjetën në këtë pikë të re pozicionuese, traumatike në hartën e sigurisë dhe paqes globale.

Kapiteni N.V. nga batalioni i Renxherëve ishte në mision në Irak dy herë. Misioni i parë "Iraku 4", nga dhjetori 2004 deri në qershor të 2005, dhe i dyti "Iraku 10" nga dhjetori 2007 deri në qershor 2008. Duke bërë dallim serioz në mes këtyre dy përvojave të tija në Irak, kapiteni na tha se misioni i dytë ishte shumë më i lehtë se sa i pari, se ka pasur një ndryshim serioz

nga kolegët e tyre në drejtim të bashkëpunimit të mëtejshëm dhe ndërveprimit "nën ombrellën" e NATO-s. Duke pasur parasysh vështirësinë e detyrave që pjesëtarët tanë i kryenin në misionin në Afganistan, kjo na jep të drejtë të konstatojmë se kemi kapacitete të mëdha në aspektin njerëzor, të cilët në zonat më të rrezikshme, nga pikëpamja e sigurisë globale, mund me sukses të prezantojnë ARM-në dhe të lënë përshtypje mbresëlënëse me veprat e tyre të cilat i realizojnë në mënyrë profesionale. Batalioni i Policisë Ushtarake është partner i respektuar nga homologët e tij, ushtritë mike që së bashku kryejnë angazhime larg vendit amë. Andaj nuk është asgjë e pazakontë që policët tanë



në zhvillimin e demokracisë irakiane mes këtyre dy misioneve dhe se jeta ushtarake ishte shumë më e organizuar gjatë misionit të dytë. Për misionin "Iraku 10", ai u dekorua me medalje për përkushtim ARCOM. Sipas tij, të dyja misionet ishin të ngjashme, në të njëjtin vend, ku gjendet kampi "Taxhi", 20 km në veri të Bagdadit. Me përkushtim dhe përgjegjshëm i ka kryer detyrat, ishte krenar që e afirmonte ARM-në. Ai gjithashtu theksoi se kolegët e tyre amerikanë i pranuan me gjithë zemër si partnerë, me besim absolut. Ende i kujtohen buzëqeshjet e fëmijëve të atjeshëm, kur u dhuruan topa futboll, çanta shkollë, çokolata etj. Kapiteni është i martuar dhe ka një vajzë. Thirrja profesionale kërkon gjithmonë të jetë gati për sfida të reja edhe nëse ata janë përsëri në shkretëtirën e Irakut në rrethana krejt të ndryshme.

Rreshteri i vjetër nga batalioni i renxherëve, J.O., gjithashtu dy herë ka "ngrënë" bukë misionari në Irak. Ka marrë pjesë në misionin "Iraku 6" nga dhjetori 2005 deri në qershor 2006 dhe "Iraku 11" nga qershori 2008 deri në dhjetor 2008. Në misionin e parë është dekoruar me medaljen AAM për arritje, dhe në të dytin ka marrë medaljen ARCOM. Në të dy misionet ishte në të njëjtin vend të njohur në bazën "Taxhi". I kujtohen mirë kontaktet me irakianët, jeta në bazë, largësia nga të dashurit. Megjithatë, më tepër i kujtohen takimet në kohën e lirë me miqtë e tij amerikan. "Rregullisht i fitonim amerikanët në futboll, thotë ai, shokët dhe kolegët tjerë nga vende të ndryshme ishin shpesh bashkë lojtarët tanë. Misioni i dytë na mundësoi komunikimin në internet, bibliotekën, pishinën. Iraku është shtet konservativ fetar, megjithatë shumë më i hapur se shumë vende arabe në atë pjesë të botës".

Nga batalioni për dedikime speciale, apo ndryshe "ujqërit" një nga bashkëbiseduesit tanë ishte majori B. N. Nga qershori 2006 deri në dhjetor 2006 ai mori pjesë në misionin "Liria e Irakut 7". Andaj, ky oficer i lartë i ushtrisë sonë u kthye krenar me medaljen për angazhim ARCOM. Përkrahja e misionit për paqe në bashkëpunim me amerikanët i ka zgjeruar horizontet profesionale, takimi me një kulturë të re, i ka zgjeruar njohuritë në të gjitha aspektet. "Para së gjithash, mësova shumë për amerikanët, për armatën amerikane, për logjistikë dhe fleksibilitetin e tyre të shquar në misione dhe për të gjitha ndërhyrjet kohore që i bëjnë ata më të suksesshëm në realizimin e detyrave të planifikuara. Në kushte tejet të ndërlikuara të motit, kur i nxehti verës arrinte deri në 70 gradë celsius në diell, demonstrim përgatitje të larat psikofizike dhe arinim rezultate të shquar në aktivitetet e



planifikuara. Megjithatë, jeta e organizuar mirë në bazë na ndihmoi edhe atje, larg vendit tonë, të jetojmë një jetë që të paktën i përngjan asaj të zakonshmes. Tani jam i martuar dhe kam një vajzë", ishin fjalët e këtij "ujku" nga radhët e ARM-së. Edhe I.M. nga Batalioni i Forcave Speciale me krenari u lavdërua me mision "Iraku 1", i cili zgjati nga qershori 2003 deri në dhjetor 2003 dhe "Iraku 8", i cili zgjati nga dhjetori 2006 deri në qershor 2007. Medalja ARCOM është atribut edhe i dekoratave të tija, a baza "Taxhi" ish vendi ku morri pjesë dy here dhe e zhvilloi profesional-

dëgjuar për Maqedoninë dhe ushtarët tonë në misione në vendin e tyre ato i respektojnë shumë. Kurrë nuk do ta harroj atë komunikim njerëzor me irakienët. Misionin e dytë e trajton ekskluzivisht cilësorë në të gjitha fushat: kuzhinë të jashtëzakonshme, internet kafene, komunikime interpersonale të shpeshta. E ka vizituar Babilonin dhe Tikrit në kompleksin e Sadam Huseinit, e njëh mire Zonën e Gjelbër në Bagdad. Transporti në misionin e dytë në relacionin Taxhi-Bagdad është kryer me helikopter, i cili ka paraqitur probleme të veçanta nga pikëpamja e sigurisë për ato rrethana. Kurrë nuk do të harroj as pushimin tre ditor në Katar, i cili i është dhënë si pjesë e misionit. Ai është i martuar dhe ka një fëmijë.

Pjesëmarrja e paqeruajtësve tanë në misionin "Liria e Irakut" është padyshim një përvojë e madhe për ta, kurse ARM-ën e pozicionon definitivisht në vertikalen e ushtrive profesionale dhe të respektuar. Edhe këtë nga armatat më të mëdha, më të fortat, drejt të cilave synon, dhe pa dyshim e meriton këtë vend. Ky mision u ishte besuar profesionistëve tanë të përgatitur më mirë, të aftë që edhe në të ardhmen t'u përgjigjen sfidave identike. Regjimenti për Operacione Special është faktor kyç në realizimin e këtyre fakteve



izim e vet. Misioni i parë do të mbetet në kujtesë e tij, sipas kontakteve të shumta me popullatën lokale të Irakut, nga ajo se mentaliteti i tyre është mjaft i ngjashëm me tonin, ato janë miqësor, ato kanë

të rëndësishme të ARM-së që synojnë efikasitetin, promovimin dhe produktivitetin e saj, edhe në rajonet e sigurisë ekskluzivisht të vështira dhe komplekse siç është tani Iraku. ★

SHEMBULLI PËR PROFESIONALIZMIN DHE PUNËN EKIPORE



MISIONI ISAF NË AFGANISTAN NË NIVEL REGJIMENTI

Si rezultat i pjesëmarrjes në misionin ISAF të realizuar me sukses dhe të vlerësuar lartë, nga gushti 2004 deri në fund të vitit 2006, ARM-ja ka marrë pjesë me një togë të mekanizuar të këmbëtorëve nga njësia "leopardët". Bazuar në vlerësimet e Aleancës në pjesën e njësive të deklaruar të ARM-së, të cilat i kanë aritur standardet strikte të kërkuara në drejtim të trajnimit dhe procedurave operative dhe në pajtim me Konceptin e Aftësie Operative (KAO), Armata e Maqedonisë në qershor të vitit 2006, për herë të parë në misionin paqeruajtës dërgoi një njësi të nivelit të regjimentit, gjegjësisht një regjiment të mekanizuar të këmbëtorëve, pjesë e Brigadës së Parë të mekanizuar të këmbëtorëve, në kuadër të kontingjentit britanik në ISAF. Në mision morën pjesë 6 oficerë, 15 nënoficerë dhe 69 ushtarë profesionistë, të cilët ishin trajnuar dhe pajisur me mjetet e nevojshme materialo-teknike për realizimin e suksesshëm të detyrave të caktuara. Komandanti i njësive së parë të ARM-së në nivelin regjimentit ishte kapiteni Stojançe Kostov. Qëllimi i misionit ishte kryerja e operacioneve për qetësim në mënyrë që të krijohet një mjedis i sigurt dhe të lehtësohen aktivitetet për ndihmë humanitare të organizatave ndërkombëtare qeveritare dhe jo-qeveritare. Besimi i dhënë nga Britania e Madhe për nëntëdhjetë "skorpionët" e Brigadës së parë të këmbëtorëve tërësisht u arsyetua. Njësia me sukses e realizoi misionin në zonën e përgjegjësisë në rajonin e kryeqytetit të Kabulit në Afganistan. Qëllimi i misionit

ishte të kryhen operacione stabilizuese në mënyrë që të krijohet mjedis i sigurt dhe të lehtësohen aktivitetet për ndihmë humanitare të organizatave ndërkombëtare qeveritare dhe jo-qeveritare.

Të gjithë pjesëmarrësit në misionin ISAF-9, nga Ministria e Mbrojtjes, u shpërblen me të holla prej 1200 dollarësh amerikan.

Njësia, për misionin e realizuar me sukses, u vlerësuan lartë nga oficerët e lartë të komandës kryesore të ISAF-it në Afganistan. Mirënjohje gjithashtu morën nga komandanti i KOB dhe komandanti i brmk1. për kryerjen me sukses të misionit.

Në rotacionin e dytë të Regjimenties për sigurimin e komandës së ISAF-it, Republika e Maqedonisë e rriti numrin e pjesëmarrësve prej 90 në 127, a nga janari i vitit 2008, dërgoi edhe tre oficerë shtabi në Komandën e ISAF-it në Kabul.

Në rotacionin e 13-të të misionit paqeruajtës ISAF në Afganistan, ku ARM-ja merr pjesë me regjimentit të mekanizuar të këmbëtorëve, në korrik të këtij viti shkuan 149 pjesëtarët e Brmk1, të cilët së bashku me përfaqësuesin kombëtar më të vjetër janë vendosur në Komandën kryesore të ISAF-it në Kabul.

Në gjashtë muajt e ardhshëm, paqeruajtësit e Maqedonisë do t'i realizojnë detyrat brenda kontingjentit ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar, ku do të jenë përgjegjës për sigurimin e Komandës kryesore të forcave të ISAF-it në Kabul.

Ushtarët e Maqedonisë në Afganistan konsiderohen si pjesëtarë të rëndësishëm të ekipit ISAF. Puna e tyre u bë shembull i profe-

sionalizmit, punës ekipore, përshtatshmërisë dhe guximit, që mund të kenë zili shumë pjesëtarë të vendeve anëtare të NATO-s të cilët shërbejnë së bashku me ta. Duke marrë pjesë në misionet shumëkombëshe, ushtria e Maqedonisë tregon se paraqet një forcë tërësisht operative, mirë e trajnuar dhe e cila është e përgatitur me partnerët e NATO-s t'u përgjigjet në mënyrë efektive kërcënimeve të sigurisë globale.

Përvojat e vlefshme që i fituan udhëheqësit dhe personeli tjetër nga pjesëmarrja në misionin paqeruajtës ISAF në Afganistan do të përdoren në realizimin e planeve për punë dhe aftësim profesional ushtarak të stafit tjetër të njësive, në mënyrë që të krijohen kushte për pjesëmarrje të vazhdueshme në misionet paqeruajtëse.

R.M.



"LEOPARDËT" E ARSYETUAN BESIMIN E DHËNË NË AFGANISTAN



ku i kryejnë detyrat e tyre funksionale. Në këtë kontekst, dua të përmend deklaratën e Shefit të Shtabit të Komandës kryesore të ISAF-it, gjeneralit Bavinkov, gjatë vizitës së tij në kontingjentin e Komandës kryesore ISAF, i cili theksoi: "Ndjehem i sigurt në Komandën kryesore të ISAF-it, sepse ajo është e siguar nga ushtarët e kontingjentit të Maqedonisë që kryejnë një detyrë shumë të rëndësishme. Kjo në fakt ju bën ato nga më të mirët në botë".

Nga kontaktet e mia dhe takimet punuese unë gjithashtu marrë vlerësime dhe përshtypje pozitive për bashkëpunimin e krijuar dhe zbatimin e detyrave të besuara të të gjithë pjesëtarëve të Armatës së Republikës së Maqedonisë. Ushtarët dhe eprorët denjësisht e paraqesin profesionalizmin e ndërtuar dhe trajnimet e fituara në drejtim të bashkëpunimit dhe promovimit intensiv të Armatës së Republikës së Maqedonisë para partnerëve. Rezultatet nga niveli i arritur i ndërveprimit janë pasuria jonë më e madhe në aspiratat e marrjes së statusit anëtare e plotë e aleancës së NATO-s.

INTERVISTE

ME PËRFAQËSUESIN KOMBËTAR TË VJETËR TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË NË MISION, NËNKOLONEL KIRO KALKOV

Kontingjenti i Maqedonisë në Afganistan hyri në muajin e katërt të misionit gjashtëmuor në Komandën kryesore të ISAF-it, duke realizuar një nga detyrat më të ndërlikuara dhe më të përgjegjshëm. Vazhdimisht, nga viti 2006, misioni për sigurimin e Komandës kryesore të forcave ISAF në Afganistan, si detyrë i është besuar kontingjentit të Maqedonisë. Ushtarët dhe eprorët nga dymbëdhjetë rotacionet janë më shumë se krenar për besimin e dhënë dhe përgjegjësinë e caktuar për sigurimin e Komandës kryesore, të vetëdijshëm për përpjekjet e dhëna dhe përpjekjet e paraardhësve të tyre në ndërtimin e imazhit dhe karakterit të paqeruajtësve të Maqedonisë, a në të njëjtën kohë të denjë para detyrave dhe sfidave të vazhdueshme për gjetjen e zgjidhjeve për të krijuar ambient më të sigurt për funksionimin e Komandës kryesore të ISAF-it. Angazhimi dhe qasja e ushtarëve të Maqedonisë në kryerjen e detyrave janë elemente të njohura dhe të vlerësuara lartë nga strukturat komanduese të ISAF-it në Afganistan, nga autoritetet shtetërore dhe ushtarake të Maqedonisë, por edhe nga qytetarët e Republikës së Maqedonisë. ValORIZIMI i demonstrimit të profesionalizmit, aftësive luftarake dhe nivelin e gatishmërisë së kontingjentit në Afganistan, paraqet qëllimin më të fortë për afirmimin dhe përpjekjet në përgjithësi të shoqërisë për integrim në strukturat e sigurisë së NATO-s.

Për përfshirjen e trupave tona në misionin ISAF në Afganistan, bisedojmë me përfaqësuesit kombëtar të vjetër të Republikës së Maqedonisë në mision, Kiro Kalkov.

Zotëri nënkolonel, si kontribuon Republika e Maqedonisë në misionin ISAF në Afganistan?

- Maqedonia jep kontribut të pamohueshëm në krijimin e paqes, stabilitetit dhe vlerave demokratike të Afganistanit, me pjesëmarrjen aktive dhe dërgimin e forcave të Armatës së Republikës së Maqedonisë, në lokacione të ndryshme dhe me mision të ndryshëm. Në misionin ISAF aktualisht Armata e Republikës së Maqedonisë përfaqësohet me: një Regjiment të Mekanizuar Këmbësorie me 150 pjesëtarë në Komandën kryesore të ISAF-it, pesë mentorë në forcën e dedikuara për partneritet dhe këshillim në Mazari Sharif, dy oficerë shtabi në Komandën e bashkuar të aeroportit KAJA dhe dy instruktorë për trajnim në shkollën e policisë ushtarake. Pjesëmarrja e vazhdueshme e Republikës së Maqedonisë me forcat e saj e bën një kontribues të rëndësishëm në arritjen e objektivave të misionit ISAF në Afganistan.

Si e vlerësojnë partnerët tanë praninë dhe kontributin e Armatës së Republikës së Maqedonisë në misionin ISAF në Afganistan?

- Armata e Republikës së Maqedonisë, siç u përmend më parë, merr pjesë me forcat e saja në aksione të ndryshme të operacioneve në misionin ISAF. Njësitë dhe ekipet tona janë të shpërndara në vende të ndryshme dhe janë nën komanda të ndryshme, por krenohemi kur dëgjojmë vlerësime të larta për punën e eprorëve tanë. Partnerët përdorin çdo mundësi për të shprehur mirënjohje dhe kënaqësi për kontributin e ARM-së në kuadër të komandave dhe njësitë të ISAF-it,

Si është bashkëpunimi i kontingjenteve tona me pjesëmarrësit tjerë në misionin ISAF në Afganistan?

- Nga fillimi i vendosjes së forcave tona në territorin e Afganistanit, ushtarët dhe eprorët e Maqedonisë gëzojnë reputacion të larta dhe atë e paraqesin në formë të bashkëpunimit dhe ndihmës reciproke me kolegët nga ushtritë e tjera pjesëmarrëse. Bashkëpunimi me pjesëmarrësit tjerë në misionin ISAF realizohet në nivelin e duhur dhe të gjitha sferat. Shkurt thënë, paqeruajtësit e Maqedonisë e arsyetuan dhe e verifikuan besimin e dhënë nga partnerët në Afganistan. Realizimi i detyrave nënkupton përgatitje të vazhdueshme dhe cilësore të pjesëmarrësve në mision për të jenë në gjendje tu përgjigjen dhe të përmbushin në mënyrë adekuate qëllimet dhe besimin e dhënë kontingjentit tonë. Përgatitjet para dërgimit janë çelësi i suksesit të misionit, prandaj i përkushtohet vëmendje e madhe përzgjedhjes së duhur të personelit për pjesëmarrje në mision paqeruajtës, trajnimi luftarak dhe mësimi i aftësive të nevojshme.

Interesante dhe të paharrueshme janë përshtypjet e para nga periferia e Kabullit dhe udhëtimi deri në bazën e Komandës kryesore të ISAF-it, ku çdo gjë ishte e organizuar tashmë për rotacionin dhe pranimin-dorëzimin e detyrës së kontingjentit të ri. Ditët e trajnimeve të përbashkëta dhe shoqëria me miqtë dhe kolegët nga kontingjenti i vjetër mbaron. Vjen ditë për kthim në atdhe dhe në familje kurse kontingjenti i ri plotësisht merr përgjegjësinë për sigurimin e Komandës kryesore ISAF.

R.M.

REALIZIM CILËSOR I DETYRËS



INTERVISTE

ME KOMANDANTIN AKTUAL TË KONTINGJENTIT TË MAQEDONISË, NËNKOLONEL DUSHAN STANKOV

Për detajet e qëndrimit të misionit të Maqedonisë nga rotacioni i dymbëdhjetë në komandën kryesore të ISAF-it, në periudhën nga korriku 2012 deri në janar 2013, për detyrat dhe përgjegjësitë biseduam me komandantin e kontingjentit, nënkolonelin Dushan Stankov.

Zotëri nënkolonel, si komandant i kontingjentit, çka ju motivon më së shumti për kryerjen me sukses të detyrave të misionit?

- Detyrat që dalin nga misioni i kontingjentit, për mua, para se gjithash, paraqesin nder dhe kënaqësi për besimin e dhënë, por në të njëjtën kohë edhe obligim dhe përgjegjësi për kryerje të plotë dhe me sukses të detyrave. Në drejtim të arritjes së qëllimeve dhe pritjeve të misionit, unë do të doja të theksoj qasjen profesionale, mbështetjen dhe bashkëpunimi e eprorëve në komandën e regjimentit, komandantëve dhe të gjithë anëtarëve të kontingjentit. Bashkëpunimi dhe niveli i komunikimit me Komandën e grupit për përkrahje është në nivel të duhur dhe kontribuon edhe më tepër për realizimin e suksesshëm të detyrave. Madje, primare është kujdesi për anëtarët e kontingjentit, a imperativ më i lartë për mua është jeta dhe shëndeti i eprorëve dhe ushtarëve në mision dhe pëmbushja e premtimit dhe besimit të dhënë nga ana e eprorëve përgjegjës.

Çilat detyra, konkretisht, i kryen kontingjenti i Maqedonisë në kuadër të Komandës kryesore të misionit ISAF?

- Kontingjenti kryen aktivitete të rregullta për sigurimin e perimetrit të jashtëm të bazës, nga kullat e caktuara për vëzhgim, patrullimin

në zonën e përgjegjësisë, sigurimin e gatishmërisë së forcave për reagim të shpejtë, kontrollin në hyrje dhe në pjesën e pasme të bazës, kontrollin në hyrje për këmbësorët dhe sigurimin e zonës së klasifikuar të Komandës kryesore ISAF.

Regjimenti, gjithashtu, angazhohet për sigurimin e vizitave të larta të komandës kryesore të ISAF-it, vetëm gjatë këtij viti janë realizuar vizita nga Sekretari gjeneral i NATO-s, kryeministra, ministra, senatorët dhe kongresistët nga vendet e huaja, si dhe zyrtarë të lartë të qeverisë së Afganistanit.

Gatishmëria luftarake e regjimentit kontrollohet vazhdimisht dhe bëhen ushtrime për

reagime dhe kohën e arritjes së forcave për reagime të shpejta, përmes ushtrimeve në nivel të regjimenteve dhe ushtrime mujore me angazhimin e të gjitha elementeve të grupit mbështetës të bazës. Me një fjalë, regjimenti është e vetmja forcë e armatosur e cila është tërësisht përgjegjëse për bazën e Komandës kryesore të ISAF-it.

Çilat janë planet dhe udhëzimet tuaja për kohën e ngulur të misionit?

- Regjimenti vazhdon të kryejë detyrat e rregullta dhe detyra shtesë, në përputhje me komandën operative për angazhim dhe procedurat standarde operative që lidhen me punën e regjimentit. Mendoj se në periudhën e kaluar me sukses i zbatuam detyrat e caktuara dhe punojmë vazhdimisht për të përmirësuar kushtet e punës, avancimin e vendeve të punës dhe ngritjen e nivelit të gatishmërisë së regjimentit. Mirënjohje për punën tonë dhe realizimin e detyrave profesionalisht, me kënaqësi na u dhanë gjatë vizitës së fundit nga gjeneral Bavinkov, Shefi i shtabit të Komandës kryesore të ISAF-it. Siç thash më parë, prioritet për mua është jeta dhe shëndeti i eprorëve dhe ushtarëve të mi dhe pëmbushjen e premtimeve dhe besimit të dhënë nga ana e eprorëve të lartë. Uroj që të ngelet kështu, dhe në këtë formë të finalizojmë realizimin e misionit.

Redaksia e "Mburoja"-ës u falënderohet bashkëbiseduesve dhe u dëshiron realizim të qetë të detyrave të misionit. "Historia e suksesshme për misionin dhe rejtungun e "Leopardëve" në Afganistan vazhdon.

R.M.





TË GJITHË SI NJË

NËNKOLONELI MICE KOTESKI, UDHËHEQËS I DY KONTINGJENTEVE NË MISIONIN ISAF

Kur bisedojmë me nënkolonelin Mice Koteski, orët kalojnë si minuta. Edhe pse ka çka të thotë në lidhje me 12 muajt e kaluar, si komandant i dy kontingjenteve në misionin ISAF. Ai është fitues i medaljes së NATO-s për merita, por pavarësisht kësaj, ai më tepër flet për të tjerët. Gjithçka që fitova, thotë ai, është rezultat i punës së përbashkët. Prandaj, shton ai, medalja është mirënjohje për të gjithë anëtarët e kontingjentit të Maqedonisë.

Si pjesëtar i "leopardëve" të Kërçovës ishit udhëheqës i dy kontingjenteve të Maqedonisë në Afganistan, në vitin 2006 dhe 2007. Cilat janë përvojat tuaja nga ajo kohe, dhe si i shikoni sot misionet paqeruajtëse?

- Jam krenar për faktin që tetë vite isha anëtar i njësisë, pjesëtarët e të cilës me krenari e mbajnë emblemën me leopard dhe logon "Fuqi për Paqe". Mu dha nderi dhe kënaqësia e veçantë që të udhëheq dy kontingjente nga përbërja së kësaj njësie. Përvojat e misionit të suksesshëm shkojnë në drejtim të përzgjedhjes së kandidatëve që duhet ekskluzivisht të jenë në duart e komandantëve të togut dhe seksionit (sigurisht se do të zgjedhin më të mirët). Gjithmonë duhet t'u je-

pet përkrahje komandantëve të cilët do të udhëheqin misionin. Duhet patjetër të definohen kriteret e përzgjedhjes së personelit kyç, në veçanti elementet e mëposhtme: gatishmëria psikofizike, trajnimi, besnikëria, shpirti ekipor, aftësitë udhëheqëse, patriotizmi, përkushtim etj. Këtu përfshihet përdorimin i mësimëve të nxjerra nga kontingjentet e mëparshme. I kryem detyrat mirë, por sigurisht se mundet edhe më mirë. Gjithmonë ka vend për përmirësim. Aktualisht natyra e vendit të punës nuk më jep mundësi për të ndikuar në punën e kontingjenteve dhe nuk kanë informata të mjaftueshme në lidhje me punën e tyre gjatë kryerjes së detyrave.

Nga "leopardët" e Kërçovës në misionet paqeruajtëse kanë marrë pjesë rreth 1.000 pjesëtarë në misionet ISAF dhe "Liria e Irakut". Tani ata janë pjesë e Brmk1. Sipas jush për "leopardët" në të ardhmen do të dëgjohet edhe më shumë si një njësi më profesionale e ARM-së?

- Vështirë është të arrihen rezultatet të lartë në kontinuitet në mungesë të modernizimit të mjeteve nga të cilat është e pajisur njësia. Vend për përmirësim sigurisht se ekziston në segmente të ndryshme, para së gjithash në përzgjedhjen e

personelit, përgatitjen e njësisë, taktikave dhe teknikave për kryerjen e detyrave. Duke përdorur mësimet e nxjerra nga kontingjentet e përbërjes së ARM-së, por edhe përvojat e kontingjenteve të shteteve anëtare të aleancës së NATO-s. Fjala popullore thotë, me moshën vjen edhe urtësia, dhe "leopardët" nga viti në vit përparojnë dhe pres të arrijnë rezultate sa më të mira.

Ju jeni mbajtës i medaljes së NATO-s për shërbim të merituar. Kjo është medalja e parë e tillë që e merr një pjesëtarë i ARM-së. Me ç'rast e morët këtë medalje?

- Arsyeja për dhënien e medaljes për shërbim të merituar ishte pas pjesëmarrjes në dy misione, në vitin 2006 dhe në vitin 2007 me pushim të shkurtër më pak se gjashtë muaj. Kontingjentet vetëm ose të përzier kryen më shumë se 700 patrulla në këmbë ose me automjete në zonën e përgjegjësisë, dhe nuk ishte bërë asnjë aksident. Besoj se jeni dakord se kjo është për shkak të respektit. Pas dhënies së medaljes theksova, tani e përsëris, se unë jam mbajtës i medaljes për shërbim të merituar, ngase u munduan të gjithë pjesëtarët e kontingjentit të Maqedonisë. U munduan me profesionalizëm,



përgjegjësi, disiplinë dhe angazhimin e tyre për kryerjen e detyrave. Veçanërisht jam krenar për rezultatet e arritura, të realizuara me organizatat ndërkombëtare por edhe me organizatat qeveritare dhe jo-qeveritare në zonën e përgjegjësisë së njësisë.

Propozimi për dhënien e medaljes erdhi nga kolonel Brian Hejbig, komandant i grupit luftues për mbështetjen e Komandës së ISAF-it. Kah mesi i misionit ndjeja se do të ketë propozim të tillë. Komandanti shprehu kënaqësinë e tij ndaj pjesëtarëve të kontingjentit për punën tone të realizuar, jo vetëm me fjalë por edhe me vepër. Nuk lëshonte asnjë rast e të mos e vizitonte QTO- në tonë ose për të uruar ditëlindjen e dikujt, duke i dhënë dhuratë modeste paqeruajtësit nga zemra dhe me buzëqeshje.

Në ish zyrën tuaj në Kërçovë vendin qendror e zë një fotografi, ku ju jeni në shoqërinë e ushtarëve britanikë. Pse?

- Pas një muaji e gjysmë vëzhgim të kujdesshëm të punës së kontingjentit të

Maqedonisë, oficerët përgjegjëse të ushtrisë britanike morën vendim që seksioni i tyre të jetë nën komandën e regjimentit tonë. Kjo për mua ishte sfidë që kërkonte qasje të re, por edhe përdorimin më aktive të gjuhës angleze në punën e përditshme, veçanërisht në përgatitjen e dokumenteve në QTO-së. Të komandosh me ushtarët dhe eprorë- pjesëtarë të një armate të fuqishme, armatë me traditë të madhe, kërkonte investime të mëdha nga eprorët e komandës së regjimentit. Për befasinë time, pjesëtarët e kontingjentit britanik shpejt u përshtatën me situatën e re, e u trajnuan edhe të përdorin armë dhe pajisje të kontingjentit tonë. Gjithsesi, disa nga ushtarët tanë u trajnuan të përdorin armët dhe pajisjet e kontingjentit britanik. Kryenim trajnime të përbashkëta, por performonim edhe të shtëna situatash nga armët personale. Mësonim nga njëri-tjetri, sidomos në aspektin e taktikave dhe teknikave gjatë realizimit të detyrave. Komandanti i togut Aleks Horner, rregullisht shkruante për një revistë të tyre. Ai marrëdhëniet me anëtarët e kontingjentit të

Maqedonisë i përshkruan kështu: "Mendimi i paqeruajtësve të Maqedonisë është identike me pikëpamjen tonë për ushtarët amerikanë".

Komanda e regjimentit kishte krijuar një praktikë të shpallë ushtarin më të mirë nëpër seksione një herë në muaj. Aty i përfshimë edhe ushtarët britanikë. Ishte për t'u gëzuar fakti kur shihje se si një ushtari i forcave "Delta" me krenari mban shenjën e Leopardëve në revers. Kjo shihet edhe në fotografi. Madje, ne shpesh ftoheshim të marrim pjesë në patrullat e tyre. Në një rast, në kuadër të patrullës, ato ishin renditur për të rregulluar pajisjen "Bibi Marou" dhe kërkuan nga ne të bëjmë foto të përbashkët. Një apo dy ditë para largimit të tyre nga Kabull, para togut të rreshtuar komandanti i njësisë më dhuroi fotografinë e cila do të dekorojë përgjithmonë murin e zyrës sime të punës.

U përfshitë në mënyrë aktive në përcjelljen e përvojave për trajnim. Nga vitit 2007 jeni përfshirë në procesin e vlerësimit të njësisë të deklaruar si vlerësues i certifikuar për nivelin 1 dhe 2, gjegjësisht për të vlerësuar gatishmërinë luftarake dhe ndërveprimin?

- Me përgatitjen e njësisë për mision menaxhon komanda e njësisë por edhe komanda e brigadës ka rolin e saj. Në çdo njësi isha anëtar i grupit që është përgjegjës për përgatitjen e kontingjentëve. Duke ditur se çfarë detyre serioze kanë para vetit, përpiqesha maksimalisht që gatishmëria e njësisë të jetë në nivelin e duhur.

Eprorët përgjegjës të SHP të ARM-së dhe KOB i vërejtën përpjekjet e mia dhe vendosën të më dërgojnë në kurs për vlerësimin e njësisë të deklaruar ndërvepruese. Pas realizimit të disa vlerësimeve të suksesshme u dërgova në kurs për vlerësimin e gatishmërisë luftarake të njësisë të deklaruar. Fillova si pjesëmarrës në kurs, dhe përfundova me detyrën drejtor i vlerësimit NATO-2 të regjimentit të deklaruar për grupin luftarak të BE-së, për të cilën jam shumë krenar. Besoj se eprorët përgjegjës ishin të kënaqur me realizimin e vlerësimit, kurse të vlerësuarit do të fitojnë përvojë pozitive nga vlerësimi.

Cili do të ishte mesazhi juaj për pjesëtarët e ARM-së të cilët do të përgatiten në të ardhmen për pjesëmarrje në misione?

- Unë do t' u them një gjë, mund t' ju vjedhin thuajse çdo gjë, por nuk mund t' ju marrin dijen, aftësinë dhe shkathtësinë. Ata janë vetëm tuajat. Prandaj, vetëm me punë, mund, sakrificë, disiplinë dhe vetëbesim mund të luftoni për vend në kontingjentet e ardhshme të ARM-së në misione jashtë territorit të RM-së, duke siguruar paqen atje ku më së tepërmi nevojitet.

V.D.



NJË HAP PARA TJERËVE

MISION I PËRBASHKËT ME PJESËTARËT E GARDËS KOMBËTARE TË VERMONTIT



Faktet të cilat flasin për përgatitjen e pjesëtarëve tanë nuk janë më ndonjë risi ose e papritur. ARM-ja si shumë herë deri tani në misionin e caktuar, "Feniks", tregoi dhe dëshmoi se vendi ynë di se si të prodhojë kuadro të denjë gatishmëria e të cilëve është në nivelin e armatave të shteteve anëtare të aleancës së NATO-s. Për shkathhtësitë në mjedis multi-etnik, siç është Afganistani, janë madje edhe një hap përpara. Prandaj nuk ishte aspak befasues lajmi se 73 pjesëtarë të ARM-së janë dekoruar me medalje dhe mirënjohje. Në nëntë muajt, derisa ishin në mision, pjesëtarët në misionin e përbashkët me pjesëtarët e misionit të Gardës Kombëtare të Vermontit, SHBA, dhe të Armatës së SHBA-së, e vazhduan kontinuitetin parimorë, gatishmërinë, partneritetin dhe përgjegjësinë e Ushtrisë së Maqedonisë. Bëhet fjalë për një mision tejet kompleks, mision i cili në vetvete kërkon shumë përgatitje dhe energji. Të ndjekur nga nevoja për solidaritet dhe ndjenjë për përgjegjësi dhe princip, Republika e Maqedonisë pa hezitim pranoi partneritetin me Vermontin të shtrihet në një mision të ri dhe të ndryshëm. Të vetëdijshëm për situatën, por edhe të sigurt në besimin tonë, ne me të njëjtin intensitet vazhduam kontributin e madh të vendit tonë në misionet paqeruajtëse. "Përgatitjet cilësore të cilat u realizuan para nisjes, staf i zgjedhur mirë, si edhe realizimi i vazhdueshëm i të gjitha detyrave të caktuara nga të gjithë pjesëtarët të kontingjentit

të cilët individualisht kontribuan që misioni i caktuar të përfundojë me sukses dhe tërësisht, shprehet komandanti i forcave të dedikuara, majori Koço Hristovski. Si pjesëtarë i ARM-së, si gjithmonë më parë, ne arritëm të konfirmojmë përgjegjësinë, profesionalizmin dhe disiplinën tonë". Diversiteti i misionit "Feniks", në lidhje me të tjerat është evident. Pra, 79 pjesëtarët e Regjimentit për dedikime të posaçme(RDP) dhe të Batalionit të Policisë Ushtarake (bnPU), së bashku me kolegët e tyre, anëtarët e Gardës Kombëtare të Vermontit, SHBA dhe Armatës së SHBA-së, gjatë periudhës nëntë mujore realizuan misione në fushën e trajnimit dhe mentorimit të Armatës Kombëtare dhe Policisë së Afganistanit, pastaj realizuan operacione të përbashkëta në mbështetje të paqes dhe stabilitetit të këtij vendi, misione për sigurimin e personave të lartë të NATO-s dhe ISAF-it dhe së bashku me forcat e koalicionit të NATO-s dhe SHBA-së veprori në mbështetje të armatës dhe policisë afgane. Me përmeshjen e detyrave, pjesëtarët e misionit, siç ceku edhe shefi i ShP të ARM-së, gjeneral-majori Koteski, "dhanë kontribut të madh në mbështetje të stabilitetit dhe ndërtimin e demokracisë në Afganistan." Ajo që duhet më së tepërmi të na impresionojë është fakti se detyrat e kryera me sukses me të vërtetë nuk kanë kaluar pa u vënë re. Në anën tjetër, shkalla e lartë e profesionalizmit dhe guximit e treguar

gjatë këtij misioni kompleks ishin më shumë se arsye të mjaftueshme që Armatë e SHBA-së t'u ndajë medalje dhe dekorata 73 pjesëtarëve të ARM-së. Përveç kësaj, të gjithë anëtarët të cilët ishin pjesë e misionit të caktuar, nga ministri i Mbrojtjes morën monedha ari dhe argjendi, u ndanë edhe katër pllaka me logon e Ministrisë edhe atë Regjimentit për operacione special, batalionit i Policisë Ushtarake, "renxherëve" dhe "ujqërve". Pikërisht këto medalje dhe mirënjohje, të plotësuar me notat e larta për profesionalizmit e demonstruar në punën e përditshme, paraqet konfirmim për ndërveprimin e ARM-së me vendet anëtare të Aleancës së NATO-s.



Kontributi i Republikës së Maqedonisë në misionin ISAF nuk shihet vetëm përmes pjesëmarrjes së kontingjenteve në nivel seksioni, togu dhe regjimenti, por paraqet një kontribut të veçantë në më shumë fusha.

Përveç kësaj, në misionin ISAF, ARM-ja merr pjesë me oficerë shtabi nga gushti 2002. Në 12 rotacione morën pjesë 39 persona.

Në mbështetje të përpjekjeve për mirëmbajtje të Armatës Kombëtare të Afganistanit (AKA), duke filluar nga muaji mars 2008, Republika e Maqedonisë dërgoi dy pjesëtarë (një oficer dhe një nënoficer), si pjesë e Ekipit Mentor të Përbashkët Operativ Shumëkombëshe për ndërlidhje (OMLT) në Mazari Sharif.

Pjesëmarrja e Republikës së Maqedonisë dhe Armatës së Republikës së Maqedonisë në misionin paqeruajtës ISAF të udhëhequr nga NATO vazhdoi të rritet. Kështu që nga janari i vitit 2009, edhe 3 (tre) pjesëtarë të ARM-së (dy oficerë dhe një rreshter), si pjesë e Ekipit mentorues operativ për ndërlidhje (OMLT) u dërguan në rajonin Kunduz, për mentorimin e pjesëtarëve të AKA-së. Aktualisht në misionin OMLT-3 gjenden pesë mentorë në forcat e dedikuara për partneritet dhe këshillim në Mazari Sharif. OMLT është ekip operativ i eprorëve nga disa vende që kanë detyra secili në fushën e vet të punës dhe ekspertë për të këshilluar, mentoruar dhe ndihmuar personelin kyç



KONTRIBUTI KONKRET

MISIONE - ISAF

OMLT, PU NË KOMANDËN KAIA, SEEBRIG-U NË NIVELIN KOMANDUES NË AFGANISTAN

në komandat dhe shtabet e AKA-së rreth ndërtimit të sistemit të njëjësive për menaxhim, planifikim dhe realizim të operacioneve luftarake dhe trajnimeve, si dhe në fushën e funksionimit të rregullt të njëjësive.

POLIC USHTARAK NË KOMANDËN E KAIA

Nga 07.01.2009 Armata e Republikës së Maqedonisë ka deklaruar një pjesëtarë të Policisë Ushtarake në Policinë Ushtarake Ndërkombëtare në komandën e KAIA, Kabul, Afganistan. Pjesëtari i Policisë Ushtarake është pjesë e stafit të shtabit të ARM-së, së bashku me oficerin e shtabit të inxhinierisë për trajnim dhe lidhjet me AKA në komandën IJC, në bazën NORTH KAIA.

Nga 7 janar 2009, ARM-ja ka deklaruar 7 pjesëtarë të Policisë Ushtarake në përbërjen e Policisë Ushtarake Ndërkombëtare të Aeroportit Ndërkombëtar të Kabulit në komandën KAIA, që aktualisht është rotacioni i tetë i Policisë Ndërkombëtare të aeroportit të Kabulit në komandën KAIA.

Si anëtar i Policisë Ushtarake Ndërkombëtare të Aeroportit të Kabulit në komandën e KAIA, pjesëtari ynë i policisë ushtarake i kryen detyrat e caktuara në pajtim me (procedurat standarde operative për Policinë Ushtarake të Policisë Ushtarake Ndërkombëtare të Aeroportit Ndërkombëtar të Kabulit në komandën KAIA) dhe detyrat tjera në përputhje me pjesën tjetër të PSO (Procedurat standarde operative), së bashku me anëtarët tjerë të policisë ushtarake ndërkombëtare që vijnë nga vende të ndryshme, të cilët janë pjesë e

misionit paqeruajtës ISAF në Afganistan.

Policia ushtarake, përveç kryerjes së detyrave të tij në Policinë Ushtarake Ndërkombëtare të Aeroportit Ndërkombëtar të Kabulit në komandën KAIA, u jep mbështetjen të madhe e trupave tanë që janë në Afganistan.

Në periudhën nga 07.01.2009 e këndeje, pjesëtarët e ARM-së të cilët ishin polic ushtarake në Policinë Ushtarake Ndërkombëtare të Aeroportit Ndërkombëtar të Kabulit në komandën KAIA kanë qenë vazhdimisht të vlerësuar dhe shpërblyer nga eprorët përgjegjës të KAIA dhe nga komandantët e policisë ushtarake ndërkombëtare për angazhimin e tyre profesionale dhe realizimin e detyrave zyrtare.

R. Stojčeski



SEEBRIG NË NIVELIN E KOMANDËS SË AFGANISTANIT

Njëmbëdhjetë pjesëtarë të ARM-së, oficerë shtabi dhe nënoficerë shtabi ishin në operacione paqeruajtës në Afganistan, si pjesë e Komandës së Brigadës së Evropës Juglindore SEEBRIG-ut - në kuadër të Forcave Ndërkombëtare për mbështetje të sigurisë në Afganistan nën udhëheqjen e NATO-s në forcat e ISAF-it, në periudhën Janar-Gusht viti 2006. Ky ishte dërgimi i parë i njëjësive të SEEBRIG-ut në mision paqeruajtës.

Pas gatishmërisë fillestare operative, në mars të vitit 2004, gatishmëria e plotë operative u realizua me marrjen e certifikatës për aftësi të Komandës së brigadës për operacione paqësore, e vlerësuar nga Komanda e NATO-s në Napoli. Në tetor të vitit 2004, filloi faza e vendosjes së Komandës SEEBRIG, me pjesëmarrjen aktive të eprorëve të Maqedonisë në Komandën SEEBRIG. Prej atëherë ndryshoi edhe roli i SEEBRIG-ut nga njësi për siguri rajonale në njësinë për kontribut dhe forcim të sigurisë në zonat tjera të krizës në botë.

SEEBRIG KMNV IX kishte detyrat e mëposhtme: të përkrah qeverinë e Afganistanit në përpjekjet e saja për të stabilizuar vendin dhe rajonin; të mbështes OKB-në dhe organizatat tjera ndërkombëtare në ndërtimin e vendit, të kontribuoj në rritjen e sigurisë në Kabul dhe rrethinë; të përkrahë ekipet për rekonstruktive rajonale përmes aktiviteteve CIMIC. ★



sor dhe tre ndihmës dhe njëkohësisht edhe shoferë. Maqedonia, Shqipëria dhe Kroacia në ekip morën pjesë me një mjek, dy teknikë mjekësore dhe një ndihmës. Gjuhë zyrtare e ekipit ishte gjuha angleze, ndërsa vendi komandues rrotullohet mes çdo vendi, ashtu që ai do të jetë gjithmonë mjek nga vendi udhëheqës. Misioni zgjat gjashtë muaj për çdo rotacion.

Ekipi i parë i përbashkët mjekësor shkoi me 8 gusht të vitit 2005 nga Selaniku në Kabul. Kjo ishte pjesëmarrja e parë e ARM-së në mision me një kontingjent të përzier të paqeruajtësve. Deri më tani në Irak dhe Afganistan kemi dërguar njësitë të përbëra kryesisht nga ushtarë të Maqedonisë. Për herë të parë ARM-ja dërgoi femër në mision. Katër pjesëtarë të ARM-së (toger Sasho Kapsirev, mjek ushtarak, njëkohësisht edhe komandant i përbashkët i ekipit mjekësor, Daniela Kostovska dhe rreshteri më i vjetër i klasës të parë, Bajram Ademi, teknikë mjekësore dhe ushtarë profesional. Igor Mitkov, ndihmës), si pjesë e togut të përbashkët mjekësor të Maqedonisë,

PAQËRUAJTËSIT NGA BALLKANI

EKIPI I PËRBASHKËT MJEKËSOR I VENDEVE - NËNSHKRUESE TË KARTËS SË ADRIATIKUT NË MISIONIN ISAF TË NATO-S NË AFGANISTAN

Vendet e Kartës së Adriatikut: Maqedonia, Shqipëria dhe Kroacia, pranë vendeve të NATO-s: Greqisë, Bullgarisë dhe Rumanisë, jo vetëm që avancuan sigurinë rajonale, por japin edhe një kontribut konkret, duke u kyçur në mënyrë efektive në misionet e jashtme të NATO-s. Si hap i parë i përbashkët në arritjen e këtij qëllimi ishte dërgimi i një ekipi të përbashkët mjekësor si pjesë e forcave të NATO-s në misionin ISAF në Afganistan. Dërgimi dhe gatishmëria e togut të përbashkët mjekësor të Maqedonisë, Shqipërisë dhe Kroacisë në misionin ISAF në Afganistan,

paraqet një hap të rëndësishëm drejt ndërtimit të një sistemi mini-rajonal të sigurisë dhe konfirmim të aftësisë së grupit të Adriatikut për të kontribuar në stabilitetin dhe sigurinë në rajon dhe botë.

ARM-ja që nga viti 2002 ka deklaruar një klasë mjekësore për misionet paqeruajtëse të NATO-s dhe misionet PpP, të përbërë nga një mjek ushtarak, dy teknikë, dy ndihmës, të cilët janë edhe "operatorë për lidhje" me kurse të përfunduar për komunikim, dhe 2 ndihmës shoferë.

Ekipi është i përbërë nga 12 anëtarë, prej të cilëve tre mjekë, gjashtë teknikë mjekësor

Shqipërisë dhe Kroacisë, i cili numëronte 12 anëtarë në Afganistan (në kuadër të kontingjentit grek në ISAF), qëndruan 6 muaj.

Ekipi i përbashkët mjekësor kishte realizuar trajnim të përbashkët edhe në Shqipëri dhe Maqedoni, dhe në atë kohë anëtarët e ekipit u njoftuan, punuan së bashku dhe aplikuan të gjitha standardet në procedurat mjekësore, gjatë të së cilës ekipi tregoi gatishmëri të madhe dhe koordinim. Ai koordinim dhe gatishmëria në mënyrën më të mirë u dëshmuar gjatë qëndrimit në Afganistan. Atje, si pjesë e spitalit grek të terrenit, ata kishin kujdestari të përditshme në ambulancën e pranimit, duke u kujdesur edhe për pacientët në spital. Përveç kësaj, ata realizuan edhe detyra jashtë spitalit, siç janë: sigurim sanitar gjatë deminimit dhe Crash-crew-kujdestari për nevojat e aeroportit të aviacionit në përbërje të së cilit është edhe spitali. Si një ekip me përvojë më të madhe ishin angazhuar edhe MEDEVAC / CASEVAC-detyra, së bashku me marinsat italian.

"Misioni për të gjithë ne ishte një sfidë e madhe, kujton komandanti i ekipit të përbashkët mjekësor trepalësh në ISAF, Afganistan, major (atëherë toger) Dr. Sasho Kapsarev. Hera e parë që ne ishim në një mision të tillë të përbashkët edhe atë në përbërje të spitalit grek polonez. "Në spital kushtet e punës ishin të shkëlqyera, jemi pritur shumë mirë, mbi të gjitha, duke iu



MIRËNJOHJE PËR MISIONIN HUMANITAR

EKIPI KIRURGJIK I MAQEDONISË NË MISIONIN ISAF

falënderuar komandantit grek të spitalit, por edhe anëtarëve tjerë në përbërjen e stafit të përbërë prej rreth 50-anëtarëve të spitalit, së bashku me ne. Kemi kaluar gjashtë muaj të shkëlqyer.”

Gjatë misionit kishte më shumë ngjarje. Ekipi mori pjesë në mjekimin e personelit ushtarak dhe popullatës vendore në Kabul, sidomos të njerëzve të cilët ishin të përfshirë në deminim.

“Unë dhe Asan Bajram, tani flamurtar në ARM, në linjën tonë vendosëm një kontakt me zyrtarët amerikanë në Kabul dhe u kyçëm në 4-5 raste, në autokolona bamirëse të cilat i kishin organizuar amerikanët, dhe me materiale të cilat i siguruan amerikanët dhe me shoqërues nga ana e tyre, vizituam disa kampe të refugjatëve në afërsi të Kabulit dhe derisa kemi pasur mundësi për ato pak orë të qëndruar në ato pozita, refugjatëve që ishin aty u kemi ofruar ndihmë mjekësore. Vetë ato dalje dhe pjesëmarrja në këto konvoje dhe mjedisin në të cilin gjendeshim, barte një rrezik të madh, por megjithatë ne e kemi marrë, dhe me miqtë tanë amerikanë morëm pjesë në konvojet bamirëse. Si rezultat i kësaj, në fund të misionit kemi marrë falënderim nga gjenerali me katër yje “na tha Kapsarev.

Si rezultat i bashkëpunimit intensiv në fushën e shëndetësisë ushtarake të iniciuar në vitin 2007, dhe në bazë të Marrëveshjes së nënshkruar për mirëkuptim dhe Marrëveshjes teknike, më 2 dhjetor të vitit 2008 ishte dërguar rotacioni i parë i ekipit kirurgjik të Maqedonisë i cili ishte pjesë e ekipit norvegjez për rindërtim, në Mejmana, Afganistan. Ekipi kirurgjik u dërgua dhe u vendos me mbështetjeje e plotë logjistike nga Mbretëria e Norvegjisë.

Ekipi kirurgjik ishte i përbërë nga tre mjekë (dy kirurgë dhe një anesteziolog) dhe tre infermiere, të cilët në gjashtë muajt e kaluar realizonin detyra nga fusha e personelit deficitar me degë në kirurgjinë ushtarake të NATO-s.

Dërgimi i ekipit kirurgjik paraqet arritjet më të larta në bashkëpunimin bilateral me Norvegjinë - një partner i dëshmuar dhe mbështetës i fortë i përpjekjeve të Republikës së Maqedonisë për integrimin e plotë euro-atlantik.

Misioni i stafit mjekësor të ARM-së, si pjesë përbërëse e Ekipit provincial për rindërtim zgjati nga dhjetori i vitit 2008 deri në maj të vitit 2012. Gjatë asaj kohe ishin dërguar shtatë rotacione me gjithsej 42 persona. Të gjithë ata morën mirënjohje nga ekipi norvegjez për rindërtim dhe ISAF-i, ndërsa pjesëmarrësve në rotacionin e tretë të ekipit kirurgjik në misionin ISAF, në ceremoninë solemne në ministrinë e Mbrojtjes, iu ndanë çmime dhe pllaketa. Anëtarët e ekipit mjekësor këto mirënjohje i morën për veprimet e tyre të ndërmarra nga aspekti më human - për të shpëtuar jetën e njerëzve.

Dekorata “Medalja mbrojtëse norvegjeze për pjesëmarrje në mision” iu nda liderit të ekipit - kolonelit të pensionuar, Dr. Zlatko Pendovski nga ana e atasheut ushtarak të akredituar të Mbretërisë së Norvegjisë në Republikën e Maqedonisë, kolonel Esben As. Anëtarëve të mbetur të ekipit mjekësor, të përbërë nga

gjashtë persona, iu ndanë pllaketa për pjesëmarrje në mision.

“Ne me krenari mund të themi se si Armatë kemi arritur përmes rotacioneve të dërgueshme t’ua bëjmë të qartë të gjithëve se ne disponojmë me ekspertë profesionistë jo vetëm nga mbrojtja, por edhe nga fusha e mjekësisë, të cilët edhe në kushte substandarde në të gjitha aspektet, siç është për nga karakteri edhe vetë misioni në Afganistan, mund të përballen me detyrat dhe të jenë ndër më të mirët në kryerjen e tyre, theksoi me këtë rast ministri i Mbrojtjes, Fatmir Besimi. Paqeruajtësit tanë kanë një shkallë të lartë të profesionalitetit dhe integritetit dhe ata janë argumenti ynë më i madh për hyrje në NATO dhe për të promovuar Maqedoninë si një vend që investon në paqen globale.”

“Motivi më i madh për ne ishte të prezantojmë popullin e Maqedonisë si një popull i denjë dhe me përkushtim dhe të gjitha detyrat të cilat na ishin shtruar i kemi kryer sa më mirë që kemi mundur. Gjithashtu, jemi shquar edhe nga aspekti i shoqërimit me të tjerët, dhe kemi qenë të rrethuar edhe me norvegjezë - profesionistë me të cilët u bëmë edhe miq shumë të mirë”, tha kolonel Dr. Zlatko Pendovski.

Ekipi kirurgjik i Maqedonisë, i përbërë nga gjashtë persona, ishte pjesë e forcave të ISAF-it në gjysmën e parë të vitit 2010. Anëtarët e ekipit, së bashku me ekipet nga Norvegjia, SHBA-ja dhe Letonia ishin të vendosur në kampin Mejmanah në përbërje të ekipit norvegjez për rindërtim në provincën Farijab. Gjatë misionit ekipi kirurgjik i Maqedonisë realizoi disa aktivitete: pranim të të plagosurve dhe kryerje të disa intervenimeve kirurgjike emergjente, operacione në sallën e operimit, intervenime më të vogla kirurgjike, kontrolle, incizime rentgenologjike, analiza laboratorike-biokimike.

R.M.



Ekipi i parë i përbashkët mjekësor mori nota jashtëzakonisht të larta nga komanda përgjegjëse për pjesëmarrjen në misionin në Afganistan. Edhe për shtatë ekipet e ardhshme mjekësore (gjithsej 8 rotacione me pjesëmarrje të 32 personave) në kuadër të spitalit grek dhe atij çek në ISAF, nga Afganistani arritën nota të larta. Pra, nuk mund të jetë më ndryshe, me të gjitha njësitet e ARM-së të cilët e përfaqësojnë vendin tonë jashtë kufijve të atdheut të tyre. Gjithmonë janë në mesin e më të mirëve dhe janë shembull për të tjetër. Ata janë përfaqësuesit e vërtetë dhe ushtarë të paqes të ARM-së, të kohës së re.

K.I.





MEDALJE PËR PJESËMARRJE NË MISIONE "LIRI PËR IRAKUN" DHE ISAF





PROFILIZIM I ARMATËS SË RE

MISIONI “LIRI PËR IRAKUN”

Deri në vitin 2003 Armata e Republikës së Maqedonisë, duke ndërmarrë një sërë aktivitete reformuese, ngadalë por sigurtë tashmë është përshtat me kërkesat e kohës moderne dhe anëtarësisë kolektive. Në mënyrë të qartë ishin formuar konturet e ushtrisë së ardhshme të Maqedonisë: ushtri e vogël, e lëvizshme, efektive dhe ndërvepruese, ushtri e cila është në përputhje me ushtritë e vendeve anëtare të Aleancës, ushtri me thelbin qartë të përcaktuar të forcave të armatosura në njësitet speciale, ushtri e cila mund të marrë pjesë në misionet ndërkombëtare. Në skenën ndërkombëtare në atë kohë zhvilloheshin operacione në Irak për të



rrëzuar regjimin e Sadam Huseinit, të ndërmarrë nga ana e koalicionit antiterrorist të udhëhequr nga SHBA-të. Pas përfundimit të operacioneve kryesore ushtarake, rrëzimi i regjimit të Sadam Huseinit dhe miratimi i Rezolutës 1546 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe Republikës së Maqedonisë, me kërkesë të Qeverisë së SHBA-ve, ishte vendosur që RM me forcat e saja të marrë pjesë në misionin “Liri për Irakun”, si pjesë e koalicionit më të madh të luftës globale kundër terrorizmit. Vendimin për pjesëmarrje të ushtarëve të Maqedonisë në misionin “Liri për Irakun” e mori Kuvendi i Republikës së Maqedonisë.

Qeveria e SHBA-ve kërkoi mbështetje nga Republika e Maqedonisë për misionin në Irak sepse në teren ndjehej nevoja për pjesëtarë special të trajnuar të cilët do të kryejnë aktivitete të veçanta në kuadër të misionit.

Kur në maj të vitit 2003, 28 pjesëtarët e parë të ARM-së, të përbërë nga "ujqit" dhe "skorpionët", nga përbërja e përzier etnike, me fluturim special shkuan në Bagdad, askush nuk supozonte se me atë hapej një faqe e re e historisë së ARM-së. Me këtë hap, në të vërtetë, në mënyrë praktike filloi profilizimi i ARM-së së re, profesionale,

filin dhe imazhin e ri të ushtarëve të paqes. Edhe pse përbërja e kontingjentit nuk ishte e madhe, sipas karakterit të ekipeve të dërguara mund të konkludohet se në atë periudhë primati i operacioneve të ndërmarra në Irak ishte vendosur pikërisht në njësite speciale të vogla mobile me profesionalizëm të lartë, veçanërisht për kryerjen e detyrave në bashkëpunim me njësitin e Armatës së SHBA-ve.

Operacionet dhe aktivitetet të cilat i morën dhe i zbatuan pjesëtarët tanë zhvilloheshin në kuadër të të ashtuquajturës misionie paqeruajtëse, operacione për zbatimin e

jëherë pas kthimit në Shkup. "Ky njësit e realizoi atë që e pata premtuar para gjashtë muajve, se do të punojë profesionalisht, në mënyrë të vendosur dhe me përgjegjësi. Dëshmuam se njësit është i aftë të zbatojë operacione të këtitlla kudo dhe në të gjitha kushtet kohore. Ndërtuam bazë empirike e cila do të forcojë partneritetin të cilin Maqedonia e ndërton në rrugën drejt NATO-s.

"Nuk mund të përshkruaj se sa gëzim i madh është që më në fund arritëm në Maqedoni. Rezultatet të cilat i arriti kontingjenti i Maqedonisë janë të shkëlqyera, dhe rrallë mund ndonjë vend të lavdërohet me rezultate të këtitlla. Qëllimi më i madh të cilin e kemi arritur është ajo se të gjithë u kthyem gjallë dhe shëndoshë në Maqedoni, pa ndonjë ushtar të plagosur", ishin fjalët e majorit Zoran Sekulovski, sot kolonel, pas kthimit në Shkup. Majori Sekulovski ishte në Shtabin e forcave të koalicionit në Irak. Gjatë vitit 2003 dhe 2004 pjesëmarrja e ARM-së në misionin "Liri për Irakun" ishte e përfaqësuar me ekipe nga njësitet speciale "ujqërit" të cilët realizuan veprime të ndryshme nga fusha e luftës jokonvencionale, së bashku me ushtarët e divizionit të 4 të këmbësorisë të Armatës së SHBA-ve. Sipas hapave të kontingjentit të parë, në Irak u nis edhe kontingjenti i ri ushtarak i Maqedonisë, i përbërë nga 31 pjesëtarë të njësitit për veprime speciale "ujqërit" në misionin "Liri për Irakun".



moderne, të trajnuar mirë, të pajisur dhe para se gjithash e gatshme maksimalisht të përgjigjet ndaj sfidave të reja.

"Ujqërit", të cilët konsideroheshin si njësit i vetëm i ARM-së i cili mund të përgjigjet ndaj sfidave të reja, si dhe "skorpionët", të cilët gjatë ishin përgatitur për misionie paqeruajtëse në botë, ishin të gatshëm të shkolin. Me këtë rast, komandanti i kontingjentit, kapiten Metodija Haxhi Janev, theksoi se është krenar që do të udhëheq këtë kontingjent në një mision historik për vetë shtetin. Kjo do të jetë funksionalizim i të gjitha përpjekjeve të Maqedonisë për hyrje në NATO dhe mundësi për të treguar se çfarë ne mundemi, me ç'rast do të dëshmohet se Maqedonia është e gatshme të mban barë të përmasave të mëdha".

Pjesëtarët e kontingjentit ishin pjesë e divizionit të katërt të këmbësorisë amerikane, në afërsi të qytetit Taxhi. Më herët, në Bagdad përmes Kuvajtit udhëtuan oficerë për lidhje, major Zoran Sekulovski dhe nënkoloneli i Aviacionit ushtarak, Lupço Stojanovski.

Njësitit ynë i parë i profesionalizuar "ujqërit" (atëherë pjesë e Regjimentit për dedikime speciale, ndërsa sot pjesë përbërëse e Regjimentit për operacione speciale të ARM-së), ishte ai i cili shënoi një nga kapitujt më të rëndësishëm të etapës më të re të Republikës së Maqedonisë dhe Armatës së Republikës së Maqedonisë dhe e krijoi pro-

paqes, preventivë e konflikteve dhe operacioneve humanitare. Në kuptimin doktrinaro-ushtarak, operacionet për stabilizim dhe mbështetje të paqes, sipas përcaktimeve doktrinare të konceptit të Armatës së SHBA-ve përfshijnë një spektër më të gjerë të operacioneve (duke përfshirë edhe operacione për mbështetjen e paqes), ndër të cilat janë: lufta kundër terrorizmit, lufta kundër proliferizimit të armëve për shkatërrim masiv, operacionet informative, operacionet për mbështetje dhe operacione të tjera.

Gjashtë muaj më vonë, me nderimet më të larta në Aeroportin "Petrovec" në Shkup ishte pritur kontingjenti i parë nga 29 ushtarë të Maqedonisë, i cili ishte pjesë e forcave të koalicionit në Irak, nën komandën e SHBA-ve. Komandantët ushtarak të Maqedonisë në Irak arritën rezultate të larta dhe ishin ndër më të mirët në forcat multinacionale të koalicionit. Kontingjenti i ARM-së realizoi qindra misionie speciale, vetë dhe me forcat speciale amerikane. Ndër të tjera, ata në Irak kryenin edhe trajnime të ushtarëve amerikan për misionie të kërkimit, zbulimit të armatimit dhe ndërhyrje në vendet e banuara.

"Jam krenar që isha komandant i këtij njësitit, sepse arrita atë që çdoherë kisha frikë të premtoja para se të nisesha – ti kthej të gjithë shëndosh e mirë", theksoi kapitrn Metodi Haxhi-Janev, sot nënkolonel, komandant i kontingjentit të Maqedonisë, men-





Meqenëse pjesa më e madhe e ushtarëve amerikan nga divizioni i 4. nuk kishin kaluar trajnim special për operacione në mjedise urbane, shumë shpejt “ujqërit” u bënë forcë udhëheqëse në operacionet e bashkuara me ushtarët amerikan të cilët e shtonin sigurinë. Ata, menjëherë pas arritjes në teren ishin të aftë vetë t’i planifikojnë dhe t’i zbatojnë misionet e parapara.

Detyrat e ekipeve nga njësitet speciale të ARM-së në atë periudhë në Irak ishin t’u jepnin mbështetje ushtarëve të SH-BA-ve, edhe atë si udhëheqës në kryerjen e operacioneve speciale. Ata me sukses kanë kryer më shumë veprime dhe operacione.

Dhe ashtu ishte. Përsëri kishte shumë lëvdata, sepse kontingjenti i Maqedonisë në Irak u tregua si një njësit i trajnuar mirë, profesional dhe çdoherë i gatshëm, i cili dinte në mënyrën më të mirë t’i kryente të gjitha detyrat e shtruara. Mirënjohje të këtilla mori edhe kontingjenti i tretë i Maqedonisë i përbërë nga “ujqërit”. Edhe ata, si dhe të tjerët që ishin para tyre, treguan kualitete më të larta njerëzore dhe ushtarake, të cilat janë karakteristikë e ushtarëve të Maqedonisë. Si mirënjohje për trajnim të lartë, kryerje profesionale të detyrave dhe rezultateve të arritura në mision, ministri i Mbrojtjes i SHBA-ve, një numri të madh të pjesëtarëve të këtij njësiti u ndau dekorata për meritë.



Prandaj, nuk është e rastësishme që Dekorata e parë për merita ushtarake të Republikës së Maqedonisë i është ndarë pikërisht Batalionit për veprime speciale, i njohur si “ujqërit”. Dekorata u është ndarë pikërisht në Ditën e ARM-së, me 18 gusht të vitit 2005.

Në fillim të vitit 2005, misionin në Irak e kryenin pjesëtarët e batalionit të renxherëve pranë Regjimentit për Operacione Speciale. Kontingjenti i parë i përbërë nga “renxherët” e Maqedonisë e përfaqëson-te rotacionin e katërt të kontingjenteve në misionin Irak. Misionin e morën nga kolegët e tyre “ujqërit” të cilët më herët kishin kryer tre misione të suksesshme, duke përfaqësuar denjësisht Republikën e Maqedonisë, duke vendosur kështu standarde të larta në profesionalizëm ushtarak.

Bataljoni i renxherëve para vetes kishte definitivisht detyrë të rëndë: të vazhdon-te me kryerjen e misionit, duke mos lejuar të ndjehen dallime në kryerjen e detyrave te partnerët e koalicionit, si dhe të vazh-dohet me prezantimin dinjitoz të Republi-kës së Maqedonisë.

Të gjitha kontingjentet e Maqedonisë të vendosura në misionin në Irak ishin të vendosura në bazën në Taxhi, bazë e cila gjendet tridhjetë kilometra në veri të Bag-dadit. Jeta në bazë për ushtarët tanë nuk ishte e keqe. Atje i kishin të gjitha kushtet e nevojshme për një jetë dhe punë nor-

male, por baza shfrytëzohej vetëm për pushim, ushqim, përgatitje për misione, brifinze dhe debriefinze.

Pjesën më të madhe të kohës “renxherët” ishin jashtë bazës, në zonën e përgjegjë-sisë, duke kryer operacione të pavarura ose në përbërje të batalionit të 70 të in-

forcave tona të dedikuara”, janë fjalët e flamurtarit amerikan Anton Kejdi, përn-dryshe person i cili drejtpërdrejtë ka bashkëpunuar me “renxherët”. Vlerësim-e të këtylla, lëndata dhe mirënjohje, “renx-herët” kanë marrë nga personalitete të shquara politike dhe ushtarake, por



xhinierisë, divizionit të 3 të këmbëtorisë, divizionit të parë të blinduar me qëllim të sigurimit të komunikimeve dhe urave, duke gjetur pozicionet në të cilat forcat e antikoalicionit veprojnë me raketa dhe minahedhës mbi forcat e koalicionit dhe vendet e banuara, zbulimin e vendeve ku mbahet armatimi, municioni dhe granatat artilerie, zbulimi i vendeve ku përpunohen automjete bombë dhe mjetet eksplozive të improvizuara, gjetje dhe heqje të lirsisë të personave të cilët janë në listën e ar-restimit dhe të tjera.

Në fillim të vitit 2005 është kryer rota-cioni i kontingjenteve. Kontingjenti i pestë në misionin “Liri për Irakun” vazhdoi ti kryejë detyrat e shtruar me temp më të madhe. Ndryshimet të cilat bëheshin në përditshmërinë në Irak e përforconin tempin e angazhimit të “renxherëve”. Me praninë e koalicionit, në Irak u bënë edhe proceset e nevojshme demokratike në të cilat Irakianët me votë vendosën për ar-dhmërinë e tyre.

Në këtë kontekst ishte edhe angazhimi i “renxherëve” – krijimi i kushteve për votim pa pengesa të popullatës.

Edhe “renxherët” e Maqedonisë, si dhe paraardhësit e tyre, gëzonin rejting të lartë në mesin e aleatëve. “Togu i renx-herëve është mjaft mirë i trajnuar dhe i disiplinuar. Ata, përveç që janë mirë të trajnuar, kanë njohuri taktike dhe teknike dhe paraqesin pjesë të rëndësishme të

mirënjohja e bashkëluftëtarit, megjithatë është mirënjohja më e madhe.

Hapave të tyre shkuan edhe kontingjen-tet tjera në misionin “Liri për Irakun”, të përbërë nga “renxherët”.

Në vitin 2008, pjesëmarrja jonë në misionin “Liri për Irakun” ishte rritur edhe me një tog. Pas 11 rotacioneve, ushtarët e Maqedonisë e përfunduan pjesëmarr-jen në misionin “Liri për Irakun”. Rreth 450 paqeruajtës të ARM-së kaluan nëpër rreth 11 misione në Irak, “ujqërit” dhe “renxherët” nga RoS, ndërsa në dy rota-cionet e fundit edhe “leopardët” nga brigada e dytë e këmbëtorisë e mekanizuar na prezantuan në Irak në mënyrë të vërtetë, si ushtarë të paqes të cilët kanë aftësi në mënyrë profesionale, disiplinore, dhe para se gjithash në mënyrë efikase të përgjigjen në detyrat e besuara. Për këtë, në fakt, ata morën mirënjohje nga komanda përgjegjëse, si dhe dekorata më të larta nga SHBA-të dhe nga vendi.

Në pesë vitet e kaluara në misionin “Liri për Irakun” ushtarët e paqes së Maqedonisë shkruan një ndër kapitujt më të rëndësishëm të Armatës së Republikës së Maqedonisë dhe vendit tonë. Në vend ata u kthyen me përvojë të pazëvendësueshme, e cila luante një rol një rëndësishëm në ndjekjen e zhvillimit të ardhshëm të ARM-së, veçanërisht në sferën e trajnimit.

V.D.



“USHTARËT ME DIEI”

METODI HAXHI-JANEV, KOMANDANT I KONTINGJENTITË PARË NË MISIONIN “LIRI PËR IRAKUN”

Në vitin 2003 Kuvendi i Republikës së Maqedonisë miratoi vendim për dërgim të kontingjentit ushtarak të ARM-së për pjesëmarrje në misionin “Liri për Irakun” dhe ju u emëruat komandant i kontingjentit të parë. Ishit përzgjedhur “për të thyer akullin” dhe të na përfaqësoni para botës. Si ndjeheshit gjatë përgatitjeve para se të shkonit?

- Të jem i sigurtë, duke patur parasysh se lajmin për emërimin tim si komandant i kontingjentit të parë i cili do të shkojë në një mision paqeruajtës, e mora derisa isha në teren (kemi realizuar trajnim mjaft serioz i cili sipas asaj programe për herë të parë realizohej në këto hapësira), këtë lajm e mora pa mos u menduar aspak. Ajo për të cilën së pari herë u drejtova ishte se si do të përbëjë ekipin. Ndjenja e përgjegjësisë dhe rëndësisë erdhën më vonë, pasi me ata që i kisha bashkëpunëtorë të parë kuptuam se ku do të shkonim. Por, duke iu falënderuar kualitetit dhe profesionalitetit të tyre, shumë shpejt arritëm të krijojmë një pasqyrë të qartë për atë që na pret dhe për ambientin ku do të gjendemi. Prandaj nuk isha ngarkuar me ndonjë lajm rreth asaj se a jemi ne të parët ose jo. Përkundrazi, ajo shumë shpjet u bë një hendikep për ne, sepse shumica nga organet që duhej të na përkrahnin, si dhe ne, nuk kishin përvojë për një operacion të këtillë. Gjithsesi, e dinim se çfarëdo të kërkohej nga ne, ne ishim të gatshëm për ta kryer. Trajnimi jonë ishte i standardizuar dhe i zotëruar deri në përsosje.

Shkuat në një drejtim të panjohur, në mision paqeruajtës larg shtëpisë. Cilat ishin përshtypjet e para nga terreni, kontaktet e para, detyrat dhe obligimet?

- Përshtypja e parë ishte shumë depresive. Në Irak, gati se gjithçka ishte e shkatërruar. Edhe pse nuk doja të tregoja atë, ata të cilët më njihnin mua, e ndjenë dëshpërimin tim, por nuk më thanë asgjë, sepse me siguri edhe ata janë ndër njësoj si unë. Ato janë gjëra të cilat nuk do ti tregoni, por i ndjeni. Përderisa udhëtonim nga aeroporti në Bagdad (përndryshe ishim nga më të rrallët të cilët ateronin direkt në Bagdad - të gjithë hynin përmes vijës tokësore, përmes Kuvajtit), kah rajoni i vendosjes, në lindje prej nesh - në drejtimin tonë të lëvizjes hasëm në forca amerikane të cilët ishin në pikën luftarake. Një automjet fundosej në flakë, përderisa një pjesë e ushtarëve amerikan shkëmbenin zjarr me disa grupe. Konvoji thjesht e tejkaloj ngjarjen, dhe më vonë kur e pyeta nënkolonelin e ushtrisë së SHBA-ve i cili na udhëhiqte, pse nuk u ndalëm, me një zë të ftohtë dhe indiferent mu përgjigj: “Ai nuk është kriter ynë. Pragu për angazhim të tillë është shumë më i lartë. Mësohu me atë, sa më shpejtë të jetë e mundur aq më mirë”. Dhe çfarë do t’ju përgjigjesh, përveç se të kthehesh prapa dhe të kujdesesh mos të lësh përshtypje të keqe tek ata. Amerikanët nuk prisnin një shpërbërje aq të shpejtë të ushtrisë së Sadamit.

Të gjitha planet për sulmin ndaj Irakut ishin nga Plan i operativ diku kah viti 1999, dhe me këtë edhe supozimet ishin të ndryshme. Supozimet e këtilla ndiknin që logjistika

te vonohej, por ndiknin edhe mbi efikasitetin. Sistemi u shemb edhe për shkak të supozimeve të këqija (të cilat ishin vjetruar). Askush nga komandantët amerikan nuk priste të zbatohen operacione të pas-konfliktit përmes modelit të policisë- sigurimin e rendit publik dhe qetësisë.

Megjithatë, duke iu falënderuar ekipit me të cilin shkova atje, shumë shpejt i kemi tejkaloar këto sfida (për shembull kemi pirë vetëm 3 litra ujë gjatë ditës në temperatura ekstreme të larta, ushqim të konservuar gati 4 muaj etj). Komandantët ishin të përgatitur në mënyrë të shkëlqyer dhe përmes shembullit personal më ndihmuan të ruaj nismën e një lideri para eprorëve të mi. Përveç kësaj, përgatitjet ekstreme na mundësuan për kohë të shkurtër të përshtatemi në këto kushte.

Mbaj mend se menjëherë pas shkuarjes tuaj filluan të mbërrijnë raportet nga terreni për sukseset e kontingjentit nga Maqedonia. Na tregoni më konkretisht për ndonjë veprim me të cilin u theksuan “Ujqërit”.

-Sigurisht. Para se të ju tregoj se çka është ajo që mua më la përshtypje të madhe, dua vetëm të shënoj diçka që të jetë më e qartë. Duke shikuar tani nga kjo distancë, por edhe duke punuar më vonë në përgatitjet e kontingjenteve të tjera, mendoj se “boom” i vërtetë me operacionet nuk u bë vetëm për shkak të suksesit të cilin e arritëm, por edhe për shkak të, do të jem i sigurtë, dyshimit të fshehur i cili mbretëronte te opinioni i gjerë rreth asaj se a jemi ne të aftë për një gjë të tillë. Siç ndryshonin rotacionet



të cilën e kam pasur gjatë planifikimit të këtij operacioni ishte ajo që të mos vinte deri te shkëmbimi i zjarrit derisa shpërndaheshim në vijën e sulmit (ata ishin në një pozitë më të përshtatshme se ne).

Surpriza ishte pika vendimtare ku pas vendosjes, pa u parë nga ata, personat u arrestuan pa u shkrepur asnjë plumb i vetëm. Këtu dua të potencoj se komandantët e lartë të SHBA-ve më lanë një përshtypje të madhe. Madhështia e asaj se si deflonin si liderë më mësoi se si duhet të respektohen "nëpunësit e nënrenditur". Ata lejuan që propozimet tona të realizohen, gjithsesi, paraprakisht pasi i bindëm në atë.

Pasuan lëvdata, dekorime dhe shpërblime të tjera. Pas kthimit në shtëpi, propozuat të vazhdoni të ndërtoni karrierën tuaj në dy drejtime, si pjesëtarë i njësitit special, por edhe si magjistër, pastaj doktor i shkencave nga fusha e së drejtës ndërkombëtare. Sa ju ka ndihmuar përvoja nga terreni në karrierën shkencore?

- Përvoja e fituar në teren më ka ndihmuar shumë. Edhe pse isha magjistër, kur shkova në Irak kisha një filozofi për luftën kundër terrorizmit, por sikur edhe shumë të tjerë, atë filozofi në mënyrë drastike e ndryshova pas kthimit. Për atë edhe u përcaktova në atë që temën e disertacionit të doktoraturës t'ia kushtoj aspekteve ndërkombëtare të së drejtës së luftës globale kundër terrorizmit.

Jeni përpjekur edhe në ujërat e literaturës. Libri juaj "Rruga për Babilon" është libër ku është e dukshme autobiografia. Në libër, misionin në Irak e shyrtoni edhe në aspekt të një komandanti me përvojë dhe në aspekt të përjetimeve emotive të një njeriu të ri, i cili është me mijëra kilometra larg gruas së tij dhe vajzës. Na tregoni diçka më tepër rreth librit, për rrugëtimin e tij dhe për rëndësinë e këtij libri në jetën tuaj.

- Pra si edhe i gjithë misioni ashtu edhe libri ishte një punë ekipore ose gjysmë ekipore. Unë e kisha idenë dhe përmbajtjen, por nuk e kisha realizimin. Librin ia ofrova strukturave ushtarake përgjegjëse, por sigurisht për shkak të arsyeshme, libri si projekt ishte refuzuar. Pastaj u pajtova me këtë dhe prisja, derisa një pjesëtarë i yni e la Armatën dhe erdhi në pozitë për të më ndihmuar. Duke iu falënderuar atij dhe shtëpisë botuese "Kultura", libri erdhi përsëri në jetë.

pas nesh, opinioni u mësua me gjithë këtë, pra skeptikët më të mëdhenj menjëherë do të vinin në përfundim se ndoshta nuk e kanë edhe aq rëndë ata që shkojnë atje. Edhe tani ka nga ata të cilët mendojnë ende kështu, por ai është qëndrimi i tyre legjitim me të cilin, patjetër, se nuk pajtohem. Mund të them se shumë shpejt kuptova se suksesin duhet ta mas, jo në pikëpamje të asaj se sa operacione kinetike kemi realizuar, por sa jetë kemi shpëtuar dhe sa autoritet kemi arritur te popullata lokale. Është e vërtetë se më së pari operacionet kinetike- kurthet, pritrat, persona të arrestuar, armatimi dhe mjetet materialo-teknike, na krijuan "imazh" në, sikur na quajtën në një raport "luftëtarët me diell", megjithatë fitorja më e madhe e rotacionit të këtyllë ishte nga elementi i shtuar nga 1km. ku "ujqërit" i kryenin menjëherë. Rreth asaj që më pyetët direkt, mund të them se kishte më shumë operacione të atilla. Këtu bëjnë pjesë operacionet "Qumështorja", suksesi i të cilës i dedikohet befasisë të cilën e bëme, duke iu falënderuar planifikimit të shkëlqyer të gjithë pjesës komanduese, pastaj operacionin "Shtëpia e bardhë", ku koordinimi i komandantëve të grupit për sulm erdhi në shprehje dhe me shumë operacione të tjera dhe veprime në të cilat jo vetëm që morëm pjesë aktive, por edhe ishim udhëheqës të veprimeve. Por, ajo që mua më la përshtypje më të madhe është operacioni "Gjahu i ujqërve", në të cilën arrestuam vrasës të paguar të cilët kishin hyrë nga Siria. Edhe pse na ishte sugjeruar operacionin ta realizonim gjatë mbrëmjes, operacionin me iniciativën tonë e realizuam gjatë ditës, sepse deshëm të bëjmë befasi. Frikën më të madhe



Do të doja t'u jap kurajë edhe komandantëve të tjerë të vepronjë të njëjtën, sepse vetëm në atë mënyrë mund të vërtetohen qëndrimet dhe tezat e mija, gjegjësisht se çdo mision është i suksesshëm dhe një tregim i veçantë në vete. Përndryshe, libri u mirëprit mjaft mirë nga ana e lexuesve, por edhe nga ana e ekspertëve. Është përkthyer edhe në gjuhën angleze dhe pjesë të librit mësohen edhe në Shkollën për trajnime ushtarake në Fort Leavenworth, si mësim për taktikat e njësiteve më të vogla.

Sot jeni profesor në Akademinë Ushtarake "Gjeneral Mihaillo Apostollski". Nga perspektiva e deritanishme, si e shihni jetën tuaj tani në këtë periudhë, nga koha kur ishit komandant i kontingjentit të parë të Maqedonisë të dërguar në misionin "Liri për Irakun", kur në terren u ballafaquat me sfida të cilat mund t'ju kushtonin edhe me jetë?

-Mendoj se kjo është një faqe e re e jetës, e cila ndoshta edhe nuk ishte e planifikuar në jetën time, por të cilën tani e dua mjaft. Sot jam shumë krenar që jam docent në Akademinë ushtarake, e cila është shumë më ndryshe nga koha kur unë isha kadetë i saj. Sot programi është mjaft i modernizuar dhe i standardizuar, kemi kadetë edhe nga vende të tjera, e cila i referohet mundësisë të jemi edhe liderë në disa projekte. Përmes mësimit dhe formave të tjera të trajnimeve si p.sh, projekti "Kampi veror", mendohem t'u jap përcjell përvojat e mia kolegëve të mi të ri, por edhe kadetëve. Unë jam shumë falënderues edhe ndaj më të vjetërve të cilët dinë si të gjinden me dinamikën time dhe nga e gjithë kjo të përfitojmë. Nuk dua monople, edhe atë mendohem ta imponoj edhe si praktikë në atë që e punoj sot. Në progres shikoj si në produkt të mosmarrëveshjeve konstruktive dhe posaçërisht jam kundër shablloneve. Kadetëve dhe studentëve mendohem t'u jap atë që e di më së miri dhe t'u tregoj rrugën se ku mund të kërkojnë dhe të gjejnë atë të cilën nuk e dinë dhe çdoherë të kenë vizion, por edhe vullnet të realizojnë diçka. Edhe pse metodat e mija në fillim ndoshta edhe nuk janë aq të lehta dhe aq të njohura tek studentët, me kalimin e kohës ata do të kuptojnë se në një periudhë më të gjatë këto metoda do të jenë të dobishme për ata. E respektoj mjaft shumë punën ekipore dhe kërkoj ta imponoj të njëjtën edhe ndaj tyre.

Dr.Zhanet Ristovska





MISIONI I PARË I PAVARUR

BE- MISIONI ALTHEA I DETASHMENTIT HELIKOPTERIK NË BOSNJË DHE HERCEGOVINË (2006 - 2008)

Republika e Maqedonisë e konfirmoi përcaktimin strategjik për anëtarësim në Bashkim Evropian (BE) përmes përcaktimit të fortë politik për mbështetjen e politikës së përbashkët të jashtme dhe asaj të sigurisë (CFSP) me dhënien e kontributit konkret në operacionet civile dhe ushtarake në kuadër të politikës së sigurisë dhe asaj të mbrojtjes (ESDP) të Unionit. Pjesëmarrja e Republikës së Maqedonisë në operacionin ushtarak të BE-misionin ALTHEA e shënon serinë e parë të kontributeve konkrete dhe të rëndësishme të cilat vendi ynë do t'i japë në kuadër të ESDP-operacioneve civile dhe ushtarake, në drejtim të përforsimit të kapacitetit të Unionit.

Me 22 maj të vitit 2006, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë miratoi vendim historik për Republikën e Maqedonisë, për Armatën e Republikës së Maqedonisë dhe për Aviacionin ushtarak për dërgimin e njësitit të ARM-së për pjesëmarrje në operacione paqeruajtëse në Bashkimin Evropian në Bosnjë dhe Hercegovinë EUFOR, ALTHEA.

Njësi, gjegjësisht detashmenti i helikopterit, ishte i përbërë nga dy helikopterë Mi-8/17 dhe personel prej 17 pjesëtarëve në këtë përbërje: një oficer për lidhje dhe përfaqësues në Komandën e EUFORIT në Sarajevë, gjashtë oficerë-pilotë, një oficer-inxhinier i aviacionit ushtarak, katër nënoficerë-teknik-fluturues, katër nënoficer dhe një ushtarë profesional – teknik i aviacionit ushtarak.

Mbretëria e Belgjikës tregoi interes për pjesëmarrje dhe formimin e një kontingjenti të përbashkët belge-maqedonas, me të cilën filluan edhe aktivitetet konkrete dhe përgatitjet e personelit dhe helikopterëve. Me 3 kor-

rik të vitit 2006, në selinë e Këshillit të BE-së në Bruksel, ishte nënshkruar Marrëveshje për pjesëmarrjen e Republikës së Maqedonisë në operacionin e BE-së në Bosnjë dhe Hercegovinë –ALTHEA. Misioni ALTHEA ishte misioni i tretë paqeruajtës ndërkombëtar i vendit tonë, pas misioneve në Irak dhe Afganistan, por misioni i parë në kuadër të Bashkimit Evropian.

ROTACIONI I PARË

Në ceremoninë e dërgimit të rotacionit të parë të misionit ALTHEA me 14 korrik të vitit 2006 ishte prezent kreu i lartë shtetërorë. Fjalim pjesëtarëve të aviacionit të VING-ut u mbajti komandanti i detashmentit të parë të helikopterit në misionin ALTHEA, major Kire Kolevski. Në fjalimin e tij të mbajtur në ditën kur shkuan në mision, ai e quajti këtë ditë si një ditë historike për të gjithë pjesëtarët e aviacionit VING.

Misioni i parë historik ndërkombëtar i Aviacionit të Maqedonisë me emrin "Bukefal" filloi kur një helikopter "Mi17" dhe një helikopter "Mi-8MT" me simbole të aplikuara të EUFOR-it, e lëshuan bazën e aviacionit në "Petrovec" dhe pas një fluturimi që zgjati dy orë përmes Shqipërisë, Malit të Zi dhe Kroacisë, hyn në hapësirën ajrore të Bosnjës dhe Hercegovinës. Kontingjenti i detashmentit ishte nën kontroll operativ të komandantit të forcave të EUFOR-it për misionin ALTHEA në BeH me seli në Sarajevë, ndërsa sipas lokacionit dhe logjistikës ishte nën Komandën e forcave multinationale për sektorin juglindor "SALAMANDER" me seli në aeroportin në Mostar, dhe pastaj në bazën "Butmir" në Sarajevë.

Me 10 tetor të vitit 2006, Kuvendi i Repub-

likës së Maqedonisë miratoi vendim për ndryshim dhe plotësim të vendimit për dërgimin e njësitit të Armatës së Republikës së Maqedonisë për pjesëmarrje në operacione paqeruajtëse në Bashkimin Evropian në Bosnjë dhe Hercegovinë EUFOR, ALTHEA. Me vendimin e ri detashmenti i helikopterit ishte i plotësuar me oficerë për meteorologji, me oficerë për zbulim dhe drejtues të cisternës me karburant.

Fluturimet e para mbi territorin e Bosnjës dhe Hercegovinës ishin fluturime për njoftim dhe studim të regjionit të misioneve të mundshme. Fluturimet për njoftim, e mbuluan tërë territorin e BeH, duke filluar nga Mostari, Sarajeva, Tuzla, Banja Luka, Zenica si dhe aterim në të gjitha aeroportet civile dhe ushtarake. Vëmendje e veçantë iu përkushtua vendeve të shumta të helikopterëve për aterim (HLS – helicopter landing spots), të cilët, në fakt, ishin të ndërlydhura me ekipet e zbulimit (LOT-liason observacion teams), gjegjësisht "karakollë" të vogla me personel të EUFOR-it të cilët ishin të vendosur në kufirin me BeH dhe brenda saj, me nevojë të vazhdueshme nga transporti me helikopter, veçanërisht në kushte dimërore.

Si një avantazh i madh u tregua përvoja të cilën e kishin eprorët e detashmentit, major Kire Kolevski dhe zëvendësi i tij, major Toni Spasovski, të cilët vitet e tyre akademike të shkollimit dhe trajnimit i kishin kaluar në BeH, më saktë në Akademinë e aviacionit në Mostar. Njohja e gjuhës angleze, frazeologjia standarde e aviacionit dhe përvoja nga NATO/PfP- ushtrimet e shumta, u treguan si një parakusht i rëndësishëm për ekzekutim kualitativ të misioneve në BeH.

Detashmenti i parë i helikopterëve të Maqedonisë në misionin ALTHEA, si dhe tre të tjerët deri në vitin 2008, kryenin misione operative gjatë ditës dhe natës (me përdorimin e NVG-pajisjeve) nga fusha e: transportit të udhëtarëve dhe ushtarëve, mjete materiale, gjegjësisht ngarkesë e brendshme dhe e jashtme, VIP-transport, në bashkëpunim me pjesëtarët dhe pajisje të kontingjenteve tjera në kryerjen e misioneve të ndryshme të tipit: SAR, CSAR, CASEVAC dhe MEDEVAC. Angazhimi i plotë i detashmentit të Maqedonisë është vlerësuar shumë nga ana e Komandës së EUFOR-it, me të cilën vërtetohen edhe deklaratat zyrtare të zëdhënësit të forcave të EUFOR-it, kapitenit britanik, Nik Foster.

Për shkak të rëndësisë së mbështetjes së helikopterëve në përbushjen e misioneve në operacionin ALTHEA, veçanërisht në periudhën e transformimit aktual të EUFOR-it, ishte kërkuar vazhdim i misionit të detashmentit të helikopterëve të Maqedonisë, i cili vazhdoi në rotacionet e mëtutjeshme.

ROTACIONI I DYTË

Mandati i rotacionit të parë nga detashmenti i helikopterit të Maqedonisë ishte deri në janar të vitit 2007, kur ishte bërë ndërrimi i personelit me rotacionin e dytë. Në krye të detashmentit të helikopterit të Maqedonisë të vendosur në Bosnjë dhe Hercegovinë qëndroi nënkolonel Borçe Jefremov. Me 9 janar, të v.2007 në kazermën "Heroi kombëtar Strasho Pinxhur" në Petrovec u mbajt ceremoni me rastin e dërgimit të

publikës së Maqedonisë të ec drejt rrugës së demokracisë dhe integriteteve".

Kontingjenti i Maqedonisë, një pjesë të rotacionit e kaloi në aeroportin në Mostar dhe pastaj në bazën "Butmir" në Sarajevë.

ROTACIONI I TRETË

Me 4 korrik të vitit 2007, në kazermën "Heroi kombëtar Strasho Pinxhur" në Petrovec, përsëri u mbajt ceremoni me rastin e dërgimit të kontingjentit të ri të Maqedonisë – rotacioni i tretë në misionin paqeruajtës ALTHEA në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Me këtë rast fjalim mbajti komandanti i kontingjentit të tretë të Maqedonisë, major Toni Spasovski. Komandanti i detashmentit theksoi: "Detyrat të cilat do ti kryejmë në BdeH janë pjesë e angazhimit të përgjithshëm të forcave multinacionale dhe kanë të bëjnë me transportin e njerzëve dhe MTC transportit VIP, CASEVAC dhe detyra tjera të ngjashme të cilat nuk i kryejmë gjatë aktiviteteve të përditshme. Trajnimi i personelit teknik dhe pilotëve u dimensionua me kohë sipas standardeve të NATO-s në këndveprim multinacional".

Kohëzgjatja e rotacionit të tretë ishte vazhduar për tre muaj plotësues pas ndërrimit të komandantëve të detashmentit, ashtuqë komandant i ri për 3 muajt e ardhshëm ishte vendosur major Kire Kolevski.

Me rastin e kthimit së rotacionit të tretë nga misioni ALTHEA, me 12 janar të vitit 2008, ndodhi një fatkeqësi e aviacionit me helikopterin "M17" me numër të evidentuar BAM-304, në vendin Katllanovë të Bllacës. Vdekja

ARM-së nga ana e përfaqësuesit të lartë të Bashkimit Evropian për politikë dhe siguri të jashtme. Me rastin e 20 vjetorit të jubileut të ARM-së, kryetari dhe komandanti i ARM-së, Gjorgje Ivanov, i dekoroi me Medalje për guxim 11 pjesëtarët e ARM-së, heronj të kohës së re.

ROTACIONI I KATËRT

Republika e Maqedonisë në pikëpamje të rotacionit të katërt të detashmentit të helikopterit (janar-korrik të vitit 2008), në bazë të analizave dhe vlerësimeve të bëra, miratoi vendim i cili shprehu nevojën për tërheqjen e njërit helikopter, "Mi-8/17", në drejtim të arritjes së nivelit të duhur të operativitetit për arsye të kontributeve të ardhshme. Në përputhje me vendimin, rotacioni i katërt i detashmentit të helikopterit në misionin ALTHEA në BeH përbëhej nga një helikopter transportues "Mi-8/17" dhe 12 persona në përbërje të detashmentit të helikopterit.

Në kazermën "Heroi kombëtar Strasho Pinxhur" në Petrovec, me 17 korrik të vitit 2008 u mbajt ceremoni solemne me rastin e kthimit të rotacionit të katërt dhe kryerjen me sukses të pjesëmarrjes në detashmentit e helikopterit të ARM-së në misionin ALTHEA." Krenohem me pjesëtarët tanë dhe ishte kënaqësi për mua të jem udhëheqës i tyre në sukseset të cilat i kanë arritur në misionin "ALTHEA" – theksoi në ceremoni nënkolonel Ili Trajkov, komandant i rotacionit të katërt të detashmentit të helikopterit të ARM-së.

Të gjithë pjesëtarët e detashmentit të Maqedonisë nga Brukseli morën medalje me rastin e pjesëmarrjes në mision. Medalja u dha për angazhimin e vazhdueshëm dhe ekzekutim me kohë të misioneve.

PËRFUNDIM

Me katër rotacionet Republika e Maqedonisë e konfirmoi përcaktimin strategjik për arritjen e anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Me përfundimin e rotacionit të fundit të detashmentit të helikopterit në korrik të vitit 2008, ishte miratuar vendim që Republika e Maqedonisë të rumbullakojë kontributin e vet me kapacitete të helikopterit në operacionin EUFOR në Bosnjë dhe Hercegovinë ALTHEA me gjithsej katër rrotullime të bëra (korrik 2006- korrik 2008).

Pjesëmarrja në misionin ALTHEA me dy helikopterë dëshmoi se ARM-ja ka potencial të merr pjesë në misione jashtë RM-së me pjesën e tyre më të sofistikuar dhe njëkohësisht të jep mbështetje logjistike për ekzekutim pa pengesë të misioneve fluturuese. Pjesëtarët e detashmentit të helikopterit dëshmuar se qëndrojmë krah për krahë me aviacionet e NATO-s dhe vendeve të PpP. Me rezultatet e shkëlqyera në kryerjen e të gjitha detyrave të vendosura nga komanda e EUFOR-it kemi fituar mjaftë simpati para opinionit ndërkombëtar dhe kemi fituar mjaft autoritet të denjë për respekt. Gjatë kohës së këtij misioni ne me vete kemi sjellë frymën pozitive të bashkëpunimit të pjesëmarrësve të tjerë në mision. Flamuri i Maqedonisë valon me krenari në këtë mision ndërkombëtar, duke shprehur vendosmërinë e palëkundur të Republikës së Maqedonisë të vazhdojë në rrugën e demokracisë dhe integriteteve euroatlantike.

Dragan Pavlovski



kontingjentit të dytë të Maqedonisë. Komandanti i kontingjentit të dytë në fjalimin e tij para të pranishmëve theksoi: "Viti i kaluar 2006 ishte vendimtar për aviacionin VING sepse nga korriku i vitit të kaluar pas përgatitjeve thelbësore, aviacioni i VING-ut merr pjesë në misionin paqeruajtës ndërkombëtar ALTHEA në Bosnjë dhe Hercegovinë. Ai ishte testimi i parë për gatishmërinë e pjesëtarëve të aviacionit të VING-ut dhe përputhshmërisë me strukturat tjera të NATO-s. Forcat tona të deklaruara sot shkojnë në rotacionin e dytë në mision paqeruajtës ndërkombëtar, nën udhëheqjen e BE-së në Bosnjë dhe Hercegovinë. Flamuri i Maqedonisë do të vazhdojë të valoj me krenari në këtë mision ndërkombëtar duke treguar angazhimin e palëkundur të Re-

e 11 paqeruajtësve për një ditë është humbja më e madhe në historinë e ARM-së. Helikopteri i ARM-së, njëri nga dy helikopterët me të cilin Maqedonia mori pjesë në misionin paqeruajtës në Bosnjë dhe Hercegovinë, kishte fluturuar rreth orës 9 e 30 minuta nga baza "Butmir" në Sarajevë dhe duhej të ateronte në pjesën ushtarake të aeroportit "Petrovec". Kontaktin e fundit me kullën e kontrollit në aeroportin e Shkupit, helikopteri e kishte bërë gjashtë milje nga objektivi, ku në ora 12 e 28 minuta ai u rrëzua. Me ndarjen e Medaljes për shërbim të politikës evropiane mbrojtëse dhe asaj të sigurisë, familjarëve të pjesëtarëve të ndjerë të ARM-së në fatkeqësinë e helikopterit, ishin dekoruar njëmbëdhjetë pjesëtarët e

INTERVISTË

FLUTURIM I PAHARRUAR



KOLONEL KIRO KOLEVSKI, KOMANDANT I BRIGADËS USHTARAKE TË ARM-SË DHE KOMANDANT I DY KONTINGJENTEVE NË MISIONIN ALTHEA

Rugët e jetës janë të pazakonta. Ndonjëherë të kthejnë në vende ku asnjëherë nuk ke qenë, nga të cilat ke kujtime të bukura. E tillë është edhe historia e kolonelit, në atë kohë major, Kire Kolevski, komandant i kontingjentit të Maqedonisë në misionin ALTHEA në Bosnjë dhe Hercegovinë. Dikur, kur Republika e Maqedonisë ishte në përbërje të ish Federatës Jugosllave, ai ishte këtu në shkollim si pilot i ANJ dhe mbante pseudonimin "Poskok". Banorët e Mostarit dhe në përgjithësi të rriturit boshnjak, e mbajnë mend si njeri i cili me helikopter kishte arritur të kalojë mbi Urën e vjetër të Mostarit.

Nga viti 2006 ai përsëri fluturoi mbi këto hapësira, por tani në përbërje të forcave paqeruajtëse të EUFOR-it BeH në operacionin ALTHEA, duke udhëhequr kontingjentin e parë dhe një pjesë të kontingjentit të tretë në BeH në kuadër të misionit ALTHEA. Ky ishte misioni ynë i parë në kuadër të Bashkimit Evropian, i cili hapi faqe të reja nga historia e ARM-së dhe sjelli fryma të reja në drejtim të angazhimit të ardhshëm të ushtrisë tonë.

Nga aspekti i sotëm, si i vlerësoni do t'i kisha quajtur, ato hapa të parë historik të AU dhe ARM-së?

- Kryerja me sukses e rotacionit të parë të detashmentit të helikopterit të Maqedonisë dëshmoi se ARM-ja në pjesën e forcave të aviacionit ka potencial të merr pjesë në misione jashtë vendit, ndërsa Republika e Maqedonisë të jetë partner serioz dhe kontribues i paqes në rajon dhe më gjerë. Jam

i bindur se përfundimi i misionit ALTHEA për VINGUN e atëherëshëm dhe Brigadën ushtarake ishte një lloj i fillimit të ri në të cilën, përvojat, e kombinuara në trajnimin e periudhës së ardhshme, garanton sukses në misionet e ardhshme në të cilat morën pjesë njësitet e Brigadës së aviacionit pranë KOB të ARM-së. Fillimi i misionit karakterizohet sipas aktiviteteve intensive për vendosjen dhe adaptimin tonë, pas njoftimit me procedurat standarde operative (PSO), me STANAG dhe me pranimin e dokumenteve të shumta nga fusha e fluturimit. Gjithashtu, njohja e gjuhës angleze, e frazeologjisë standarde të aviacionit dhe përvoja e shumë ushtrimeve të NATO/PpP, u dëshmuar si parakusht i rëndësishëm për kryerje kualitative të misioneve në BeH. Si plotësim i kësaj, duhej të studioheshin edhe procedurat lokale dhe ato civile, që në asnjë moment aktivitetet tona fluturuese mos të vijnë në konflikt me ICAO procedurat civile, në përputhje me urdhrat e komandës së EUFOR-it. Njëkohësisht me angazhim operativ të detashmentit, të gjithë pjesëtarët e DHM kaluan trajnime të ndryshme si, p.sh, trajnim për njohje dhe largim nga fushat e minuara. Në çdo kohë, ky ishte trajnim i nevojshëm, duke pas parasysh se në BeH në atë kohë zyrtarisht ekzistonin mbi 18.000 fusha të minuara. Fluturimet e para mbi territorin e Bosnjës dhe Hercegovinës ishin fluturime për njohjen dhe studimin e rajonit të misioneve të mundshme. Fluturimet e mbuluan tërë territorin e BeH, duke filluar nga Mostari, Sarajeva, Tuzila, Banja Luka, Zenica si dhe aterim në të gjitha



aeroportet ushtarake dhe civile. Vëmendje e posaçme iu kushtua vendeve të shumta për aterim të helikopterëve (HLS- helicopter landing spots), të cilët janë të ndërlidhur me ekipet vëzhguese (LOT-liason observacion teams) – "karakollë" të vogla me personel të EUFOR-it të cilët janë të vendosur brenda dhe në kufirin e BeH, dhe të cilët kanë nevojë të vazhdueshme për transport me helikopterë, posaçërisht në kushte të dimrit.

Mendoj se të gjithë duhet të krenohemi me pjesëtarët e katër misioneve të misionit ALTHEA, veçanërisht me gatishmërinë e tyre të jashtëzakonshme, ballafaqimin dhe shkathtësinë të mund të gjinden gjatë pëmbushjes së detyrave të rregullta në situata të ndryshme dhe përputhshmërisë me strukturat tjera të NATO-s. Pjesëtarët e

detashmentit të helikopterit e tejkaloan me sukses edhe këtë sfidë, me ç'rast për këtë flasin edhe vlerësimet e larta nga Komanda e EUFOR-it në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Ky ishte misioni i pare i pavarur i ARM-së. Çfarë do të thotë kjo konkretisht?

- Detashmenti i helikopterit ishte pjesë e misionit ALTHEA të BE-së për rrualtjen e paqes dhe sigurisë në BeH, dhe me kapacitete e veta transportuese merr pjesë aktive në tërë territorin e BeH. Në rotacionin e parë të misionit ALTHEA morën pjesë 21 pjesëtarë të aviacionit të VINGUT të ARM-së, të cilët detyrat i kryenin së bashku me kontingjentin belg në Mostar, me përfshirje të një oficeri i cili në rolin e oficerit për lidhje ishte vendosur në komandën e EUFOR-it në Sarajevë.

Detashmenti i parë i helikopterit të Maqedonisë, me angazhimin e helikopterit të tipit "Mi-8" dhe "Mi-17" për nevojat e misionit ALTHEA, prej fillimit të korrikut të vitit 2006 deri në janar të vitit 2007, i kryente me sukses misionet operative gjatë ditës dhe natës, transportim të ushtarëve dhe mjeteve materiale, VIP-transport, pjesëmarrje në ushtrime të ndryshme etj. HMD në fillim ishte mbështetës logjistik nga ana e kontingjentit të Belgjikës në raport me distribuimin e karburanteve, automjeteve zjarrfikëse, sigurisë dhe zbulimit, shërbimit meteorologjik, vendosjes dhe ushqimit. Me shkuarjen e kontingjentit belg, misioni i detashmentit të helikopterit vazhdoi të ekzistojë i pavarur. Mund të them lirish se kemi pasur një mision të ri i cili sipas të gjithatributeve paraqet mision të pavarur të Republikës së Maqedonisë në kuadër të EUFOR-it.

Të punuarit me kontingjentin belg për ne ishte një përvojë e re nga fusha e organizimit të punës dhe kryerjes së misioneve operative fluturuese. Të gjitha vlerësimet për punën me kontingjentin belg ishin pozitive dhe ajo që është më rëndësi, është fakti se kjo përvojë shfrytëzohet dhe do të shfrytëzohet edhe në misionet e ardhshme ku njësjia jonë e helikopterëve vetë në mënyrë të pavarur do të merr pjesë.

Puna e pjesëtarëve të kontingjentit të Maqedonisë është e vlerësuar lartë nga ana e komandës së EUFOR-it, e cila i dedikohet trajnimit të lartë dhe profesionalitetit, procedurave të tejkaluara operative standarde të NATO-s në fushën e udhëheqjes së njësiteve të aviacionit dhe motivimit të lartë të paqeruajtësve të Maqedonisë. Paqeruajtësit tanë, me sakrificimin dhe para se gjithash me profesionalitetin e tyre, mundësuan operativitet të plotë të pjesëtarëve të aviacionit të përcaktuar për mision, si dhe zëvendësim të tyre për kohëzgjatjen e tërë misionit, dhe në të njëjtën kohë i kryenin të gjitha detyrat e shtruara, në njësitin amë.

Për cilat përvoja konkrete bëhet fjalë?

- Detashmenti i helikopterit në misionin ALTHEA kryente misionet operative gjatë ditës dhe natës (me përdorimin e pajisjeve për fluturim gjatë natës) nga fusha e transportit të ushtarëve - udhëtar dhe mjete materiale, gjegjësisht një barrë e brendshme dhe e jashtme, VIP-transport, në bashkëpunim



me pjesëtarët dhe me pajisje të kontingjentëve tjera, kryerje të misioneve të tipit SAR (Kërkesë dhe shpëtim), CSAR (Kërkesë luftarake dhe shpëtim) dhe CASEVIC (Evakuim të të lënduarve). Gjatë misionit çdo ditë ishim të angazhuar me misione dhe ushtrime të ndryshme, në përputhje me urdhrin operativ "Bukefal", me fluturim mujor deri në 60 orë i kemi përbushur të gjitha misionet e dhëna nga Komanda e EUFOR-it në Sarajevë. Menaxhimi i drejtë me resurse njerëzore dhe ato të fluturimit mundësoi që në gjashtë muajt e parë, pjesëtarët e HMD të realizojnë fluturim afër 320 orë me kryerjen e drejtë të detyrës gjatë tërë 180 ditëve dhe me ndarjen e fluturimit në lidhje 70:30% në dobi të misioneve operative për nevojat e EUFOR-it, në përputhje me marrëveshjen e ShP të ARM-së dhe komandës së EUFOR-it. Përvojat e fituara gjatë punës në veprimet multinacionale janë të një rëndësisë të madhe për Brigadën ushtarake, sepse procesi i përgatitjeve, kryerjes dhe analizimit të misioneve në kushte reale dhe në bashkëpunim me njësitë e vendeve tjera paraqet një përvojë të posaçme të fituar e cila zhvillohet gjatë trajnimit të Brigadës ushtarake. Menaxhimi me resurset njerëzore dhe ato të fluturimit, koordinimi kohor dhe përgatitja meteorologjike e aktiviteteve fluturuese në kushte të terrenit të panjohur me një lartësi të madhe mbidetare dhe ndryshime të shpejta të situatës kohore, janë gjithashtu pjesë e përvojave të cilat janë fituar gjatë misionit.



Nuk janë më pak të rëndësishme as edhe miqësitë dhe lidhjet të cilat u vendosën me pjesëtarët e kontingjentit të huaj dhe popullatës miqësore të BeH.

Për fat të keq, në profesionin tonë tragjeditë janë përfshirje të cilat duhet vazhdimisht të rikujtojmë se vetëm me trajnim të mirë dhe investim material mund t'u ikim momenteve të padëshiruara, siç ishte rasti me njëmbëdhjetë pjesëtarët e aviacionit të VINGUT të ARM-së, të cilët humbën jetën në mënyrë tragjike gjatë kthimit nga misioni ALTHEA në BeH. Ata ishin heronj të kohës së re, të cilët pas tyre lanë vepra, gjurmë të pashlyera të cilat çdoherë do të mbeten të shkruara në historinë e aviacionit të Maqedonisë si profesionistë të lartë dhe ambasadorë të paqes. Jemi krenarë që kemi pasur eporë ushtarake dhe shok, të cilët dinin si profesionist dhe miq t'i ndanin detyrat e punës, momentet e vështira, por edhe gjithë ato momente në të cilat bashkë ndamë edhe gëzim dhe lumturi.

Gjatë misionit ALTHEA, të gjithë pjesëtarëve të detashmentit u ishte dhënë Medalje e misionit ALTHEA nga Brukseli. Ju keni fituar edhe dekoratë të posaçme nga përfaqësuesi i lartë i BE-së?

- Medalja e pjesëtarëve të misionit ALTHEA ishte ndarë për angazhim dhe kryerje më kohë të misionit. Së bashku me medaljen ishte ndarë edhe certifikatë e nënshkruar nga përfaqësuesi i lartë i politikës së përbashkët dhe asaj të jashtme të BE-së, Havier Sollana. Pas përfundimit të rotacionit të tretë në ALTHEA, mora edhe një mirënjohje të veçantë nga komandanti i EUFOR-it, gjeneral-majori spanjoll Ignasio Martin Vilalain, për kryerje të suksesshme të misioneve të dhëna në kuadër të rotacionit të tretë të HMD në EUFOR. Gjithashtu, angazhimi i tërësishëm i detashmentit nga Maqedonia është lartë i vlerësuar nga Komanda e EUFOR-it.

Ç'farë do të ndodh më tej?

- Vazhdojmë me trajnimet e përditshme dhe me mirëmbajtjen e teknikës së aviacionit ku në mënyrën më të mirë u japim mbështetje të gjithë njësiteve të ARM-së, si dhe më gjerë në kuadër të tërë vendit. Mbështetja e institucioneve shtetërore gjatë kohës së fatkeqësive elementare (dërgimi i ushqimit dhe barnave në kushte të reshjeve të borës) dhe zjarreve të mëdha në terrere të pakalueshme. Vazhdimi i modernizimit dhe avancimit të teknologjive më moderne me të cilat pajisen fluturaket, dhe kuptohet mbështetja e shkollës për pilotët e cila duhet në periudhën e ardhshme t'i jep pilotët e parë për nevojat e Brigadës ushtarake. Brigada e aviacionit, në përputhje me objektivat e dhëna të partneritetit, në mënyrë aktive i përforcon helikopterët dhe personelin për pjesëmarrje në misionet e ardhshme paqeruajtëse të detashmentit të helikopterit. Tashmë vetëm e kemi kaluar vetë vlerësimin Nivel 1 dhe 2, si dhe vlerësimin e NATO-s Nivel-1, dhe tani pason edhe vlerësimi i NATO-s Nivel-2. Poqese është nevoja që nesër mund të nisemi në mision.

V.D.



EKIPI ELIT MJEKËSOR

EKIPI MJEKËSOR I ARM-SË NË KOMANDËN E EUFOR-IT NË MISIONIN ALTHEA

Republika e Maqedonisë e konfirmon përcaktimin strategjik për arritje të anëtarësisë në Bashkimin Evropian me deklarin e kontributit konkret në operacionet ushtarake në kuadër të politikës së përbashkët të mbrojtjes dhe sigurisë (CSDP) të Bashkimit, ALTHEA në BeH. Marrëveshja ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrje të Republikës së Maqedonisë në kuadër të operacionit ALTHEA ishte nënshkruar me 3 korrik të vitit 2006 në Bruksel.

Kontributi i parë i Republikës së Maqedonisë në operacionet e udhëhequra nga Bashkimi Evropian filloi në korrik të vitit 2006 me deklarin të ARM-detashmentit,

të përbërë nga dy helikopterë "Mi-8/17" dhe personelit të përbërë nga 21 persona. Kontributi me kapacitete të helikopterit zgjati prej korrikut të vitit 2006 e deri në korrik të vitit 2008. Në nëntor të vitit 2006, Republika e Maqedonisë e përforcoi kontributin e vet në operacionet e Bashkimit në BeH, ALTHEA, duke deklaruar ekip mjekësor të përbërë nga 10 persona për ROLE 1 mbështetjen mjekësore të kampit në Butmir. Në procedurë është rotacioni i trembëdhjetë i ekipit mjekësor në ALTHEA. Kontributi i Republikës së Maqedonisë në ALTHEA ishte përforcuar edhe me deklarin e një personi jurist ushtarak - ndihmës këshilltarë jurist në Komandën e EUFOR-it/ HQ EUFOR (nga qershori i vitit 2007).

Ndihmës këshilltarë jurist është anëtarë i Zyrës së këshilltarit jurist në Komandën e grupit kryesorë në komandën e EUFOR-it. Ai siguron këshilla juridike për komandantin e EUFOR-it dhe zëvendës komandantin, i cili njëkohësisht e kryen edhe funksionin e shefit të shtabit dhe pjesëtarëve të tjerë të Shtabit të EUFOR-it, nga fusha e së drejtës ndërkombëtare dhe lokale, si dhe bën interpretimin e dispozitave nga Marrëveshja e përgjithshme kornizë për paqe në BeH dhe rezolutat e Këshillit për siguri të KB.

Në procedurë është edhe rotacioni i njëmbëdhjetë i këtij pozicioni, ndërsa nga dhjetori i vitit 2012 fillon rotacioni i dymbëdhjetë i ndihmës këshilltarit juridik. Kjo detyrë është e një rëndësie të veçantë për ARM-në në drejtim të përforcimit të mëtutjeshëm të pozitës personale në detyrat kyçe në misionet paqeruajtëse dhe me këtë edhe potencohen vlerat personale përmes kryerjes profesionale të përgjegjësisë në strukturën e forcave multinacionale.

Ekipi i parë mjekësor ALTHEA në BeH përbëhej nga 2 mjek, 6 teknik mjekësor dhe 2 shoferë. Ishin të vendosur në bazën "Butmir". Detyrë e ekipit ishte t'u japë siguri shëndetësor forcave multinacionale në Bosnjë, Sarajevë. Ata kishin bashkëpunim të shkëlqyer me të gjitha kontingjentet kombëtare, asnjëherë nuk kanë pasur ndonjë problem dhe ka ndodhur shpesh që shumë mjek nga kontingjentet tjerë të kërkojnë shërbim nga kontingjenti ynë. Ab-





solutisht i kanë kryer të gjitha detyrat të cilat u janë shtruar.

"Ditën kur arritëm, kujton lideri i ekipit të parë mjekësor ALTHEA (tani kolonel në pension), d-r Kristo Blazhevski, i hapëm materialet, ndërsa ditën tjetër u paraqitëm se jemi të gatshëm për punë. Pacientët e parë ishin trajtuar në mënyrën e duhur, ndërsa lehtësim më i madh ishte se e flisnim gjuhën angleze. Mund të lavdërohem se të gjitha problemet profesionale i kemi tejkaluar në mënyrën e duhur, pa ndonjë

"Shkuarja në misione është një arritje e përvojës së çmuar në një këndvështrim tjetër. Qëllimi ynë ishte human, të ballafaqohemi me njerëz të cilët mund të jenë objektivi i sulmit. Ne jemi ushtarë, dhe kjo do të thotë se të gjithë ata që janë të uniformuar duhet të japin siguri, të lënduarit duhet ta kenë me dije se çdoherë ka dikush që do t'ua shpëton jetën. Kishte edhe ushtarë nga kontingjentet tjera të cilët vinin tek ne, duke e kaluar mjekun e tyre. Ne sillshim në mënyrë profesio-

jete sanitare, ndërsa ato i mirëmbante kontingjenti i Turqisë.

Ndihmë e vlefshme për ata, siç tha Kërstevski, për të gjithë kontingjentet, ishte trajnimi i cili mbahej në Spitalin ushtarak me ndihmë të delegacionit të Zvicrës, prej të cilëve fituan pajisje të çmuara.

Reparti mjekësor i ARM-së, misionin në BeH e kryen në mënyrë të pavarur, gjë që nuk është rasti i njëjtë me misionet tjera ku ARM-ja ka të vendosur pjesëtarë të saj. Kjo do të thotë se furnizimi me barëra dhe materiale tjera mjekësore për nevojat e misionit bëhet me mjete personale.

Në aeroportin "Butmir", reparti mjekësor i ARM-së ka zhvilluar stacion mjekësor, i cili për nevojat e forcave të EUFOR-it jep ndihmë të përgjithshme mjekësore, por edhe detyra të tjera nga fusha e sigurimit mjekësor në kuadër të misionit.

Përveç kujdesit të përditshëm të sëmurëve dhe të lënduarve nga kampi "Butmir", ekipet e para mjekësore dhe ato të ardhshme rregullisht merrnin pjesë edhe në misione për sigurim mjekësor të aktiviteteve sportive dhe kulturore brenda dhe jashtë kampit dhe e gjithë kjo me urdhër të komandës përgjegjëse.

Ekipi mjekësor i ARM-së gjashtë muajt e fundit në mënyrën më të mirë demonstroi aftësitë dhe ndërveprimin e ARM-së në kuadër të misionit të BE-së, por dha edhe kontribut të madh në afirmimin e ARM-së dhe Republikës së Maqedonisë, gjë që vërtetohet edhe me vlerësimet e larta të mara nga komanda e EUFOR-it.

"Çdo mision i ardhshëm, siç theksoi ministri i Mbrojtjes, Fatmir Besimi, në takimin me pjesëtarët e ARM-së të cilët ishin pjesë e operacionit EUFOR-ALTHEA-12, vendos standarde të reja dhe të larta dhe me këtë rast nuk mund të përjashtohet as edhe rotacioni i ri". Me këtë rast, ShP të ARM-së, gjeneral-major Goranço Koteski, i ndau "Medalje të argjendtë të ARM-së" komandantit të kontingjentit, kolonel Dushan Stojanoviç, ndërsa pjesëtarëve të tjerë të kontingjentit "Medalje të bronzit të ARM-së".

Rotacioni i ri, i trembëdhjetë i ekipit mjekësor shkoi në Sarajevë me 31 tetor të vitit 2012. Ekipi mjekësor i ARM-së është i përbërë nga 10 persona, personel profesional dhe ndihmës mjekësor. "Obligimi ynë është reputacioni i fituar për profesionalizmin e lartë dhe me kryerjen e detyrave ta vërtetojmë dhe ta ngrisim në kuadër më të lartë", theksoi lideri i ekipit Elizabeta Naumovska Petrevska. Besojmë se edhe ata, si dhe paraardhësit e tyre në mënyrë profesionale, të ndërgjegjshme dhe të disiplinuar do të përgjigjen në detyrat e dhëna në kuadër të misionit dhe edhe një herë do të konfirmojnë se pjesëtarët e ARM-së janë të gatshëm për kryerjen e detyrave, krah për krah me paqeruajtësit tjerë.

Kristina Ilievska



problem të veçantë, përveç se kishte një të lënduar rëndë i cili përfundoi me evakuim në Gjermani. Ishim të organizuar në punë, kishim orar pune prej orës 8 deri në ora 16 dhe pas kësaj kishim kujdestari. "Fushë betejë" kryesore ishte salla e gjimnasit, ku më së shpeshti kishte fraktura, të shtypura, por kishe edhe persona me sëmundje kronike të cilët vazhdimisht ishin nën kontroll".

nale, dhe nuk kishte aspak improvizime. Të gjithë ishim profesionist dhe të gjithë vinin te ne me besim të plotë dhe jo me frikë. Ndodhte, p.sh. gjatë kohës së kujdestarisë, të kërkojnë ndihmë edhe për gjëra banale, siç janë gërvishtje të vogla. Edhe ato intervenime i kryenim vetë, pa thirr kirurg. Ishim të trajnuar edhe për këtë", shtoi kolonel Blazhevski. Për kryerjen e detyrave kishim dy autom-



MISIONI I OKB-së – UNIFIL

MISIONI MË I GJATË NËN ORGANIZIM TË OKB-së

Misioni UNIFIL (United Nation Interim Force In Lebanon) lirisht mund të thuhet, se është njëri nga misionet më të gjata të Organizatës së Kombeve të bashkuara. Në mars të këtij viti u mbushën 34 vjet nga themelimi i saj në vitin 1978. Në këtë mision me ushtarët e tyre marrin pjesë vende nga e gjithë bota. Nga maji i vitit 2007 edhe Armata e Republikës së Maqedonisë mer pjesë me një oficer të shtabit në Shtabin kryesor të misionit.

Vendimin për kontributin e deklaruar të Republikës së Maqedonisë me oficer të shtabit në kuadër të operacionit paqeruajtës UNIFIL, mandati i të cilët është dhënë me Rezolutën 1701 të Këshillit për siguri të OKB-së, është miratuar nga ana e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë me 27 prill të vitit 2007, ndërsa është implementuar me 16 maj të vitit 2007. Pas shkuarjes së përfaqësuesit të parë në qershor të vitit 2008, kontributi vazhdoi me dërgimin e oficerit të ri të shtabit, si rotacioni i parë në kuadër të UNIFIL-it, përderisa në procedurë është rotacioni i gjashtë nga Armata e Republikës së Maqedonisë në pozitën e oficerit të shtabit në Komandën e bashkuar operative (major Besnik Halili).

Meqenëse ai është misioni i vetëm, nën udhëheqjen e OKB-së, ku në mesin e flamujve të 32 nacionaliteteve të tjera, nga maji i vitit 2007, valon edhe flamuri i Republikës së Maqedonisë, meriton një kthesë më të gjerë të fillimeve për vendosjen e misionit.

Forcat paqeruajtëse të Organizatës së kombeve të bashkuara në Libi kanë ardhur

që nga v. 1978, tre vjet pas fillimit të luftës qytetare (vitit 1975) dhe dy vjet pas okupimit të Sirisë në disa pjesë të Libisë (viti 1976). Por misioni UNIFIL (United Nation Interim Force In Lebanon) nuk është vendosur as për shkak të luftës qytetare e as për shkak të okupimit të Libisë.

Për shpërthimin e luftës qytetare në Libi ekzistonin më shumë shkaqe, dhe një ndër më të rëndësishmit ishte statusi i refugjatëve palestinez të cilët në territorin e Libisë kishin ardhur pas "Shtatorit të Zi" në vitin 1970, kur në Libi kishin ardhur më shumë se 100.000 palestinez. Me ata, në territorin e Libisë (kryesisht në jug të Libisë) u shpërngul edhe PLO (Palestinian Liberation Organization) dhe udhëheqësi i saj, Jaser Arafat. Në fazën fillestare të luftës qytetare palestinezët kishin fituar autonomi të madhe, ku shumë organizata militante palestineze filluan Libinë jugore, (ku deshën të formojnë shtetin e tyre) ta shfrytëzojnë për sulme kundër Izraelit. Një sulm i tillë "Fatah" (fraksion i PLO-së) mbi Izraelin, me 11 mars të vitit 1978, i njohur si "Masakër", në afërsi të Tel Avivit, rezultoi me 34 të vrarë dhe me 70 izraelitë të lënduar, që ishte edhe shkak për ngatërrimin e Izraelit në situatën kaotike në Libi.



Për të zgjidhur problemin e sigurisë të kufirit me Libinë, në mbrëmjen mes datës 14 dhe 15 mars të vitit 1978, Izraeli e filloi operacionin "Litani". Fushata e rreth 25.000 ushtarëve izraelit për dëbimin e rreth 5.000 guerilëve palestinez u shndërrua në pushtimin e gati tërë jugut të Libisë.

Qeverisë së dobët dhe të ndarë në Bejrut nuk i mbeti asgjë tjetër pos t'i drejtohet OKB-së, ashtuqë në mëngjesin e 15 marsit deri te OKB-ja dërgoi notë protestuese kundër invazionit izraelit, me arsyetimin se Libia nuk ka asnjë lidhje me PLO dhe me veprimet e saja mbi Izraelin dhe për këtë nuk mund të jenë viktimë e konfliktit palestineze-izraelit. Me 19 mars të vitit 1978, Këshilli i sigurisë së OKB-së i miratoi rezolutat 425 dhe 426 me të cilat kërkoi nga Izraeli ndërprerje të përkohshme të aktiviteteve luftarake dhe tërëhëqje nga territori i Libisë.

Tashmë me 23 mars të vitit të njëjtë, vetëm dy ditë pas armëpushimit, pjesëtarët e parë prej rreth 5.300 personave, të mbledhur nga 10 vende, arritën në Libi. U formua misioni UNIFIL (United Nation Interim Force In Lebanon). Shtabi i misionit ishte vendosur në vendin e quajtur Nagura ku është edhe sot. Duhet të theksohet se kryesisht ata ishin vëzhgues, të pajisur me armë të lehta të këmbësorisë. Sipas rezolutave të përmendura 425 dhe 426 të Këshillit të Sigurimit, UNIFIL duhej të:

- konfirmoj tërheqjen e Izraelit nga jugu i Libisë;
- të ripërtërijë paqen dhe sigurinë në rajon;
- t'i ndihmojë qeverisë së Libisë në kthimin e autoritetit të saj në Libinë jugore.

Edhe pse trupat izraelit u tërhoqën prapa kufirit ndërkombëtar, përsëri, në rripin në gjerësi prej 4-12 km (të territorit të Libisë) qeveria ia dorëzoi policisë kristiane (SLO), e njohur si Armatë e Libisë jugore. Meqenëse qeveria e Libisë nuk mund të merrte kontrollin në atë pjesë të vendit të vet edhe UNIFIL nuk mundi plotësisht të plotësoi mandatin e vet por patrullonte në jug të Libisë duke u marrë kryesisht, me aktivitetet humanitare për popullatën lokale (shumica Shiit dhe Kristijanë), duke ruajtur kështu neutralitetin e saj.

Në fillim të vitit 1982, edhe armata izraelite, në përbërje të operacionit "Paqe për Galileun", përsëri e morën Libinë jugore. Atëherë qeveria e Libisë as nuk u mundua të diskutojë për intervenimin ushtarak izraelit, por vetëm dërgoi dy kundërshtime plotësuese deri te KB.

Në përpjekjen për të diskutuar pas pyetjes për dëbimin e palestinezëve nga vendi, qeveria u shpërbë, gjë që vetëm i përforcoi ndeshjet e brendshme në mes të Sunitëve dhe Druzëve nga njëra anë dhe Kristijanëve nga ana tjetër. Meqenëse ajo ishte vetëm okupim ushtarak, dhe jo aneksimi i Libanit jugor, misioni ndërkombëtar UNIFIL vazhdon.

Nga viti 1982 deri në vitin 2000 erdhi deri te formimi i "Hezbollahut", i cili i dëboi guerilët palestinez nga vendi, dhe në vend të tyre, Hezbollahu filloi të kryente sulme terroriste mbi ushtrinë dhe objektivat izraelite në përgjithësi, për çlirimin e Libisë jugore. Pas luftës guerile shumëvjeçare me "Hezbollahun", për t'ua marrë motivin kryesor Shiitëve për luftën kundër Izraelit, për t'i zvogëluar shpenzimet dhe t'i jep fund incidenteve dhe viktimave,

në prill të vitit 2000. Izraeli i njoftoi KB se deri në fund të verës do t'i tërheq forcat e tij nga Libani jugor. Me këtë erdhi edhe deri te lëvizja e misionit dhe në fillim të vitit 2000, UNIFIL e definoi "Blu Line", e cila shtrihet në rripin e kufirit ndërkombëtar ndërmjet Libisë dhe Izraelit. Vija kufitare "Blu line" edhe sot është kontestuese në disa vende, ku ndër të tjera veçanërisht e rëndësishme është zona Sheeba Farms në trekëndëshin Libi, Siri dhe Izrael. Përderisa për Izraelin Sheeba Farms është pjesë e Izraelit, përveç nga Siria, në luftën prej v.1967, "Hezbollahu" pohon se ajo është pjesë edhe e Libisë.

Dy muaj pas tërheqjes së Izraelit nga Libia, në qershor të vitit 2000 KB e miratuan



Rezolutën 1310 me të cilën qeveria e Libisë thirret që sa më shpejt të vendos një pjesë të ushtrisë në Libinë jugore. Që nga viti 2000, kur batalioni i ushtrive të Fixhit dhe Indisë i morën pikat vëzhguese gjatë "Blu Line", Libia nuk e plotësoi obligimin e saj sipas Rezolutës 1310 të KB. Meqenëse qeveria në Bejrut e zgjaste punën me marrjen e hapësirave të çliruara, faktikisht ishte krijuar hapësirë, pa qeveri të pranuar ndërkombëtare. Me atë hapësirë filloi të menaxhojë "Hezbollahu" si përfaqësues i popullatës shiite. Ndoshta kjo anarki i përgjigjej Qeverisë së Libisë, sepse në këtë mënyrë donte ta refuzonte nevojën që i gjithë shteti të merret me element ushtarak individual politik në shoqëri, e cila gjithsesi i përgjigjej "Hezbollahut". Sjelljes së tillë të qeverisë libaneze nuk i ndikoi as Rezoluta 1337 e vitit 2001 me të cilën KB u munduan me dënim të ndikojnë në Libi. KB madje e zvogëluar edhe numrin e UNIFIL-it, nga 5.800 në 4.500 pjesëtarë të cilët mbetën të vëzhgojnë të ashtuquajturën "vendin e askujt". Deri në verë të vitit 2004 UNIFIL u zvogëluar deri në 2.000 ushtarë nga 7 vende dhe në rreth 50 vëzhgues nga përbërja e UNTSO (United Supervision Organization) në Siri të cilët i ndihmonin pjesëtarët e UNIFIL-it. Reduktimi i numrit të pjesëtarëve të UNIFIL-it dhe politika e dobësimi të qeverisë qëndrore në Bejrut të injoroj "Hezbollahun" e shiitëve, rezultuan me incidente serioze gjatë vijës kufitare. Situata eskaloj në qershor të vitit 2006 kur "Hezbollahu" sulmoi patrullë izra-

elite, duke vrarë 8 IDF-ushtarë dhe dy ushtarë ishin burgosur. Në atë incident Izraeli u përgjigj me luftë njëmuajore, kryesisht duke përdorur aviacionin e saj dhe duke sulmuar objektiva në të gjithë Libanin. Pas konfliktit një mujor, Këshilli i Sigurimit i KB e miratoi Rezolutën 1701 - si themel i armëpushimit me 14 gusht të vitit 2006. Deri në mes të shtatorit të vitit 2006 ishte përbërë "UNIFIL i ri", me ç'rast filloi edhe vendosja e forcave të tij. UNIFIL i ri sot numëron rreth 13.000 pjesëtarë të njësiteve të vogla tashmë të pranishme të Kinës, Indisë dhe Ganës të cilëve iu bashkëngjiten një numër i madh i vendeve perëndimore. Pranë 13.000 "helmetave blu", në jug të Libisë sot janë të pra-

nishëm rreth 10.000 LAV-ushtarë. Me Rezolutën 1701, misioni, gjithashtu, fiton edhe komponentë detare IMTF (Interim Maritime Task Force), të cilën e përbëjnë Gjermania, Holanda, Greqi dhe Turqia, të cilët detyrat e tyre vëzhguese në bregun e Libisë dhe ujërave të saja territoriale, i kryejnë me një rrip me një gjatësi prej rreth 50 milje detare në perëndim të bregut libanez. Edhe pse shumica, posaçërisht KB dhe popullata libaneze, presin që UNIFIL i ri të vendos dhe të ruaj paqen e dëshiruar shumëvjeçare, përsëri ekzistojnë më shumë elemente militante dhe organizata në të cilën UNIFIL i sotëm (në të cilin dominojnë elemente të botës perëndimore) u pengon të zgjerojnë idenë se Perëndimi përmes UNIFILIT okupoj pjesë të vendeve arabe. Për shkak të këtij kuptimi dhe kësaj ideologjie, shumë organizata terroriste kryejnë edhe sulme terroriste mbi patrullën dhe bazën e UNIFIL-it. Në një sulm të këtyrë me automobile-bombë (rreth 70 kg eksploziv), me 24 qershor të vitit 2007 ishin vrarë 6 ushtarë të kontingjentit spanjoll në sektorin perëndimor. Deri më tani janë kryer disa sulme të tilla terroriste në patrulla, konvojë dhe automjete individuale të UNIFIL-it, por për fat, pa viktima në njerëz dhe vetëm me dëme materiale për UNIFIL-in. Në janar të vitit 2008 gjatë një sulmi të tillë mbi një automjet të UNIFIL-it ishin lënduar dy oficerë irlandez. Edhe përkundër aktiviteteve të tilla armiqësore, UNIFIL mbete e palëkundur në përpjekjet për ruajtjen e paqes shumëvjeçare në këtë anë të botës.

S.M.



TAKIM ME PAQËRUAJTËSIN E PARË TË MAQEDONISË NË MISIONIN UNIFIL NË LIBI, NËNKOLONEL SIMEON MITREV

ME PROFESIONALIZIËM DHE PËRGJEGJËSI DREJT OBJEKTIVAVE MË TË LARTA

Etablimenti i vlerave bashkëkohore, paqja, prosperiteti, pa dyshim se janë një imperativ i çdo shteti të pjekur dhe demokratik qëllimi i të cilëve nuk devijon nga rruga e rritjes dhe zhvillimit në korniza globale. Në këtë drejtim edhe Republika e Maqedonisë, si anëtare e 181 e organizatës më të madhe botërore, Kombeve të Bashkuara, vazhdimisht i mbështet përpjekjet për bartjen e këtyre përfitimeve të shekullit të ri në të gjitha anët e botës.

Duke respektuar Kartën e OKB-së, si një komizë themelore e marrëdhënieve ndërkombëtare, Republika e Maqedonisë merr pjesë në mënyrë aktive në misionet paqeruajtëse të organizatës botërore, konkretisht në operacionet paqeruajtëse të OKB-së në Libi, UNIFIL.

Pjesëmarrja e Republikës së Maqedonisë në UNIFIL filloi në maj të vitit 2007, kur një pjesëtarë i Armatës së Republikës së Maqedonisë, nënkolonel Simeon Mitrev, si përfaqësues i parë i Republikës së Maqedonisë në UNIFIL ishte pjesë e misionit si oficer i shtabit - rojtar i ndërrimit ("watchkeeper").

E pyetëm nënkolonel Mitrev cili është përfitimi kryesor nga pjesëmarrja e Republikës së Maqedonisë në misione paqeruajtëse ndërkombëtare. "Dërgimi i paqeruajtësve nga Maqedonia në misione dhe në më

shumë organizata internacionale sjell përfitim të dyfishtë - Maqedonia fiton eporë me përvojë, të gatshëm për tu ballafaquar me rreziqet e epokës së re, dhe njëkohësisht edhe ARM-ja dëshmon se në ushtrinë e saj ka kuadër të trajnuar dhe profesional, i cili aspak nuk mbetet mbrapa vendeve më të zhvilluara perëndimore. Për mua personalisht, e një rëndësie të veçantë është përvoja, sepse atje isha oficer shtabi. Sa i përket përfitimeve nga misioni, duhet të potencoj se shumë njerëz nga vendet më të largëta për herë të parë kanë dëgjuar për Maqedoninë. Mendoj se e një rëndësie të veçantë për ushtrinë tonë është pjesëmarrja e saj e vazhdueshme në misione të tilla".

Kur bëhet fjalë për përgjegjësitë kryesore dhe detyrat gjatë rotacionit një vjeçar, nënkoloneli na sqaroi se: "Në punë isha me ndërrime 12 orë, nga ora 8 në mëngjes deri në ora 8 të mbrëmjes. Pastaj, atë natë isha i lirë dhe të nesërmen njësoj, dhe pastaj prej orës 8 të mbrëmjes, deri në mëngjes. Në vendin e punës kisha dy telefon kryesorë, sepse tërë baza ishte e ndarë në dy sektore me nga dy brigada - lindor, ku si bartës ishte Spanja, dhe perëndimor, me Italinë si bartës. Në fakt, në bazë kishte përfaqësues nga gjithsej 31 vende. Informatat për gjithë atë që ndodhte vinin përmes "watchkeeper".

Dhe ato nuk janë vetëm paralajmërim, por në bazë të atyre informatave duhet të sillen edhe vendime vendimtare - se ku duhet të dërgohet njësi, a duhet të dërgohet patrullë ose jo dhe të tjera. Njëkohësisht kisha edhe detyrë të përgatisë raport, të bëj prezantim dhe t'ia paraqes komandantit të forcave".

Edhe në misione ku qëllimi kryesor është përmirësimi i jetës së popullatës vendore dhe bartja e përfitimeve nga proceset demokratike, ekzistojnë rreziqe. "Të gjitha kontingjentet në UNIFIL bëjnë ahengje për ditët kombëtare. Për ditën kombëtare të Spanjës ishim në sektorin lindor dhe gjatë kthimit, pas automjetit tonë, pas pesë minutave, me një eksploziv të automobil-bombës, me 70 dhe më shumë kilogram eksploziv, ishte shkatërruar plotësisht një transportues spanjoll. Atëherë humbën jetën 6 paqeruajtës", u rikujtua nënkolonel Mitrev.

Përsëri, mundësia për të qenë pjesë e operacionit kompleks i cili në vete mban një qëllim fisnik, është një arsye e mjaftueshme dhe një rast që pjesëtarët-paqeruajtësit e Armatës së Republikës së Maqedonisë, me tërë profesionalizmin e tyre, njohurit në profesion, vazhdimisht të jenë pjesëmarrës aktiv në misione paqeruajtëse.

Ivan Petrushevski



